



KOMISIONI EVROPIKA  
KOMISIJA

Bruksel, 30.10.2024  
DPSH (2024) 693 version i fundit

**DOKUMENT PUNE I SHËRBIMEVE TË KOMISIONIT<sup>1</sup>**

**Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024**

*bashkëngjitur*

**KOMUNIKIMI I KOMISIONIT DORËZUAR PARLAMENTIT EVROPIAN,  
KËSHILLIT, KOMITETIT EVROPIAN EKONOMIK-SOCIAL DHE KOMITETIT  
TË RAJONEVE**

**Komunikimi për Politikën për Zgjerim të BE-së për vitin 2024**

{KOM(2024) 690 version i fundit} – {DPSH(2024) 690 version i fundit} – {DPSH(2024) 691 version i fundit} – {DPSH(2022) 692 version i fundit} – {DPSH(2022) 694 version i fundit} – {DPSH(2022) 695 version i fundit} – {DPSH(2022) 696 version i fundit} – {DPSH(2022) 697 version i fundit} – {DPSH(2022) 698 version i fundit} – {DPSH(2022) 699 version i fundit}

---

<sup>1</sup> Vërejtje: Përkthimi në gjuhën maqedonase është version pune. Nëse ekziston çfarëdo parregullsie ndërmjet dokumentit në gjuhën angleze dhe përkthimit në gjuhën maqedonase, dokumenti original në gjuhën angleze do të konsiderohet si version autentik i cili është i përshtatshëm për përdorim.

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
1.1. Konteksti .....	3
1.2. Konstatimet kryesore nga raporti.....	3
1.3. Gjendja aktuale me negociatat aderuese.....	21
2. klasteri 1: vlerat fundamentale të procesit të anëtarësimit.....	22
2.1. Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma në administratën publike .....	22
2.1.1. Demokracia .....	22
2.1.2. Reforma në administratën publike .....	25
2.2. Sundimi i ligjit dhe të drejtat funksionale.....	28
2.2.1. Kapitulli 23: Sistemi i drejtësisë dhe të drejtat fundamentale .....	28
2.2.2. Kapitulli 24: E drejta, liria dhe siguria .....	43
2.3. KRITERET EKONOMIKE.....	52
2.3.1. Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut.....	52
2.3.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut në Bashkimin Evropian .....	58
2.4. Prokurimet publike, statistika, kontrolli financiar .....	60
Kapitulli 5: Prokurimet publike .....	60
Kapitulli 18: Statistika .....	61
Kapitulli 32: Kontrolli financiar .....	62
3. marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal .....	64
4. AFTËSIA PËR MARRJEN E PËRGJEGJËSIVE TË ANËTARËSIMIT.....	65
Klasteri 2: Tregu i brendshëm.....	65
Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave.....	66
Kapitulli 2: Lëvizja e lirë e punëtorëve.....	67
Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve .....	67
Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit .....	68
Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare.....	69
Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale .....	69
Kapitulli 8: Politika e konkurrencës .....	70
Kapitulli 9: Shërbimet financiare .....	71
Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtja shëndetësore.....	72
Klasteri 3: Konkurrenca dhe rritja gjithëpërfshirëse .....	74
Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat .....	74
Kapitulli 16: Tatimimi .....	75
Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare .....	76
Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi .....	77

Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale .....	79
Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi .....	80
Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura .....	80
Kapitulli 29: Unioni Doganor .....	83
Klasteri 4: Agjenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme.....	83
Kapitulli 14: Politika e transportit.....	83
Kapitulli 15: Energjetika .....	85
Kapitulli 21: Rrjetet transevropiane .....	86
Kapitulli 27: Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike .....	87
Klasteri 5: Resurset, bujqësia dhe kohezioni .....	90
Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	90
Kapitulli 12: Siguria e ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare .....	91
Kapitulli 13: Peshkimi dhe akuakultura .....	92
Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore .....	93
Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore .....	95
Klasteri 6: Marrëdhëniet e jashtme .....	95
Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme.....	96
Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes.....	96
Aneksi I – Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Maqedonisë së Veriut .....	99
Aneksi II – Të dhënat statistikore .....	101

## 1. HYRJE<sup>2</sup>

### 1.1. KONTEKSTI

Pas Konferencës së parë Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit më 19 korrik 2022, takimet e shqyrtimit (screening) për të gjashtë klasterët përfunduan më 7 dhjetor 2023. Maqedonia e Veriut vazhdoi të zbatojë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe u mbledhën organet e përbashkëta në kuadër të Marrëveshjes.

Maqedonia e Veriut vazhdimisht thekson përkushtimin e saj politik ndaj qëllimit strategjik të integritimit në BE dhe ambicien e saj për të shënuar progres në procesin e negociatave të anëtarësimit. Presidentja e sapozgjedhur mori detyrën në maj 2024 dhe në qershor 2024, pas zgjedhjeve parlamentare, u formua qeveria e re. Duhet të zbatohen reforma thelbësore në lidhje me BE-në. Maqedonia e Veriut mban marrëdhënie të mira me vendet e tjera të përfshira në procesin e zgjerimit dhe ka vazhduar pjesëmarrjen e saj aktive në nismat rajonale. Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese me vendet fqinje duhet të zbatohen me vullnet të mirë nga të gjitha palët, përfshirë Marrëveshjen e Prespës ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë dhe Marrëveshjen për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me Bullgarinë.

Maqedonia e Veriut vazhdoi harmonizimin e saj të plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, përfshirë edhe në lidhje me agresionin ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, duke dërguar kështu një sinjal të qartë për zgjedhjen së saj strategjike për pranimin në BE dhe, edhe një herë, duke u dëshmuar si një partner i sigurt. Në vitin 2023, luajti një rol aktiv në një kontekst të ndërlikuar gjeopolitik gjatë mandatit të saj si kryesues i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Maqedonia e Veriut është përfshirë në mënyrë aktive në zbatimin e Planit të ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor përmes katër shtyllave të tij: (i) integrimi gradual me tregun e vetëm të BE-së, (ii) integrimi ekonomik rajonal, (iii) reformat themelore dhe (iv) ndihma e rritur financiare. Agjenda reformuese e të njëjtit përfshin qëllimet kryesore reformuese në fushat: (i) menaxhimi, reforma në administratën publike dhe menaxhimi i financave publike; (ii) transicioni i gjelbër dhe digjital; (iii) kapitali njerëzor; (iv) zhvillimi i sektorit privat dhe mjedisi i biznesit; dhe (v) të drejtat themelore dhe sundimi i ligjit.

Maqedonia e Veriut për herë të parë u përfshi në Raportin e Komisionit për Sundimin e Ligjit për vitin 2024<sup>3</sup>.

### 1.2. KONSTATIMET KRYESORE NGA RAPORTI<sup>4</sup>

## 2. KLASTERI 1: VLERAT FUNKSIONALE TË PROCESIT TË ANËTARËSIMIT

<sup>2</sup> Raporti për vitin 2024 është paraqitur në format dhe strukturë të përtëritur. Konstatimet kryesore nga raporti, së bashku me rekomandimet (fusha të përhitura paraprakisht me vlerësim) gjenden në fillim të raportit. Më tutje, nën klasterin vlera fundamentale, për lexueshmëri dhe krahasim më të mirë në të gjitha raportet, të dhëna të caktuara janë dhënë (gjithashtu) në formë të grafikëve.

<sup>3</sup> KOM(2024) 800 version i fundit

<sup>4</sup> Ky raport e përfshin periudhën nga 15 qershor 2023 deri më 1 shtator 2024. Ai bazohet në kontribut nga burime të ndryshme, përfshirë edhe kontributet nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, vendet anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informacionet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare. I përfshin edhe rezultatet nga vlerësimet komparativë dhe indekset e krijuara nga palët tjera të interesuara, veçanërisht në sferën e sundimit të ligjit.

Për të përshkruar situatën faktike, Raporti përdor shkallën e mëposhtme: faza e hershme, shkallë e caktuar e gatishmërisë, gatishmëri mesatare, nivel i mirë i gatishmërisë dhe shkallë shumë e mirë e gatishmërisë. Ai përdor shkallën e mëposhtme për të përshkruar progresin e bërë gjatë periudhës raportuese: regres, nuk ka progres, progres i kufizuar, progres i caktuar, progres i mirë dhe progres shumë i mirë. Aty ku është e përshtatshme, përdoren edhe ndërvlerësime.

### 2.1.1 Demokracia

---

Realizimi i **zgjedhjeve** ishte kryesisht i kënaqshëm. Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale ishin konkurruese. U respektuan liritë themelore. Legjislacioni zgjedhor ofron një kornizë adekuate për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, është bërë përparim i kufizuar në zbatimin e rekomandimeve tjera nga Zyra e OSBE-së për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) dhe nga Komisioni i Venecias. Maqedonia e Veriut duhet t'i zbatojë rekomandimet shpejt dhe plotësisht para zgjedhjeve të ardhshme.

U konstatua se **Kuvendi** i realizon autorizimet e tij në mënyrë kryesisht të kënaqshme. Megjithatë, polarizimi politik në Kuvend vazhdoi, duke prlonguar miratimin e reformave të rëndësishme dhe disa emërime të vonuara para shumë kohësh. Në nëntor 2023 u miratuan rregullore të reja procedurale të bazuara në një shkallë të lartë konsensusi, me ç'rast u rumbullakuan obligimet e "Dialogut Zhan Mone". Kuvendi i ri, i konstituar në maj, arriti të gjejë një konsensus të gjerë për zbatimin e rregulloreve të reja të punës, për nevojën për një debat politik konstruktiv dhe gjithëpërfshirës dhe duhet të përshpejtojë punën e tij për të vazhduar reformat e nevojshme për procesin e integritimit në BE. Kuvendi duhet të planifikojë dhe miratojë me kujdes agjendën e tij dhe të kufizojë përdorimin e procedurave të shpejta legjislative ose përdorimin e papërshtatshëm të procedurës me "flamur evropian", që ka qenë praktikë deri tani. Bashkëpunimi ndërpartiak është me rëndësi thelbësore për të përshpejtuar zbatimin e reformave të lidhura me BE-në, në interes të qytetarëve. Pavarësisht tentativave, deri më tani nuk është bërë progres në miratimin e ndryshimeve kushtetuese, të cilat vendi është obliguar t'i iniciojë dhe zbatojë, me qëllim për t'u përfshirë në Kushtetutë qytetarët që jetojnë brenda kufijve të vendit dhe që janë pjesë e popujve të tjera, si bullgarët, siç është cekur në Konkluzionet e Këshillit të 18 korrikut 2022.

Janë themeluar institucionet e ngarkuar për procesin e integritimit. Qeveria e re themeloi Ministrinë për Çështje Evropiane, e cila zëvendësoi Sekretariatën për Çështje Evropiane. Pas përfundimit të suksesshëm të procesit të shqyrtimit, Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë t'i përforcojë strukturat e saj negociuese me BE-në dhe të arrijë koordinim të mirë ndërmjet ministrive dhe institucioneve resore me zhvillimin e mëtejshëm të ekspertizës në lidhje me të drejtën e BE-së në administratën publike.

Nevojiten hapa të vazhdueshme dhe vendimtare për të përshpejtuar realizimin e reformave të BE-së dhe për të ecur përpara në procesin e negociatave të anëtarësimit me BE-në. Bashkëpunimi ndërpartiak mbetet thelbësor në këtë drejtim. Nevojitet urgjentisht reformë të vetëqeverisjes lokale dhe duhet të përsëri të fillojë dialogu ndërmjet niveleve të ndryshme të pushtetit. Marrëdhëniet ndëretnike mbetën të qëndrueshme dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit vazhdoi të zbatohet.

**Organizatrat civile** (OC) në Maqedoninë e Veriut punojnë në përgjithësi në një mjedis të favorshëm. Megjithatë, Qeveria duhet t'i rrisë përpjekjet e saj për të përfshirë shoqërinë civile në fushat prioritare dhe në aktivitetet konsultative. Ende ekziston nevoja për të ndryshuar dhe zbatuar kornizën ligjore dhe financiare ekzistuese, veçanërisht për të siguruar mekanizma konsistente për sigurimin e financimit transparent publik të OC-ve. Nevojiten përpjekje urgjente për vazhdimin e aktiviteteve të Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

### Reformë në administratën publike

---

Maqedonia e Veriut mbetet e përgatitur mesatarisht në fushën e reformës në administratën publike. Është arritur progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese, veçanërisht gjatë miratimit të ndryshimeve në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, të cilat sollën përmirësime përmes qartësisht të linjave të përgjegjësisë, futjes së

vlërësimeve të ndikimit për formimin e organeve të reja shtetërore dhe reduktimit të numrit të përdoruesve primar buxhetor.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe prandaj mbesin në masë të madhe të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë dhe zbatojë ligjin e rishikuar për zyrtarët administrativë, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat ligjore për shërbimin e lartë udhëheqës;
- ta finalizojë rishikimin dhe të fillohet me zbatimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore dhe ligjeve të tjera përkatëse në përputhje me rekomandimet për organizimin e ri të organeve të administratës shtetërore;
- të sigurojë zbatimin e plotë të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative me përfundimin e digjitalizimit të regjistrave të institucioneve dhe shkëmbimin e të dhënave dhe me thjeshtimin e procedurave elektronike.
- t'i miratojë dhe ta zbatojë Ligjin për nëpunës administrativë, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat ligjore për shërbimin e lartë udhëheqës;
- ta finalizojë revizionin dhe të fillojë me zbatimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore dhe ligjet tjera lidhur në pajtim me rekomandimet për organizimin e ri

### **Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat fundamentale**

---

Maqedonia e Veriut arriti **ndërmjet nivelit të caktuar dhe mesatar të gatishmërisë** në zbatimin e të drejtës së BE-së dhe standardeve evropiane në këtë sferë. Gjithsej, është arritur **progres i kufizuar** në përfundimin e pavarësisë gjyqësore dhe përmirësimin e kornizës juridike për mbrojtjen e të drejtave fundamentale.

#### ***Funksionimi i sistemit të drejtësisë***

Sistemi gjyqësor i Maqedonisë së Veriut arriti **ndërmjet nivelit të caktuar dhe mesatar të gatishmërisë** dhe arriti **progres të caktuar**. Vendi miratoi Strategji të re sektoriale zhvillimore të sistemit të drejtësisë (2024-2028) dhe udhërrëfyes për Kapitullin 23 dhe filloi t'i zbatojë rekomandimet e Misionit vlerësues të vitit 2023 për Këshillin Gjyqësor. Njoftimet e Qeverisë së re për planet për "shpërbërjen" e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë shkaktojnë shqetësim serioz sepse aktivitetet e tilla do ta dëmtojnë pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Deficiti i rritur i resurseve njerëzore në sistemin e drejtësisë shkakton shqetësim për ndikimin mbi cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe prandaj në masë të madhe vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të miratojë Ligj të ri për procedurë kontestimore, në pajtim me standardet evropiane dhe të fillojë me zbatimin e Strategjisë sektoriale zhvillimore të sistemit të drejtësisë;
- ta përforcojë Këshillin Gjyqësor përmes revizionit të kornizës legjislative dhe funksionimit të tij të përgjithshëm që të përforcohet transparenca dhe pavarësia e tij, në pajtim me rekomandimet e Misionit vlerësues nga viti 2023 dhe të përshpejtohet zbatimi i strategjive për resurse njerëzore për gjyqësorin dhe prokurorinë;
- të sigurohet se sistemi i automatizuar informues për menaxhim me lëndët gjyqësore (AKMIS) është funksional dhe kompatibil plotësisht me nivelin e ndërlikimit të lëndëve gjyqësore dhe metodës për vlerësim të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatësve.

#### ***Lufta kundër korrupsionit***

Maqedonia e Veriut arriti ndërmjet **nivelit të caktuar të gatishmërisë dhe nivelit mesatar të gatishmërisë** dhe nuk arriti **progres** të caktuar në parandalimin dhe luftën kundër

korrupsionit. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe përbën një çështje shqetësuese. Qeveria aktuale deklaroi se lufta kundër korrupsionit është prioritet.

Korniza institucionale për luftimin e korrupsionit është vendosur dhe është e kënaqshme për sa u përket masave parandaluese. Megjithatë, nevojitet përmirësimi i zbatimit të ligjit. Përbërja e re e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) ka filluar mandatin më 8 shkurt 2024. Është me rëndësi kryesore që të veprojë me nivelin më të lartë të profesionalizmit, integritetit dhe pavarësisë. Duhet të vazhdojë të sigurojë udhëzime proaktive politike për të parandaluar korrupsionin dhe të punojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Rekomandimet e tij duhet të zbatohen në mënyrë efektive. Për të përmirësuar punën e KSHPK-së, Prokuroria Publike, qendrat hetimore dhe njësitë e zbatimit të ligjit duhet të marrin burime shtesë njerëzore dhe mbështetje financiare. Janë miratuar dokumente strategjike dhe është vendosur kornizë ligjore për të luftuar korrupsionin, por duhet të përmirësohet, si në aspektin e masave parandaluese ashtu edhe në aspektin e zbatimit të ligjit.

Ndryshimet në Kodin Penal të shtatorit 2023 dobësuan kornizën ligjore, duke ndikuar negativisht në ndjekjen penale të korrupsionit, veçanërisht në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Shumë çështje në vazhdim janë ndërprerë ose për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit ose për shkak se nuk ekzistojnë më kundërvajtje konkrete, si keqpërdorimi i pozitës zyrtare në prokurimet publike.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar plotësisht dhe prandaj mbesin të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut veçanërisht duhet:

- të miratojë Kod të ri penal në pajtim me të drejtën e BE-së dhe standardet ndërnacionale. Ta përmirësojë rezultatin në lëndët e korrupsionit të nivelit të lartë – me hetime në kohë, profesionale dhe transparente proaktive, ndjekje, aktgjykime të plotfuqishme dhe kthim, përfshirë edhe konfiskimin e mjeteve kriminale, konfiskimin të bazuar në vlerë, konfiskimin e zgjeruar dhe konfiskimin nga pala e tretë;
- ta përmirësojë zbatimin e Strategjisë Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, si dhe rekomandimet e GREKO-s, veçanërisht lidhur me sistemin e sanksioneve për shkelje të rregullave për konflikt të interesave, integritet dhe antikorrupsion;
- t'i ndajë resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare prokurori publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë edhe ekspertët financiarë që të sigurohet llogaridhënie efektive për lëndët e korrupsionit të nivelit të lartë; dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për ta përmirësuar verifikimin e deklaratave për gjendjen pronësore dhe mbikëqyrjen e financimit të fushatës zgjedhore.

### ***Të drejtat fundamentale***

Korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore është pjesërisht e harmonizuar me të drejtën e BE-së dhe standardet evropiane. Vendi vazhdon të përmbushë detyrimet e tij të përgjithshme në lidhje me të drejtat themelore, por legjislacioni duhet të zbatohet në mënyrë sistematike. Në nëntor të vitit 2023, Kuvendi caktoi Shoqatën maqedonase të juristëve të rinj dhe Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNJ) për të shërbyer si mekanizëm i kontrollit civil në kuadër të Zyrës së Avokatit të Popullit. Kuvendi zgjodhi anëtarët e rinj të Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe plotësoi vendet vakante. Asnjë progres nuk është bërë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Gjendja e përgjithshme e burgjeve mbetet e tmerrshme megjithëse infrastruktura është rinovuar dhe përmirësuar në disa institucione të burgjeve.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe prandaj mbeten të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet veçanërisht:

- të përballet me kushtet e tmerrshme në burgjet dhe të vazhdojë me përpjekjet për promovimin e alternativave të mbylljes dhe zbatimit të rekomandimeve relevante për kushtet për paraburgim, të dhëna nga institucionet nacionale dhe ndërnacionale, veçanërisht nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Veprimet ose Ndëshkimit Jonjerëzor dhe Poshtëruës (KPT);
- t'ua ndajë resurset e domosdoshme Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi që t'u mundësojë ta plotësojnë mandatin e tyre;
- të sigurojë mbështetje adekuatë për kategoritë vulnerabile të fëmijëve, veçanërisht fëmijëve viktimë të dhunës, fëmijëve romë<sup>5</sup> dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.

### **Liria e shprehjes**

Maqedonia e Veriut arriti **ndërmjet nivelit të caktuar të gatishmërisë dhe nivelit mesatar të gatishmërisë** për lirinë e shprehjes dhe arriti **progres të kufizuar** në këtë sferë. Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale u ndryshua në korrik 2023 që të harmonizohet me Direktivën për shërbime mediatike audiovizuale. Gjithashtu u ndryshua në shkurt 2024 që përsëri të futet reklamimi shtetëror në mediat komerciale, që më vonë u kritikua nga rregullatori për mediat dhe organizatat mediatike. U ndryshua edhe Ligji për mediat dhe Kodi Zgjedhor. Megjithatë, këto ndryshime nuk u përfshinë dhe prandaj shumica e çështjeve shumëvjeçare mbeten të pazgjidhura.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe prandaj mbeten të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet veçanërisht:

- të vazhdojë ta rishikojë kornizën juridike që i rregullon mediat për ta harmonizuar me të drejtën e BE-së dhe standardet evropiane, veçanërisht me futjen e rregullave për transparencë të plotë në pronësinë dhe reklamimin e mediave, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore dhe të drejtën e pronësisë intelektuale, në pajtim me tregun e vetëm të BE-së;
- ta zbatojë strategjinë për reforma në radiodifuzerin publik dhe të emërojë në Këshillin Programor të Servisit Radiodifuziv Publik dhe në Këshillin e Rregullatorit Mediatik;
- të vazhdojë t'i zgjidhë në kohë të gjitha rastet e kërcënimeve dhe veprimeve të dhunshme ndaj gazetarëve dhe të sigurojë që kryerësit të dënohen.

### **Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria**

Maqedonia e Veriut **është përgatitur mesatarisht** për zbatimin e të drejtës së BE-së. Është arritur **progres i caktuar** në sferën e kthimit të mjeteve dhe konfiskimit me harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me të drejtën e BE-së. Është arritur progres i kufizuar lidhur me migrimin dhe azilin ku nuk kishte harmonizim të mëtutjeshëm me të drejtën e BE-së. Marrëveshja e re me Fronteks zbatohet në nivel të kënaqshëm.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe kryesisht mbeten të vlejshme. Prandaj, në vitin e ardhshëm, vendi duhet veçanërisht:

- të vazhdojë me reformë proaktive të strukturave që janë përgjegjës për luftimin e krimit të organizuar dhe financiar dhe pastrimin e parave me fokus në rritjen e kapacitetit operativ dhe bashkëpunimi dhe konfiskimi i pronës kur kjo është e arsyetuar;

<sup>5</sup>Në përputhje me terminologjinë e institucioneve evropiane, shprehja e përgjithshme "romë" përdoret këtu për t'u referuar disa grupeve të ndryshme, pa mohuar specifikat e këtyre grupeve.



- të sigurojë zbatim dhe ndjekje efektive të strategjive nacionale për luftimin e terrorizmit (2023-2027), luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (2023-2027) dhe të plan veprimit të përbashkët për luftimin e terrorizmit;
- t'i evidentojë në mënyrë sistemore emigrantët dhe ta përmirësojë profilizimin e ndjeshëm ndaj mbrojtjes dhe të miratojë qasje më sistemore në luftimin e kontrabandimit të emigrantëve.

### **Luftimi i krimit të organizuar**

Maqedonia e Veriut arriti **nivel të caktuar të gatishmërisë dhe nivel mesatar të gatishmërisë** në luftimin e krimit të organizuar. Është arritur **progres o caktuar** në sferën e konfiskimit me harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit për Zyrën për kthim të pronës dhe menaxhim me pronën e konfiskuar me kornizën juridike të BE-së. Është arritur progres shtesë në formimin e Komisionit për kompensim në para të viktimave të trafikimit me njerëz.

Rekomandimet e Komisionit nga e kaluara u zbatuan vetëm pjesërisht dhe mbeten të vlejshme. Prandaj, në vitin e ardhshëm, vendi duhet veçanërisht:

- ta përmirësojë evidentimin e hetimeve, ndjekjen dhe aktgjykimet në lëndët e krimit të organizuar dhe lëndët e pastrimit të parave me fokus në kthimin e mjeteve dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi;
- ta përforcojë kapacitetin njerëzor dhe financiar të organeve për zbatimin e ligjit që hetojnë krim të organizuar dhe serioz, krimin financiar dhe pastrimin e parave, si dhe të Zyrës për kthimin e pronës (ARO) dhe Agjencisë për Menaxhim me Pronë të Konfiskuar;
- ta harmonizojë legjislacionin e saj lidhur me pastrimin e parave, kthimin e mjeteve, armën, drogat dehëse dhe substancat psikotropike *me të drejtën* e BE-së.

### **Kriteret ekonomike**

#### **Ekzistimi i ekonomisë tregtare funksionale**

---

Maqedonia e Veriut arriti **progres të caktuar** dhe nëse ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në zhvillimin e ekonomisë tregtare funksionale. Shpenzimet kapitale u rritën dukshëm dhe reformat në menaxhimin fiskal shënuan progres. Bilanci i llogarisë rrjedhëse u përmirësua dukshëm për shkak të rënies së çmimeve të importit të energjisë dhe ushqimit. Banka Popullore e ruajti shkallën bazë të kamatës të pandryshuar nga shtatori 2023 sepse inflacioni vazhdoi të ulet. Sektori bankar mbeti i rezistueshëm, ndërsa stabiliteti financiar u përforcua me masat e reja makroprudente. Rimëkëmbja pas krizës me KOVID-19 mbeti e dobët në vitin 2023, ndërsa deficitin fiskal dhe niveli i borxhit publik u rritën. Tregu i punës vazhdoi të përballëte me problemet strukturore, përfshirë edhe shkallët e ulëta të pjesëmarrjes, emigrim të dukshëm dhe hendek të madh ndërmjet gjinive. Mjedisi i biznesit ende është e penguar nga ekonomia e madhe joformale.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe prandaj mbeten në masë të madhe të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut veçanërisht duhet:

- ta miratojë legjislacionin për zbatim të Ligjit për buxhetet dhe të harmonizohet me rregullat fiskale që do të zbatohen nga viti 2025, përfshirë edhe me miratimin e masave shtesë për rritjen e të ardhurave;
- ta përshpejtojë Plan veprimin për menaxhimin me investimet publike dhe ta përmirësojë kornizën juridike për partneritete dhe koncesione privato-publike;
- ta zbatojë Strategjinë e re për formalizimin e ekonomisë joformale 2023-2025.

#### **Kapaciteti për përballje me presionin konkurrues dhe forcat e tregut në kuadër të BE-së**

---

Maqedonia e Veriut arriti **progres të caktuar** dhe **është përgatitur mesatarisht** të përballet me presionin konkurrues dhe forcat e tregut në kuadër të BE-së. Ajo arriti progres të caktuar në rritjen e pjesëmarrjes së prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe e modernizon kornizën juridike për përmirësimin e efikasitetit energjetik. Integrimi me BE-në në tregtimin dhe investimet, si dhe transparencën e plotë tregtare, mbetën në nivel të lartë në vitin 2023. Digjitalizimi i ekonomisë shënon progres, por subjektet afariste vendore vuajtën nga shkathtësitë e ulëta digjitale. Qeveria miratoi legjislacion për modernizimin e sistemit arsimor, por mungesa e madhe e shkathtësive, si dhe mangësitë në infrastrukturën e transportit dhe energjetikës ekzistojnë edhe më tutje.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe prandaj mbeten të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- t'i rrisë resurset financiare dhe njerëzore që të përshejtohen reformat e sistemit për arsim dhe trajnim profesional;
- ta zbatojë Plan veprimin për Strategjinë për specializim të mençur;
- ta rrisë shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, përfshirë edhe me miratimin e Ligjit të ri për burime të rinovueshme të energjisë dhe Ligjit për biokarburante;
- të zbatojë politika për reduktimin e emisioneve, përfshirë edhe me miratimin e Ligjit për aksion klimatik.

## **Kapitulli 5: Prokurimet publike**

---

Maqedonia e Veriut **është e përgatitur** në sferën e prokurimeve publike. Është arritur **progres i kufizuar** nga vlerësimi i fundit. Kapacitetet e institucioneve kryesore, organeve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë doemos duhet doemos të rriten përmes trajnimit të vazhdueshëm. Duhet të rritet konkurrenca në prokurimet publike dhe shfrytëzimi i kriterëve për ofertën më të volitshme ekonomike (OVE). Organet nacionale duhet të zbatojnë masa më efikase antikorrupsive në ciklin e prokurimeve publike.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe prandaj mbeten të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë Ligjin për partneritet privato-publik (PPP) dhe Ligjin për koncesione, për harmonizim të më tutjeshëm të kornizës juridike në këto sfera me të drejtën e BE-së;
- ta rrisë përdorimin e kriterëve për ofertën më të volitshme ekonomike (OVE) për ndarje të kontratave dhe për ta përmirësuar monitorimin e procedurave për prokurime publike përmes njoftimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të parregullive, në rastet e konfliktit të interesave dhe praktikave mashtruese;
- ta përmirësojë koordinimin ndërmjet aktorëve kryesorë dhe për ta përforcuar kapacitetin e tyre për zbatimin e parimeve për transparencë, konkurrencë të lirë, trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim.

## **Kapitulli 18: Statistika**

---

Vendi arriti ndërmjet **niveleit mesatar dhe niveleit të mirë të gatishmërisë** në sferën e statistikës. Është arritur **progres i caktuar**, kryesisht në sferën e infrastrukturës statistike, statistikës afariste dhe statistikës për tregti dhe statistikës për llogari financiare.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe mbeten në masë të madhe të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta zbatojë Regjistrimin provues të bujqësisë;
- të sigurojë personel adekuat dhe mjete të mjaftueshme financiare për Entin Shtetëror të Statistikës;
- të vazhdojë ta përmirësojë statistikën makroekonomike, veçanërisht me vendosjen e transparencës, përmirësimin të konsekuencës, kohës së duhur dhe përfshirjes së procedurës për deficit tej mase dhe statistikës financiare qeveritare dhe me harmonizimin e mëtutjeshëm të llogarive financiare dhe llogarive nacionale tremujore me Sistemin evropian të llogarive 2010 (ECC 2010).

### **Kapitulli 32: Kontrolli financiar**

---

Vendi **është përgatitur mesatarisht** në sferën e kontrollit financiar dhe arriti **progres të kufizuar**. Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP) dhe reformat për përgjegjësinë udhëheqëse prolongohen për shkak të prolongimeve të konsiderueshme në miratimin e Ligjit për KBFP, i cili pas më shumë se 3 vite ende është në procedurë të Kuvendit. Duhet të përfordhet kapaciteti institucional i inspektimit financiar. Pavarësia e Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) ende nuk është garantuar me Kushtetutën dhe Ligji për revizion shtetëror pret të miratohet nga Qeveria. Efikasiteti i mbikëqyrjes së Kuvendit mbi financat publike dhe monitorimi i njëpasnjëshëm i rekomandimeve nga revizioni duhet të përmirësohen.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe prandaj mbeten të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë dhe të fillojë së zbatuari Ligjin e ri për KBFP me qëllim të përfordimit të kapacitetit institucional të njësive për revizion të brendshëm, llogaridhënies udhëheqëse dhe menaxhimit të qëndrueshëm financiar;
- ta miratojë Ligjin për revizion shtetëror me qëllim të përfordimit të pavarësisë së ESHR-së, përmirësimin të bashkëpunimit ndërmjet ESHR-së dhe Kuvendit, përmirësimin të kontrollit të Kuvendit mbi zbatimin e raporteve të veçanta të revizionit dhe monitorimit të njëpasnjëshëm të rekomandimeve të ESHR-së;
- ta sigurojë funksionimin efikas të Rrjetit për koordinim të luftimit kundër mashtrimit të mjeteve të BE-së (AFKOS) dhe të përmirësohet parandalimi, menaxhimi dhe raportimi për parregullsitë lidhur me fondet e BE-së.

## **KLASTERI 2: TREGU I BRENDSHËM**

### **Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave**

---

Maqedonia e Veriut **është e përgatitur mesatarisht** në sferën e qarkullimit të lirë të mallrave. Megjithatë legjislacioni nacional lejon mallrat të hyjnë në tregun e BE-së, duhet të arrihet harmonizimi i plotë me të drejtën më të re të BE-së. Në periudhën e raportit **nuk është arritur progres**.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejshme. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë Ligjin për mbikëqyrje të tregut dhe legjislacionit për zbatim që janë të domosdoshëm që të përfundojë harmonizimi me Direktivën e BE-së për siguri të përgjithshme të produkteve;
- të miratojë strategji të re për qarkullim të lirë të mallrave, që duhet të përfshirë parashikim të rritjes së konsiderueshme në resurset njerëzore për zhvillim juridik dhe zhvillim të politikave dhe zbatim;
- të miratojë plan veprim të ri për mënjanim të pengesave jotarifore për tregti dhe për sigurim të harmonizimit me nenet 34-36 të Marrëveshjes për funksionim të Bashkimit Evropian.

## **Kapitulli 2: Qarkullimi i lirë i punëtorëve**

---

Maqedonia e Veriut është **në fazë të hershme të gatishmërisë** në sferën e qarkullimit të lirë të punëtorëve dhe **nuk është arritur progres** në këtë sferë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta përforcojë kapacitetin e Agjencisë së Punësimit me vazhdim të aktiviteteve për trajnim dhe në mënyrë plotësuese ta harmonizojë legjislacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira, në pajtim me rregullat e EURES-it dhe ELA-s;
- të vazhdojë me përshtatjen e kornizës juridike në pajtim me *të drejtën* e BE-së për qasje në tregun e punës, veçanërisht në lidhje me rregullat për mosdiskriminim në bazë të tregut të punës, veçanërisht në lidhje me rregullat për mosdiskriminim në bazë të kombësisë lidhur me punëtorët e BE-së në të gjitha sektorët;
- të vazhdojë me negociatat dhe me lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për koordinim të sigurimit social dhe për sigurimin shëndetësor me vendet anëtare të BE-së dhe të vendosë masa administrative për përgatitje për qasje.

## **Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve**

---

Lidhur me të drejtën e themelimit të lirisë së ofrimit të shërbimeve, Maqedonia e Veriut **është përgatitur mesatarisht**. Është arritur **progres i kufizuar** në vazhdimin e harmonizimit të legjislacionit sektorial me Direktivën për shërbime.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të vazhdojë me zbatimin e planit të veprimit 2024-2026 për tejkalimin e mosharmonizimit të ligjeve të cekura sektoriale me Ligjin për shërbime;
- ta finalizojë harmonizimin me *të drejtën* e BE-së për shërbime postare dhe të sigurojë kapacitet për monitorim dhe zbatim të rregullave të reja të tregut postar;
- të harmonizohet me *të drejtën* për njohje të ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, veçanërisht me Direktivën për njohje të kualifikimeve profesionale dhe me Direktivën për test të proporcionalitetit para miratimit të rregullativës së re për profesionet.

## **Kapitulli 4: Qarkullimi i lirë i kapitalit**

---

Maqedonia e Veriut është **përgatitur mesatarisht** në sferën e qarkullimi të lirë të kapitalit. Është arritur **progres i kufizuar** në sferën e sistemeve pagesore dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CTF).

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm, Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë dhe ta zbatojë udhërrëfyesin për përcaktim të veprimeve dhe afateve për aplikim të rregullave të BE-së për qarkullim të lirë të kapitalit, përfshirë edhe përvetësimin e tokës bujqësore;
- të vazhdojë ta zbatojë Ligjin për shërbime pagesore dhe sisteme pagesore, duke kontribuar përmbledhje më të gjerë të shërbimeve pagesore me cilësi të lartë dhe të sigurt, përfshirë edhe përmes përsheptimit të vendosjes së regjistrimit të unifikuar të llogarive bankare;
- të vazhdojë ta zbatojë legjislacionin e ri për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me të drejtën e BE-së, përfshirë edhe me monitorimin e vlerësimit të MONEYVAL të vendit nga viti 2023.

## **Kapitulli 6: E drejta e shoqërisë tregtare**

---

Vendi ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në sferën e të drejtës së shoqërisë tregtare. Megjithatë, **nuk është arritur progres** gjatë periudhës së raportit. Vendi duhet t'i përforcojë angazhimet për harmonizim të legjislacionit të saj me të drejtën e BE-së në këtë sferë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u përmbushën dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta harmonizojë legjislacionin nacional me të drejtën e BE-së për nxitjen e angazhimit afatgjat të aksionarëve,
- ta harmonizojë legjislacionin nacional me direktivat për konversione, bashkime dhe ndarje tejkufitare dhe për përdorimin e mjeteve digjitale dhe proceseve në të drejtën e shoqërisë tregtare;
- të miratojë ligje për kontabilitetin dhe për revizionin që do të harmonizohen me të drejtën më të re të BE-së në këto sfera që të përforcohet roli dhe kapaciteti i Këshillit për avancimin dhe mbikëqyrjen e revizionit.

## **Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale**

---

Maqedonia e Veriut mbetet **e përgatitur mesatarisht** në sferën e të drejtës së pronësisë intelektuale. **Nuk është arritur progres**. Nevojiten angazhime shtesë për harmonizimin e legjislacionit me të drejtën e BE-së në këtë sferë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u përmbushën dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht të:

- ta përmirësojë më tej kornizën juridike në sferën e të drejtave autoriale dhe të drejtave të ngjashme, veçanërisht përmes harmonizimit me Direktivën për menaxhim me të drejtat kolektive dhe me Direktivat për shfrytëzim të lejuar të veprave jetime, si dhe me Direktivat për transmetim online të organizatave radiodifuzive dhe ritransmetim të programeve televizive dhe të radios (SatCab II) dhe për tregun e vetëm digjital (DSM);
- ta përmirësojë më tej kornizën juridike në sferën e të drejtës së pronësisë industriale, përmes harmonizimit me Direktivën për zbatimin e të drejtës së pronësisë intelektuale dhe me Direktivën për sekrete tregtare;
- ta zbatojë Strategjinë për pronësinë intelektuale për vitin 2021-2026 dhe ta aftësojë platformën informative online për shkëmbimin e të dhënave për të drejtat e pronësisë intelektuale ndërmjet institucioneve për zbatimin e ligjit.

- ta shfrytëzojë bashkëpunimin me Zyrën e Bashkimit Evropian për pronësi intelektuale, veçanërisht në sferën e mbështetjes teknike dhe operative të harmonizimit dhe zbatimit të së drejtës së BE-së.

## **Kapitulli 8: Politika e konkurrencës**

---

Vendi është përgatitur mesatarisht në sferën e konkurrencës. **Nuk është arritur progres.**

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u përmbushën dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta harmonizojë më tej kornizën legjislative, veçanërisht legjislacionin për zbatim në sferën e ndihmës shtetërore dhe antimonopol, me të drejtën e BE-së.
- të sigurojë transparencë të plotë të ndihmës shtetërore të ndarë nga organet;
- ta përforcojë kapacitetin administrativ dhe financiar të organit nacional për konkurrencë.

## **Kapitulli 9: Shërbimet financiare**

---

Vendi është përgatitur mesatarisht në sferën e shërbimeve financiare. Është arritur **progres i caktuar**. U miratua Ligji për zgjidhjen e bankave me të cilin u emërua organ për zgjidhjen e bankave. U miratuan dy ligje kryesore, Ligji për instrumente financiare dhe Ligji për prospekte dhe detyrime për transparencë për emetuesit e letrave me vlerë, me çka u kompletua harmonizimi me Direktivën për finalitetin e barazimit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të vazhdojë ta harmonizojë rregullativën bankare me versione të rishikuara të Rregullativës për kërkesat kapitale, Direktivën për kërkesat kapitale (CRR/CRD) dhe Direktivën për rimëkëmbje dhe zgjidhje të bankave (BRRD);
- të harmonizohet me Direktivën Solvencë II, veçanërisht me shtyllën 1 dhe shtyllën 3 të kësaj direktive;
- ta përshpejtojë zbatimin e legjislacionit për rregullimin e tregjeve të kapitalit, veçanërisht me miratimin e legjislacionit për zbatimin e Ligjit për instrumente financiare dhe Ligjin për prospekte dhe detyrime për transparencë të emetuesve të letrave me vlerë, si dhe Ligjit për fonde investuese alternative, dhe t'i vazhdojë përpjekjet për harmonizim me të drejtën e BE-së për infrastrukturë të tregut financiar.

## **Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtja shëndetësore**

---

Në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbrojtjes së shëndetësisë, Maqedonia e Veriut mbetet **e përgatitur mesatarisht**. Është arritur **progres i kufizuar** në lidhje me skringun e kancerit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut veçanërisht duhet:

- të miratojë Strategji për mbrojtje të konsumatorëve 2025-2028, krijim të platformës së internetit për informim të publikut për problemet e konsumatorëve dhe përforcim të kapaciteteve për mbikëqyrje të tregut;

- të miratojë Strategji për mbrojtjen e konsumatorëve 2025-2028, krijimin e platformës së internetit për informim të publikut për problemet e konsumatorëve dhe përforcimin e kapaciteteve për mbikëqyrje të tregut;
- të sigurojë kontroll efikas të duhanit përmes zbatimit të së drejtës relevante të BE-së dhe ratifikim të Protokollit për eliminim të tregtisë së palejuar me produkte duhani dhe harmonizim të plotë me të drejtën e BE-së për barna për përdorim njerëzor dhe barna për përdorim veteriner;
- ta rrisë financimin dhe resurset njerëzore në sferën e shëndetësisë, veçanërisht për zbulimin e kancerit dhe trajtimin e sëmundjeve të rralla, në bazë të të dhënave nga regjistrat adekuate.

### KLASTERI 3: KONKURRENCA DHE RITJIA INKLUZIVE

#### Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat

Vendi është **përgatitur mesatarisht** në sferën e transformimit digjital dhe mediat. Është arritur **progres i kufizuar**, veçanërisht rritje të vogël në shërbimet elektronike që janë të disponueshme për qytetarët dhe subjektet afariste, si dhe miratimin e rregulloreve me qëllim reduktimin e shpenzimeve për vendosjen e rrjeteve të shpejta.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta finalizojë dhe ta miratojë strategjinë afatgjate për teknologji informatike-komunikuese (TIK); ta finalizojë dhe ta miratojë Strategjinë nacionale për siguri kibernetike; ta harmonizojë legjislacionin nacional me Kodin për komunikime elektronike të BE-së, me Direktivën e BE-së për reduktim të shpenzimeve për internetin me brez të gjerë, me Direktivën e BE-së për siguri të rrjeteve dhe sistemet e informimit (Direktiva NIS 2) dhe pakoja e veglave për 5G;
- ta përforcojë pavarësinë dhe kapacitetin e rregullatorit mediatik, të servisit radiodifuziv publik dhe rregullatorit për komunikime elektronike;
- ta përforcojë funksionimin e numrit për raste urgjente 112 përmes sigurimit të resurseve njerëzore adekuate dhe ta përmirësojë komunikimin ndërmjet shërbimeve për raste urgjente.

#### Kapitulli 16: Tatimimi

Maqedonia e Veriut mbetet **e përgatitur mesatarisht** në sferën e tatimimit. Është arritur **progres i kufizuar**, veçanërisht me zvogëlimin e barrës administrative për tatimpaguesit dhe themelimin e zyrës për menaxhim me reforma për mbështetje të Agjendës reformuese të Drejtorisë së të Ardhurave Publike (DAP).

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u batuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të zhvillojë sistem të ri të integruar tatimor TI për Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP), ta përmirësojë harmonizimin e saj në menaxhimin me rreziqe dhe procesin e reformave strategjike të DAP;
- të fillojë me përgatitjet për vendosjen e mekanizmit për realizim të shkëmbimit automatik të informacioneve tatimore me vendet anëtare të BE-së në pajtim me Standardin global të OECD-së.

- të fillojë me përgatitjet për arritjen e interkonektimit dhe interoperabilitetit me sistemet TI të BE-së për tatimim.

## **Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare**

---

Vendi **është ndërmjet nivelit mesatar dhe të mirë të gatishmërisë** në sferën e politikës ekonomike dhe monetare dhe është arritur **progres i caktuar**. Politika monetare prurënde ka arritur të parandalojë inflacionin. Rekomandimet nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht duke emëruar anëtarë të Këshillit Fiskal dhe u ndërmorën hapa që të sigurohet pavarësi e Bankës Popullore, veçanërisht me rishikimin e kornizës juridike që i përcakton kushtet për punësim të personelit të tij.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar dhe u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të sigurojë zbatim të plotë të Ligjit për buxhetet (BP) deri në vitin 2025, me miratimin e legjislacionit të nevojshëm për zbatim, veçanërisht për klasifikimin buxhetor dhe për deklaratën për politikë fiskale; dhe me përditësim të Manualit për projeksione makrofiskale;
- ta përforcojë pavarësinë e Bankës Popullore; ta miratojë Ligjin e ardhshëm për nëpunës administrativ dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe t'i ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin dhe operacionalizimin e kornizave makroprurënde dhe kornizave për zgjidhjen e Bankës Popullore.

## **Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi**

---

Vendi mbetet **i përgatitur mesatarisht** në sferën e politikës sociale dhe punësimit. Është arritur **progres i caktuar** me reduktim shtesë së shkallës së papunësisë dhe rritje të benefiteve për ndihmë sociale. Vazhdoi zbatimi i Skemës Garancia për të rinj në gjithë vendin. Shkalla e varfërisë u reduktua, por mbetet dukshëm e lartë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj vazhdojnë të vlejnjë në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të vazhdojë t'i zbatojë strategjisë për aktivizimin e tregut të punës për të rinjtë, për të papunët në afat të gjatë dhe individët me kualifikim të ulët, si dhe për banorët, personat me aftësi të kufizuar dhe romët, dhe të sigurojë se këto masa janë të vlerësuara në mënyrë adekuate;
- ta rrisë kapacitetin e Inspektoratit Shtetëror të Punës për zgjidhjen e çështjeve lidhur me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës; të vendosë sistem për monitorim të lëndimeve dhe rasteve të vdekjes gjatë punës, dhe ta përforcojë dialogun social bipartiak ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve;
- të vendosë kornizë për monitorim dhe vlerësim të shërbimeve sociale dhe ta avancojë reformën e mbrojtjes sociale, duke krijuar lidhje të fuqishme me iniciativat për aktivizim të të punësimit dhe ta përforcojë dialogun social.

## **Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale**

---

Vendi arriti ndërmjet **nivelit mesatar dhe të mirë të gatishmërisë** në sferën e ndërmarrjeve dhe politikës industriale. Është arritur **progres i caktuar**. U miratuan plani për konsolidim të strukturave institucionale dhe mandateve të organeve publike dhe strategjisë për formalizim të ekonomisë joformale.



Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht deri në një masë të caktuar. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta zbatojë planin për konsolidim të strukturës institucionale dhe mandatet e organeve publike;
- ta miratojë Strategjinë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) dhe ta përforcojë gatishmërinë për eksport dhe integrimin e ndërmarrjeve në zinxhirët e furnizimit përmes përforsimit të përpjekjeve për zbatim të strategjisë për promovim të eksportit;
- ta përmirësojë procesin e konsultimeve me ndërmarrjet gjatë përgatitjes së masave dhe informimit të tyre me kohë të mjaftueshme për zbatimin e kushteve.

## **Kapitulli 25: Shkenca dhe hulumtimi**

---

Vendi ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në sferën e shkencës dhe hulumtimit. Është arritur **progres i caktuar**, veçanërisht me miratimin e Strategjisë për specializim të mençur për vitin 2024-2027, vendosja e Skemës inovative rajonale të Institutit evropian për inovacione dhe teknologji (EIT RIS) dhe vazhdimi me pjesëmarrje në Horizont Evropa.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta rrisë efikasitetin e resurseve shtetërore për shkencë dhe hulumtim në pajtim me prioritetet e reja të Sferës hulumtuese evropiane;
- ta promovojë dhe rrisë pjesëmarrjen në Horizont Evropa;
- ta përshpejtojë përgatitjen dhe zbatimin e masave përfshirë në Strategjinë për specializim të mençur.

## **Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura**

---

Maqedonia e Veriut është **e përgatitur mesatarisht** në sferën e arsimit dhe kulturës. Është arritur **progres i caktuar**. Puna e Strategjisë për arsimin për vitin 2018-2025 dhe për zhvillimin e një sistemi adekuat për monitorim vazhdoi të zhvillohet ngadalë. Miratimi i ligjeve kryesore siç janë Ligji për arsimin e mesëm, Ligji për arsimin e të rriturve dhe Ligjin për arsimin dhe trajnimin profesional (ATP) u prolongua.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë Ligjin për arsimin e mesëm, për arsimin e të rriturve dhe për arsimin dhe trajnimin profesional, si dhe legjislacionin adekuat për zbatim dhe të vazhdojë me themelimin dhe operacionalizimin e qendrave rajonale për arsimin dhe trajnimin profesional;
- ta përmirësojë qasjen në arsimin cilësor për të gjithë, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga komuniteti rom; më tutje t'i zhvillojë shkathtësitë e mësimdhënësve dhe të investojë në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional;
- ta optimizojë rrjetin shkollor; t'i miratojë dhe aplikojë formulart e reja për financimin e arsimit fillor; të përgatisë dhe aplikojë formula të ngjashme për arsimin e mesëm, ATP dhe arsimin e lartë.

## **Kapitulli 29: Unioni Doganor**

---

Maqedonia e Veriut ka **nivel të mirë** në këtë sferë. Është arritur **progres i caktuar** lidhur me konsolidimin dhe mbindërtimin e sistemeve TI. Drejtoria Doganore realizon ambient plotësisht pa letër për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe vazhdojnë të vlejnjë në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta mbindërtojë komponentin e saj nacional nga Sistemi i ri i kompjuterizuar transit (SRKT) deri në fazën e pestë;
- të sigurojë harmonizim të vazhdueshëm të legjislacionit doganor me *drejtën* e BE-së dhe të vazhdojë me konsolidimin dhe aplikimin e saj të sistemeve doganore nacionale TI në pajtim me programin e punës të Komisionit për Ligjin doganor të BE-së (UCC) dhe modelet nga Plani strategjik shumëvjeçar (MASP) dhe të sigurojë mbindërtim të tyre;
- ta ratifikojë Protokollin për eliminimin e tregtisë së palejuar me produkte duhani.

#### KLASTERI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME

##### Kapitulli 14: Politika e transportit

---

Vendi **është përgatitur mesatarisht** në sferën e transportit. Në periudhën e raportit, është arritur **progres i caktuar**, veçanërisht me miratimin e Ligjit të ri për aviacion. Në trupat inspektuese sektoriale ende mungon kapaciteti administrativ dhe operativ për t'u përmirësuar.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të sigurojë kapacitet të kualifikuar operativ dhe administrativ të trupave inspektuese dhe ta zhvillojë kapacitetin e tyre për zbatim dhe të reduktohen fatkeqësitë dhe viktimat në transportin rrugor dhe hekurudhor;
- t'i zbatojë masat reformuese për lidhshmëri për rrugët dhe hekurudhën dhe t'i finalizojë marrëveshjet/protokollet e ardhshme për pikat kufitare që të lehtësohet qarkullimi i komunikacionit dhe mallrave;
- të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për sisteme multimodale dhe inteligjente të transportit (SIT) për rrugët dhe hekurudhën dhe për informacionet elektronike për komunikacionin e ngarkesës.

##### Kapitulli 15: Energjetika

---

Maqedonia e Veriut është **e përgatitur mesatarisht** në sferën e energjetikës. Është arritur **progres i caktuar** në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë, me investimet me elektrana solare dhe interkonektorë rajonale të gazit. Vendi duhet ta përshejtojë transicionin e tij ndaj energjisë së gjelbër dhe ta reduktojë varësinë nga qymyri dhe gazi.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta zbatojë Udhërrëfyesin për transicion të drejtë, veçanërisht të bëhen plotësisht operativë mekanizmat për qeverisje që janë paraparë në udhërrëfyesin;

- të sigurohen resurse të mjaftueshme njerëzore dhe kapacitete institucionale për Ministrinë e sapoformuar të Energjetikës, Minierës dhe Lëndëve të Para Minerale;
- të miratohet dhe të fillojë zbatimi i legjislacionit të nevojshëm për tregun energjetik, burimet e rinovueshme të energjisë dhe efikasitetin energjetik, në pajtim me direktivat relevenate të BE-së.

## **Kapitulli 21: Rrjetet e transevropiane**

---

Maqedonia e Veriut ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në sferën e rrjeteve transevropiane. Është arritur **progres i kufizuar** gjatë periudhës së raportit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta përforcojë kapacitetin operativ dhe teknik të të gjitha institucioneve administrative dhe institucioneve të palëve të prekura që janë përfshirë në zhvillimin e Rrjetit transevropian të transportit (TEH-T) dhe Rrjetit energjetik transevropian (TEH-E) dhe ta harmonizojë kornizën juridike me Rregullativën për rrjetin transevropian;
- të mobilizojë resurse të mjaftueshme për zbatimin e qëllimeve dhe afateve të përcaktuara në planin pesëvjeçar të punës të Komunitetit të transportit për zhvillim të zgjerimit të TEN-T;
- ta bëjë operativ Protokollin për pikën kufitare për komunikacionin hekurudhor, që është lidhur me Kosovën, ta finalizojë marrëveshjen e ndërsjellë për procedurat për pikat kufitare me Greqinë dhe ta përshpejtojë progresin në ndërtimin dhe përfundimin e lidhjes hekurudhore përgjatë korridorit 8 me Bullgarinë.

## **Kapitulli 27: Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike**

---

Maqedonia e Veriut ka **nivel të caktuar të gatishmërisë** në këtë sferë. Është arritur **progres i kufizuar** gjatë periudhës së raportit, veçanërisht në sferën e menaxhimit me mbeturina, me miratimin e Ligjit për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit për menaxhim me rrjedhat e veçanta të mbeturinës. Ende nevojiten përpjekje shtesë për zbatimin dhe ekzekutimin në të gjithë sektorët, veçanërisht në sferën e ndryshimeve klimatike ku nuk është arritur progres. Vendi është nxitur ta përmirësojë kapacitetin e tij operativ për mbrojtje dhe koordinim civil me Mekanizmin për mbrojtje civile të BE-së.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejnjë. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- t'i përforcojë dukshëm kapacitetet e saj administrative dhe kapacitetet inspektuese për zbatim dhe ekzekutim të të drejtës për mjedisin jetësor, të realizojë reforma strukturore në të gjitha sektorët dhe të sigurojë se ekziston strukturë institucionale që të sigurojë planifikim të koordinuar, strategjik për investime në mjedisin jetësor;
- ta bëjë operativ sistemin rajonal për menaxhim me mbeturinë në Rajonin lindor dhe në Rajonin verilindor;
- ta miratojë Ligjin për ndryshimet klimatike, në pajtim me kornizën e BE-së 2030, ta zbatojë Planin nacional të energjisë dhe klimës (PKEK) dhe Udhërrëfyesin për dekarbonizim të Komunitetit Energjetik, duke u fokusuar në sistemin MRVA për futjen e çmimeve të qymyrit dhe harmonizimin me BE ETS dhe ta bëjë operativ Seksionin për politika në ndryshimet klimatike të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

### **Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural**

---

Maqedonia e Veriut mbetet **e përgatitur mesatarisht** në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Është arritur **progres i mirë** gjatë periudhës së raportit, veçanërisht me miratimin e Ligjit për shërbime këshillimore në bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe me progresin në zbatimin e IPARD II dhe IPARD III.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të miratojë kornizë juridike për harmonizim shtesë me të *drejtën* e BE-së në sferën e pagesës për mbështetje të bujqësisë, organizim të tregut të përbashkët, politikë për cilësi dhe bujqësi organike;
- të sigurojë interoperabilitet të elementeve të ndryshme nga IAKS së bashku me verifikimin e saktësisë së të dhënave dhe transferim të Regjistrit të vetëm të ekonomive bujqësore dhe Sistemit për identifikim të parcelave tokësore (SIPT) të Agjencisë pagesore;
- t'i përmirësojë kapacitetet administrative në strukturat operative të Instrumentit për ndihmë paraaderuese për zhvillim rural (IPARD) që të sigurojë zbatim të qëndrueshëm të programit IPARD III.

### **Kapitulli 12: Siguria e udhqimit, politikës veterinerë dhe fitosanitare**

---

Maqedonia e Veriut ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në sferën e sigurisë së ushqimit dhe politikës veterinerë dhe fitosanitare. Është arritur **progres i caktuar** në periudhën e raportit, veçanërisht në kontrollin e sëmundjeve të kafshët, kontrollin e shëndetit të bimëve dhe zbatimin e masave për mënjanim të dëmtuesve, në bazë të rezultateve nga programet për mbikëqyrjen fitosanitare.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u përmbushën dhe prandaj vazhdojnë të vlejné. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë draft-ligjin për kryerje të kontroleve dhe Ligjin e ri për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve dhe të vazhdojë t'i përafrojë rregullat nacionale me legjislacionin e BE-së për mirëqenie të kafshëve;
- ta përforcojë kapacitetin për analizë të të dhënave dhe t'i përmirësojë strukturat për zbatim të Ligjit për sigurinë e ushqimit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- të zbatojë masa për përdorim të qëndrueshëm të pesticideve.

### **Kapitulli 13: Peshkataria dhe akuakultura**

---

Maqedonia e Veriut është **përgatitur mesatarisht** në sferën e peshkatarisë dhe akuakulturës. Është arritur **progres i mirë** gjatë periudhës së raportit, me miratimin e Ligjit të ri për peshkatari dhe akuakulturë në pajtim me të *drejtën* e BE-së për standarde tregtare, masa strukturore dhe ndihmë shtetërore, por edhe vendosje të dispozitave themelore në pajtim me Rregullativën e BE-së për ngjالات.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe vazhduan të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta miratojë legjislacionin për zbatim të standardeve tregtare, informacionet për konsumatorët, mundësinë për monitorim dhe organizatat e prodhuesve, si dhe Planin nacional shumëvjeçar strategjik për akuakulturë;
- ta përmirësojë sistemin për mbledhje të të dhënave dhe njoftim, përmes vendosjes së kornizës për të dhënat për mbledhje të të dhënave për peshkatori dhe akuakulturë, dhe përfshirje të informacioneve për peshkim të ngjalës evropiane edhe në peshkim rekreativ dhe komercial, si dhe analizë të pasojave të saj.
- t'i përmirësojë kontrollet e menaxhimit me fondin e peshkut dhe peshkimit ilegal, të paraqitur dhe të parregulluar (PIPP) me futjen e sistemit për certifikim të peshkimit.

## **Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore**

---

Maqedonia e Veriut është e **përgatitur mesatarisht** në sferën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. U arrit **progres i kufizuar** gjatë periudhës së raportit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- ta përplotësojë kapacitetin e saj institucional, administrativ dhe teknik për menaxhim me fondet e BE-së me miratimin e politikës së përgjithshme për ruajtjen e të punësuarve, përf forcimin e kapacitetit, përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve nga BE-ja dhe nga revizioni dhe përf forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional;
- ta përforcojë investimin publik me miratimin e Rregullores për menaxhim me investime publike dhe Ligjit për partneritet privato-publik;
- ta përshpejtojë procesin e decentralizimit përmes kornizave të besueshme financiare për komunat dhe përf forcimit të dialogut për zhvillim rajonal.

## **Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore**

---

Përgatitjet nga ky kapitull janë në **fazë të hershme**. Është arritur **progres i kufizuar** gjatë periudhës së raportit. Llogaritë nacionale dhe për llogaritjet të bazuara në të ardhurat bruto-nacionale duhet të harmonizohen më tej me të drejtën e BE-së. Të gjithë deklaratat doganore dhe dokumentet e akcizës tani përpunohen në formë elektronike, por ende nuk është vendosur struktura e nevojshme institucionale për funksionim efikas të sistemit të resurseve vetjake.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan plotësisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- t'i përmirësojë bazën juridike dhe mjetet metodologjike për sistemin e resurseve personale;
- të vazhdojë me harmonizimin e të dhënave për llogaritë nacionale me SELL 2010 dhe përmirësimin e gjithëpërfshirjes së transferimit të të dhënave në Eurostat;
- t'i përforcojë kapacitetet administrative dhe mekanizmat për koordinim për palët e prekura kryesore në sistemin.

## Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme

---

Vendi ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në sferën e marrëdhënieve të jashtme dhe arriti **progres të kufizuar** gjatë periudhës së raportit, veçanërisht në zbatimin e protokolleve të CEFTA-s dhe në përpjekjet për ta zhvilluar sistemin për kontroll të eksportit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe, prandaj, vazhdojnë të vlejné në masë të madhe. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut veçanërisht duhet:

- të vendosë kornizë juridike për politikën për bashkëpunim dhe zhvillim ndërnacional, si dhe ndihmë humanitare ndaj vendeve që nuk janë anëtarë të BE-së, në pajtim me politikën dhe parimet e BE-së.
- Të vazhdojë t'i realizojë detyrimet nga Plani i veprimit për PPB për vitin 2021-2024 dhe t'i realizojë veprimet sipas Planit të ri të veprimit për vitin 2025-2028, më tutje ta zbatojë Protokollin 6 të CEFTA-s për tregti me shërbime, dhe t'i ndër marrë hapat e nevojshme për zbatimin e Protokollit 7 të CEFTA-s për zgjidhjen e kontesteve.

## Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes

---

Maqedonia e Veriut ka **nivel të mirë të gatishmërisë** në sferën e politikës së përbashkët të jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes. Është arritur **progres i mirë** sepse vendi e mban evidencën e saj për harmonizim të plotë me deklaratat adekuate të Përfaqësuesit të lartë në emër të BE-së dhe Vendimet relevante të Këshillit, përfshirë edhe masat restriktive të BE-së në lidhje me agresionin rus ndaj Ukrainës. Maqedonia e Veriut vazhdoi të marrë pjesë në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin me kriza. Vendi filloi negociatat për partneritet të sigurisë dhe mbrojtjes me BE-në në pranverë 2024.

Rekomandimet nga viti i kaluar u zbatuan në masë të madhe dhe vazhdojnë të vlejné pjesërisht. Në vitin e ardhshëm Maqedonia e Veriut duhet veçanërisht:

- të mbajë harmonizim të plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së;
- të vazhdojë t'i përforcojë kapacitetet e saj për zbatim dhe ekzekutim të sanksioneve të vendosura;
- të bëjë përpjekje për harmonizim të legjislacionit në sferën e armës së vogël dhe të lehtë.

### 1.3. GJENDJA AKTUALE ME NEGOCIATAT ADERUESE

Pas Konferencës së parë Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, Komisioni filloi menjëherë shqyrtimin analitik të së drejtës së BE-së – procesin e “skriningut”. Pas dorëzimit të Raportit të Skriningut për klasterin 1 në korrik 2023, në vjeshtën e vitit 2023, Këshilli i prezantoi Maqedonisë së Veriut kushtet për hapjen e negociatave të anëtarësimit për klasterin e parë (Vlerat Themelore) pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese. Si përgjigje, Qeveria miratoi udhërrëfyesit për sundimin e ligjit dhe për reformat në administratën publike. Miratimi i Planit të Veprimit për mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave dhe komuniteteve është ende në proces. Raportet e Skriningut për Klasterin 2 – Tregu i Brendshëm iu prezantuan Këshillit në maj 2024, ku pasuan nga raportet e shqyrtimit për Klasterin 6 – Marrëdhëniet e jashtme dhe Klasteri 3 – Konkurrueshmëria dhe rritja inkluzive në tetor 2024.

## 2. KLASTERI 1: VLERAT FUNDAMENTALE TË PROCESIT TË ANËTARËSIMIT

### 2.1. FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE DHE REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE


#### 2.1.1. Demokracia

Funksionimi i institucioneve demokratike është kryesisht i kënaqshëm. Situata u polarizua në periudhën para zgjedhjeve në prill dhe maj 2024.

#### Zgjedhje

Raundi i parë i **zgjedhjeve presidenciale** u mbajt më 24 prill, ndërsa raundi i dytë më 8 maj. **Zgjedhjet parlamentare** u mbajtën më 8 maj. Sipas konstatimeve dhe konkluzioneve të ODIHR-së së OSBE-së, zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale ishin konkurruese, ndërsa liritë themelore u respektuan. Legjislacioni zgjedhor jep kornizë adekuate për mbajtje të zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, rregullat për fushatën, qasja në mediat dhe shpërndarja e financimit shtetëror nuk janë rregulluar në mënyrë adekuate. Parregullsitë e vazhdueshme, mangësitë dhe paqartësitë e kompromentojnë sigurinë juridike dhe kërkojnë revizion të Kodit Zgjedhor.

Vetëm disa javë para zgjedhjeve, Kuvendi miratoi me procedurë të përspejtuar disa ndryshime në Kodin Zgjedhor. Megjithatë, ata nuk u përqendruan në një numër



të madh rekomandimesh kyçe të theksuara nga ODIHR dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës ose nga grupi i punës ndërmjet agjencive të formuar nga Ministria e Drejtësisë në maj 2023. Rekomandimet e tilla përfshinë: (i) rishikimi i Kodit Zgjedhor përmes konsultimeve gjithëpërfshirëse; (ii) miratimi i masave për rritje të transparencës së financimit të partive dhe fushatave; (iii) rishikimi i rregullave për shpërndarjen e reklamimit politikë me pagesë; (iv) përcaktimi i procedurave të qarta për mandatin dhe emërimin e anëtarëve të KSHZ-së; dhe (v) eliminimi i kufizimeve që pengojnë zgjidhjen efektive të kontesteve zgjedhore.

#### Kuvendi

Përbërja e 10-të e Kuvendit, e cila u shpërnda në maj, ishte e para që nga viti 2006 që përfundoi mandatin e saj 4-vjeçar. Kuvendi i ri u konstitua dhe kryetari i Kuvendit u zgjodh më 28 maj. Trupat e tij të punës, disa me kompetenca të përshtatura për ministrinë dhe

delegacionet e sapoformuara ose të ristrukturuara, u krijuan në korrik. Në gusht, u themelua Komisioni i ri i përkohshëm i Kuvendit për të monitoruar përfaqësimin e duhur dhe të drejtë të qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve. Në korrik u themelua Grup ndërpartiak kundër korrupsionit. Kryetari i Kuvendit mbijetoi interpelancën së 3 shtatorit.

Në nëntor 2023, Kuvendi miratoi **Rregullore të re të punës** të bazuar në një shkallë të lartë konsensusi, duke përmbytur angazhimin kryesor të procesit "Dialogu Zhan Mone". Për miratimin e programit vjetor për vitin 2024 dhe planit financiar dhe investues të kanalit të TV-së të Kuvendit dominoi frymë të konsensusit. Të gjitha partitë e mbështetën Ligjin për Strategjinë Nacionale për Zhvillim. Vlerësimi afatmesëm i Planit të Veprimit për promovimin e ndjeshmërisë gjinore të Kuvendit 2022 - 2024 konfirmoi se masat janë zbatuar me sukses. Nëntë grupe ndërpartiake vazhduan punën e tyre aktive si dhe Komiteti për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive. Në gusht, Kuvendi i ri miratoi Planin Strategjik 2025-2029.

Nuk u arrit dy e treta e shumicës në Kuvendin që të miratohet propozimi për **ndryshimin e Kushtetutës** të përfshihen edhe gjashtë komunitete në preambulën dhe në dy nene të Kushtetutës, dhe atë: populli bullgar, populli kroat, populli malazez, populli slloven, populli hebre dhe egjiptian. Gjatë mandatit të përbërjes së 10-të të Kuvendit nuk u arrit konsensus për miratimin e ligjeve të rëndësishme për rregullimin e reformës në administratën publike, as për përmirësimin e statusit të zyrës së Avokatit të Popullit. Partia e atëhershme opozitare VMRO-DPMNE propozoi ose mbështeti disa propozime ligjore dhe ndonjëherë siguronte kuorum, ndërsa opozita shqiptare bojkotonte disa seanca plenare në shenjë proteste kundër zgjedhjes së prolonguar të anëtarit të ri të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Mbikëqyrja** e Kuvendit mbi pushtetin ekzekutiv vazhdoi me seanca mujore për pyetje deputetësh. Kuvendi në ikje mbajti tre diskutime publike. Kuvendi zgjodhi dy gjykatës të Gjykatës Kushtetuese, Prokuror publik, anëtarë të Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, të Komisionit për Mbrojtje të Konkurrencës dhe Agjencisë për Komunikime Elektronike.

**Procesi i miratimit të ligjeve** shënoi rritje të përdorimit të procedurave të shkurtuara, përfshirë edhe për propozimi-ligjet e propozuara nga deputetët nga përbërja e 10-të e Kuvendit. Opozita e kritikoi Qeverinë dhe votoi kundër përdorimit joadekuat të procedurës së përshpejtuar me "flamur evropian" për propozime që nuk janë të lidhura me harmonizimin e legjislacionit me të drejtën e BE-së. Përdorimi i procedurës me "flamur evropian" doemos duhet të jetë konsekuent, lidhur me ligjet e orientuara fillimisht ndaj harmonizimit të legjislacionit nacional me të drejtën e BE-së dhe në bazë të konsultimeve gjithëpërfshirëse, përfshirë edhe me Komisionin Evropian. Përdorimi i procedurave të shkurtuara duhet të kufizohet. (*Shih 2.1.2. Reformë në administratën publike*).

## **Integrimi në BE**

Qeveria e re formoi Ministrinë për Çështje Evropiane, të udhëhequr nga ministri i Çështjeve Evropiane. Paraprakisht, Sekretariati për Çështje Evropiane, i udhëhequr nga zëvendëskryeministri për çështje evropiane, e koordinoi me sukses punën e organeve të administratës shtetërore dhe organeve tjera gjatë procesit të skringut, që përfundoi në dhjetor. Megjithatë, Sekretariati nuk i kishte resurset e nevojshme që të përballet me sfidat lidhur me procesin e integritimit në BE. Drejtoria për BE në Ministrinë e Punëve të Jashtme ndihmon në koordinimin e marrëdhënieve me institucionet e BE-së. Strukturë e ngjashme ekziston edhe në Kuvend, me Këshillin Nacional për Eurointegritime dhe Komisioni për Çështje Evropiane. Duhet të përkufizohen më mirë kompetencat adekuate të këtyre dy organeve. Organet e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociacion mblidhen rregullisht.

Nuk u përpunuan raportet nga monitorimi i zbatimit të Programit të fundit nacional për miratimin e të drejtës së BE-së (NPAA) të miratuar në qershor 2021. NPAA duhet të harmonizohet plotësisht me programin vjetor dhe institucional të punës të Qeverisë. Qeveria



komunikoi rregullisht me publikun për procesin e skringut dhe në përgjithësi për procesin e integritetit në BE.

## **Qeverisja**

Qeveria kalimtare e ngarkuar për organizimin e zgjedhjeve, të mbështetur nga 65 deputetë, e mori funksionin më 28 janar.

Më 23 qershor 2024, Kuvendi e miratoi **koalicionin qeveritar** të përbërë nga VMRO-DPMNE<sup>6</sup>, VLEN<sup>7</sup> dhe ZNAM<sup>8</sup>, me 77 deputetë që votuan „pro“, 22 „kundër “ dhe pa të përmbajtur. Deputetët<sup>9</sup> e koalicionit „Fronti Evropian“ të udhëhequr nga BDI nuk morën pjesë në votimin. Qeveria është formuar nga pesë zëvendëskryeministra dhe 18 ministra. Ministritë e sapoformuara ose të ristrukturuara do të bëhen funksionale nga shtatori 2024. Nuk është bërë progres në reformën e **vetëqeverisjes lokale**. Shqyrtimi i prolonguar i sistemit të decentralizimit, së bashku me sfidat ekonomike me të cilat përballen komunat, ndikuan negativisht në cilësinë e shërbimeve lokale. Qeveria e re duhet të ripërtërijë urgjentisht dhe në mënyrë aktive dialogun ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes për të përmirësuar kornizën rregullatore dhe financiare në përputhje me Programin për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021-2026 dhe Planin e Veprimit për vitin 2024-2026. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për të ndërtuar një bazë financiare të qëndrueshme dhe të parashikueshme për qeverisjen lokale.

**Gjendja ndëretnike** mbeti në përgjithësi stabile. Marrëveshja kornizë e Ohrit nga viti 2001, që e kultivon karakterin multietnik të shoqërisë, vazhdoi të zbatohet.

## **Shoqëria civile**

Organizatave civile (OC) vazhdojnë të punojnë në mjedis të volitshëm dhe kanë mundësi të informohen për dhe të marrin pjesë në Këshillin për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile, Këshillit Nacional për Eurointegritet dhe Këshillit për partneritet të hapur qeveritar. Ekziston nevojë urgjente për t'u zhvilluar një qasje konsekuente për përfshirje të organizatave civile në krijimin e politikave në nivel nacional dhe lokal, dhe përsëri të ndërtohet besimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve të interesuara dhe përsëri të aktivizohet ky kanal i rëndësishëm.

Së bashku me transparencën për financim shtetëror të OC, zbatimi i duhur i kornizave ekzistuese ligjore dhe financiare kërkon strukturë të qartë institucionale për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe zbatim dhe monitorim të Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2022-2024.

## **Mbikëqyrja civile mbi sektorin e sigurisë dhe zbulimit**

Komisionet e Kuvendit që i mbikëqyrin shërbimet e sigurisë dhe zbulimit mbajtën takime në pajtim me përgjegjësitë e tyre adekuate. Duhet të plotësohen të gjitha vendet vakante në Njësinë speciale për hetim dhe ndjekje të veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe nga pjesëtarë të policisë së burgut. Përbërja e Mekanizmit për kontroll civil të Zyrës së Avokatit të Popullit është kompletuar me përfaqësues të zgjedhur të shoqatave të qytetarëve. Që të mundësohet funksionimi i rregullt i mekanizmit, duhet të sigurohen resurse financiare adekuate, pajisje dhe zyra. Megjithëse Ligji për monitorim të komunikimeve u ndryshua në korrik 2023, konfiguracioni i Këshillit për mbikëqyrje civile ende

---

<sup>6</sup>Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas.

<sup>7</sup> Koalicioni politik i formuar nga parti të ndryshme politike që e përfaqësojnë komunitetin etnik shqiptar.

<sup>8</sup> Për Maqedoninë Tonë.

<sup>9</sup> Bashkimi Demokratik për Integritet.

nuk ka përfunduar me personat e nevojshëm profesional teknik. Prandaj, Këshilli nuk është operativ.

## 2.1.2. Reforma në administratën publike

### Korniza strategjike për reformë në administratën publike

Është vendosur Korniza strategjike për reformë në administratën publike. Cilësia e Strategjisë për reformë në administratën publike (RAP) është në masë të madhe e kënaqshme, dhe efikasiteti i saj është shumë e kufizuar për shkak të zbatimit shumë të ngadalshëm.

**Strategjia për reformë në administratën publike 2023-2030** dhe plani i veprimit shoqëruar u miratuan në korrik 2023. Cilësia dhe fushëveprimi i strategjisë janë të përshtatshme. I mbulon të gjitha fushat kryesore të reformës, vendos vlerë fillestare të qartë dhe synime dhe objektiva të qarta, dhe identifikon sfidat e politikave. Mbështetja politike, udhëheqja, mbikëqyrja dhe menaxhimi i reformave të administratës publike në të gjithë qeverinë mbeti e pamjaftueshme, gjë që u dëmtua më tej nga koordinimi i dobët ndërmjet Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) dhe Ministrisë së Financave, si dhe ndryshimet e shpeshta të udhëheqësisë së MSHIA-së. Ministria e re e Administratës Publike (MAJ), e formuar pas riorganizimit të MSHIA-s në fillim të korrikut 2024, vazhdon pa burime të mjaftueshme njerëzore dhe mbështetje politike për të nxitur reformat në nivel teknik. Strukturat e monitorimit dhe menaxhimit nuk funksionojnë plotësisht dhe në mënyrë efektive.

Shkalla e zbatimit të masave për RAP dhe MFP vazhdon të jetë e ulët. Raportet për monitorim publikohen shumë vonë. Vetëm një e treta e të gjitha shpenzimeve për aktivitetet e të dyja strategjive vlerësohet se janë financuar nga buxheti shtetëror.

### Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

Janë vendosur zhvillimi dhe koordinimi i politikave.

Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme që të qartësohen përgjegjësitë në institucionet që **i krijojnë politikat**, që të sigurohet funksionimi i tyre i rregullt dhe të racionalizohet njoftimi, përfshirë edhe përforsimi i rolit të Sekretariatit të përgjithshëm. **Politika e bazuar në dëshmi dhe zhvillimi i legjislacionit** janë vetëm të siguruara pjesërisht. Cilësia dhe ndikimi i vlerësimeve të ndikimit të rregullativës dhe **konsultimet publike** janë shumë të kufizuara. Rreth gjysma e të gjitha 123 ligjeve të miratuara nga Kuvendi në vitin 2023 u miratuan në procedurë të shkurtuar. Përdorimi i procedurës me “flamur evropian” nuk është konsekuent. Në një numër të madh të rasteve, ajo nuk u lidh me ligje që janë parimisht të orientuara në harmonizimin e legjislacionit nacional për vlerësim të sistemit *eks post* të ligjeve dhe politikave.

Sa i përket **kontrollit publik mbi punën e Qeverisë**, Plani Vjetor i Punës i Qeverisë dhe raportet vjetore nuk janë të disponueshme për publikun. Janë zbatuar vetëm rreth 40% e zërave të planifikuar në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2023 dhe vetëm 22% e propozim-ligjeve. Një numër i madh zërash janë shtuar në rendin e ditës të mbledhjeve të qeverisë në momentin e fundit. Rendi i ditës i seancave të qeverisë nuk publikohet para mbajtjes së mbledhjeve. Procesverbalet dhe vendimet e seancave të qeverisë nuk publikohen sistematikisht në internet.

### Menaxhimi me financat publike

**Menaxhimi me financat publike** është vendosur në masë të madhe, por duhet të përmirësohet më tej.

Në dhjetor 2023, Ministria e Financave realizoi shqyrtim afatmesëm të Programit të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (PRMFP) 2022-2025 dhe formuloi një program të ri reformash që mbulon periudhën 2024-2027, i cili ende nuk është miratuar zyrtarisht nga Qeveria. Shkalla e zbatimit të PRMFP 2022-2025 ishte mjaft e ulët. PRMFP e re 2024-2027 është e strukturuar rreth tetë shtyllave, duke mbuluar dobësitë kryesore të identifikuar në vlerësimet ndërnacionale. Kapaciteti institucional i Ministrisë së Financave vazhdon të jetë i kufizuar, pasi ajo përballlet me sfida në tërheqjen dhe mbajtjen e kuadrove me aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme.

Miratimi i legjislacionit për zbatim që e shoqëron Ligjin për Buxhetin dhe themelimi i Sistemit Informativ të Integruar të Menaxhimit Financiar (SIIMF) janë prolonguar dukshëm. Është arritur progres i caktuar në fushën e menaxhimit të investimeve publike (MIP) me formimin e Sektorit të ri për MIP në Ministrinë e Financave. Besueshmëria buxhetore është forcuar falë krijimit dhe hyrjes në funksion të Këshillit Fiskal, përmirësimit të strategjisë fiskale dhe monitorimit më të mirë të rreziqeve fiskale.

Ligji për Buxhetet vendosi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor si parim dhe prezantoi një detyrim për përfituesit e buxhetit që të dorëzojnë një deklaratë buxhetore gjinore për politikën me implikime të mundshme gjinore. Megjithatë, një buxhet efektiv i përgjegjshëm gjinor do të kërkojë forcimin e diskutimeve mbi politikën gjatë përgatitjes së buxhetit, zhvillimin e mëtejshëm të klasifikimeve buxhetore dhe zgjerimin e numrit të treguesve të ndara sipas gjinisë.

Ministria e Financave vazhdoi përpjekjet për përmirësimin e transparencës buxhetore duke publikuar të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet e institucioneve publike, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve shtetërore në baza tremujore. Transparenca buxhetore në Maqedoninë e Veriut vazhdon të jetë e kufizuar, siç tregohet nga një rezultat i ulët prej 35 në Anketën e fundit për buxhet të hapur, shumë nën mesataren globale prej 45. Ministria e Financave duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të rritur pjesëmarrjen e publikut në çdo fazë të përgatitjes, ekzekutimit dhe raportimit për buxhetin.

#### Shërbimi publik dhe menaxhimi me resurset njerëzore

Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore mbeten të pamjaftueshëm. Politizimi i shërbimit publik dëmton vazhdimisht zbatimin e konsekuent të dispozitave për punësim të bazuar në merita dhe proceseve transparente dhe e redukton më tej besimin tek administrata dhe puna e saj. Ndryshimi në strukturat qeverisëse pas zgjedhjeve parlamentare të majit 2024 nuk solli asnjë përmirësim në këtë drejtim pasi u ndryshuan një sërë postesh drejtuese të nivelit të mesëm dhe shumë u shkarkuan.

Maqedonia e Veriut nuk e miratoi Ligjin e rishikuar të shumëpritur për nëpunësit administrativë dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik. Këto ligje synojnë të sigurojnë punësim të bazuar në merita dhe promovime dhe shkarkime të drejta. Që nga miratimi i tyre në vitin 2014, ligjet aktuale për shërbimin shtetëror kanë pësuar ndryshime të shumta, duke çuar në zbatim jokonsistent. Gjithashtu, rregullat kontradiktore në ligjet sektoriale lejuan që disa punonjës të përjashtohen nga fusha e veprimit të Ligjit për nëpunësit administrativë.

Pavarësisht ekzistimit të rregullave për kryerjen e vlerësimit të performancës, ai nuk kryhet në mënyrë sistematike ose i përshtatshëm për qëllimin. Transparenca sipas bazave për largimin e nëpunësve shtetërorë është e pamjaftueshme dhe nuk jepën të dhëna për largimin e kuadrove udhëheqës dhe joudhëheqës. Ende nuk është siguruar monitorimi adekuat i rekomandimeve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për përmirësimin e procedurave të punësimit. Administrata përballlet me sfida serioze në tërheqjen dhe mbajtjen e kuadrit të kualifikuar të trajnuar. Nismat sporadike për rritjen e pagave në disa ministri apo autoritete kanë rritur fragmentimin e **sistemit të shpërblimit** dhe në disa raste janë kundërshtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Lëvizja e vazhdueshme e stafit që punon në

menaxhimin dhe zbatimin e fondeve të BE-së dëmton efektivitetin e këtyre masave. Shumë pozita të larta vazhdojnë të plotësohen nga ushtrues detyre. Një numër i madh i bartësve të vendeve udhëheqëse u ndryshuan para përfundimit të mandatit të tyre dhe u zëvendësuan nga ushtrues detyre pas zgjedhjeve parlamentare në maj 2024. Numri i kontratave me afat të caktuar dhe kontratave të punës vazhdon të jetë i lartë, pa një sistem të vendosur për monitorimin e numrit efektiv dhe kohëzgjatjes së tyre në nivel të të gjitha institucioneve. Shumica e institucioneve tani përdorin sisteme informacioni për menaxhimin e burimeve njerëzore. Sipas raporteve të Entit Shtetëror për Revizion, një numër i caktuar punonjësish në shërbimet publike marrin pagë edhe pse nuk kanë detyrë formale dhe nuk duhet të paraqiten në punë. Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive vazhdoi të punësojë staf dhe planifikon të sistematizojë punonjës të rinj në institucione të ndryshme.

Gratë përbëjnë 56.8% të të gjithë punonjësve në shërbimet publike sipas Regjistrimit të punonjësve në sektorin publik. Këtu nuk përfshihen institucionet si ushtria dhe disa agjenci për zbatimin e ligjit. Sa i përket **përsosjes profesionale**, nuk janë marrë masa për krijimin e një baze të të dhënave të centralizuara për mbledhjen e informacioneve për të gjitha trajnimet. Legjislacioni i sinjalizuesve është i kënaqshëm. Asnjë informacion nuk ishte i disponueshëm për mbrojtjen e sinjalizuesve në vitin 2023.

### Llogaridhënia e administratës

Ende duhet të përmirësohet llogaridhënia e administratës

Për sa i përket llogaridhënies, Maqedonia e Veriut miratoi disa ndryshime në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore në qershor 2024. Progresi duhet të vazhdojë në revizionin e ligjit, si dhe në zbatimin e përgjithshëm të reformës. Riorganizimi i tre sistemeve pilot ministrore është prolonguar disa herë që nga viti 2019, kur filloi reforma. Një numër i madh organesh mbeten përgjegjës para Kuvendit, por puna e tyre nuk ndiqet në praktikë. Delegimi i autorizimeve vendimmarrëse në pozitën udhëheqëse të nivelit të mesëm është ende i kufizuar si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal të Qeverisë.

Legjislacioni për **të drejtën e qytetarëve për qasje në informacionet me karakter publik** është vendosur, por përgjigja ndaj kërkesave për informacione me karakter publik dhe zbulimi proaktiv i informacioneve duhet të inkurajohet më tej. Më pak informacione janë të disponueshme në faqet e internetit të institucioneve shtetërore, portali i hapur i qeverisë nuk përditëson informacionet, ndërsa publikimi i mbledhjeve dhe agjendave të qeverisë vonohet në masë të madhe. Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik vazhdoi t'i përpunojë në kohë ankesat, duke vërejtur një rritje të caktuar të ankesave për heshtjen e administratës. Debati në Kuvend për raportet e Avokatit të Popullit dhe Entit Shtetëror të Revizionit ishte shumë i kufizuar në vitin 2023, dhe gjetjet dhe rekomandimet duhet të ndiqen më sistematikisht. Nuk ka progres në të drejtat e qytetarëve për administrim të mirë. Edhe pse korniza ligjore është e kënaqshme, kontestet administrative edhe më tutje prolongohen në mënyrë joracionale. Procedurat ankimore mbeten të ndërlikuara dhe të gjata, ku shumica e vendimeve bazohen në të menduarit procedural dhe jo në bazueshmëri. Me legjislacionin përcaktohen **të drejtat e qytetarëve për të kërkuar kompensim për dëmet** dhe përgjegjësinë e organeve publike në rastet e veprimit të gabuar.

### Sigurimi i shërbimeve për qytetarët dhe për subjektet afariste

Sigurimi i shërbimeve për qytetarët dhe subjektet afariste duhet të përmirësohet më tej.

Portali nacional për e-shërbime (<https://uslugi.gov.mk/>) është në funksion. Ai ofron informacione dhe shërbime praktike administrative në internet në tre gjuhë dhe u shërben njerëzve me nevoja të veçanta. Megjithatë portali u përditësua me vetëm disa shërbime të reja elektronike, shërbimet e kërkuara më shpesh nuk janë ende të disponueshme online.

135 shërbimet e reja të shumëpritura për qytetarët dhe subjektet afariste ende nuk janë konfiguruar në portal. Portali aktualisht ka 292,179 përdorues, por numri i transaksioneve mujore është ende i ulët (2,070 kërkesa). Po ashtu, planifikimi i dobët dhe organizimi i pamjaftueshëm i zëvendësimit të dokumenteve personale me emrin e mëparshëm kushtetues të shtetit shkaktoi pakënaqësi dhe mosbesim të madh te qytetarët. Përdorimi i Regjistrisë të Popullsisë është ende i kufizuar. Maqedonia e Veriut duhet të sigurojë pajtueshmëri me Kornizën Evropiane për Interoperabilitet (revizioni i fundit në vitin 2017) dhe me Ligjin për Evropë Interoperabile (2022). Korniza për Interoperabilitet aktualisht përdoret nga vetëm disa institucione, megjithëse numri i transaksioneve është rritur. Meqenëse legjislacioni nacional është harmonizuar me Rregulloren eIDAS 2014, vendi duhet të ndërmarrë hapa për të harmonizuar ligjet e tij me versionin e rishikuar të Rregullores 2024, duke vendosur kornizën e re të identitetit digjital të BE-së, që përfshin krijimin e një portofoli nacional të identitetit digjital. Mjetet ekzistuese aktuale për certifikata për identifikim elektronik dhe nënshkrim elektronik janë të ndërlikuara dhe shpesh kërkojnë ndryshim të akreditivave, të cilat nuk janë as falas për qytetarët dhe as veçanërisht të përshtatshme për përdoruesit.

Nuk është bërë përparim në **thjeshtimin e procedurave administrative**. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative është në përputhje me parimet e administrimit të mirë, por nuk zbatohet sistematikisht në të gjithë administratën, dhe harmonizimi i ligjeve të veçanta me Ligjin ende nuk ka përfunduar.

## **2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT FUNKSIONALE**

### **2.2.1. Kapitulli 23: Sistemi i drejtësisë dhe të drejtat fundamentale**

*Vlerat themelore të BE-së përfshijnë sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Me rëndësi jashtëzakonisht të madhe janë ekzistimi i sistemit efektiv (të pavarur, me cilësi të lartë dhe efikas) të drejtësisë dhe lufta efikase kundër korrupsionit, si dhe respektimi i të drejtave fundamentale në ligjin dhe në praktikë.*

#### **Funksionimi i sistemit të drejtësisë**

##### Dokumenti strategjik

Qeveria miratoi Strategjinë Sektoriale Zhvillimore për Sistemin e Drejtësisë 2024-2028 dhe Planin e Veprimit shoqëruar në dhjetor 2023. Strategjia është e strukturuar në pesë fusha prioritare: gjyqësori dhe prokuroria publike; institucionet e sistemit të drejtësisë; profesionet e pavarura dhe shërbimet publike; reforma e Gjykatës Kushtetuese; dhe reforma në fusha të veçanta ligjore (penale dhe civile). Edhe pse u miratua me një vonesë të konsiderueshme, ai bazohet në një vlerësim të strategjisë së mëparshme dhe konsultimeve me komunitetin juridik dhe OC. Plani i veprimit ka afate reale kohore dhe veprimet e tij ndjekin një radhitje logjike, por nuk është buxhetuar. Plani i veprimit përfshin tre fusha përveç gjyqësorit: reforma në Kodin Zgjedhor; reforma në Ligjin për financimin e partive politike; dhe miratimi i Ligjit për përfundim të drejtë. Këshilli për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, i themeluar në mars 2024, nuk është mbledhur. Janë bartur aktivitete të ndryshme të përcaktuara nga Strategjia e mëparshme për reforma në sektorin e drejtësisë për periudhën 2017-2022. Nuk është bërë progres në zbatimin e Strategjive për menaxhim me resurset njerëzore 2020 në gjykatat dhe prokuroritë publike.

##### Trupat udhëheqës

Trupat udhëheqëse janë vendosur, por duhet t'i përforcojnë më tej përpjekjet e tyre për të mbrojtur pavarësinë, integritetin dhe profesionalizmin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

Në janar 2024, Këshilli Gjyqësor zbatoi me shpejtësi vendimin e Gjykatës Administrative për kthimin e kryetarit të shkarkuar në mënyrë të paligjshme. Më 1 mars 2024, Këshilli Gjyqësor

miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Misionit vlerësues nga viti 2023, në kuadër të kompetencave të Këshillit. Në përputhje me planin, më 29 maj 2024, Këshilli miratoi ndryshimet në Rregulloren e Punës dhe Rregulloren për mënyrën e renditjes së kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, ndër të tjera duke kërkuar nga anëtarët e Këshillit të arsyetojnë vendimet. Organet do të duhet të forcojnë zbatimin e rekomandimeve të Misionit të Vlerësimit, në lidhje me revizionin e kornizës legislative për të përmirësuar funksionimin dhe pavarësinë e Këshillit Gjyqësor.

Strategjia e re e komunikimit të Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024-2028), e miratuar në qershor 2024, fokusohet në forcimin e besimit të publikut në gjyqësor. Këshilli Gjyqësor ka ndërmarrë hapa për të rritur transparencën, siç është publikimi i orarit të seancave, procesverbaleve të mbledhjeve, vendimeve, raporteve dhe dokumenteve të tjera përkatëse në faqen e tij të internetit dhe ka filluar transmetimin e seancave online. Praktika e brifingjeve të rregullta dymujore mediatike filloi në prill 2024.


Hezitimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për të aplikuar për vendet e lira në Këshillin Gjyqësor, ndërsa Këshilli nuk e ka korrigjuar shkarkimin e paligjshëm të kryetarit të tij, rezultoi me tre konkurse të pasuksesshme. Në qershor dhe shtator 2024, gjyqtarët zgjedhën tre anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor: një gjyqtar nga Gjykata Supreme, një gjyqtar nga gjykatat nën kompetencën e Gjykatës së Apelit në Manastir dhe një gjyqtar nga komunitetet pakicë.

Pesë anëtarë të rinj janë zgjedhur nga kolegët e tyre në Këshillin e Prokurorëve Publikë. Në vendimin e tij të dhjetorit 2024, pas një parashprese nga prokurori i përgjithshëm, Komisioni për Parandalim dhe Mbrotjtje nga Diskriminimi konstatoi se Këshilli e ka diskriminuar paditësen në bazë të moshës dhe gjendjes civile për të vendosur nëse do të plotësonte kërkesën e saj për promovim. Pas prolongimit të shpalljes së konkursit, në shkurt të vitit 2024 Kuvendi zgjodhi prokurorin e ri publik shtetëror, i cili ishte i vetmi nga tre kandidatët e mbështetur nga Këshilli i Prokurorëve Publikë. Këshilli i Prokurorëve Publikë ka rritur transparencën përmes angazhimit më të madh me mediat, duke lëshuar deklarata të rregullta për shtyp dhe duke transmetuar seanca në mediat sociale.

Megjithatë, si Këshilli Gjyqësor ashtu edhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të ofrojnë një arsytim gjithëpërfshirës për vendimet e tyre, duke përfshirë përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

### Pavarësia dhe paanshmëria

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit duhet të përmirësohet. Ndërhyrja e jashtme apo politike mbetet një problem serioz. Niveli i perceptuar i besimit në gjyqësor mbetet shumë i ulët. Nevojiten përpjekje shtesë për të rritur transparencën dhe për të parandaluar përpjekjet për ndikim të padrejtë ose përdorimin e frikësimit. Konkretisht, qëllimet e njoftuara të pushtetit ekzekutiv për shpërbërje të të dy Këshillave shkaktojnë shqetësim serioz, pasi veprime të tilla do të cenonin pavarësinë e gjyqësorit. Vendimet e bazuara në merita dhe emërimet dhe avancimet e pavarura duhet të miratohen vazhdimisht.



Në janar 2024, Komisioni për Parandalim dhe Mbrotjtje nga Diskriminimi konstatoi se Këshilli i Prokurorëve Publikë ka rritur transparencën përmes angazhimit më të madh me mediat, duke lëshuar deklarata të rregullta për shtyp dhe duke transmetuar seanca në mediat sociale.

**Графику 2: Maqedonia e Veriut – Kërkesa për mbrotjtje nga ndikimi i palejuar gjyqtarë**

tyre, ndërprejnë procedurën për shkarkimin e Kryetares së Gjykatës Supreme për shkak të akuzave publike për ndërhyrje të jashtme politike të saj në punën e Gjykatës

Supreme dhe për mungesën e saj në seancat e Këshillit pas shkarkimit të paligjshëm të kryetarit të tij.

Këshilli Gjyqësor ka ndërmarrë procedurat për zgjedhjen ose shkarkimin e gjyqtarëve apo kryetarëve të gjykatës dhe anëtarëve të Komisionit të Përbashkët të Gjykatës Supreme parlamentare dhe presidenciale, bazuar në njoftimin publik të Komisionit të Përbashkët të Gjykatës Supreme për arandalimin e Korrupsionit (KSHPK), duke iu referuar një dispozite të Komisionit të Përbashkët të Gjykatës Supreme për emërimin e funksionarëve publikë. Ndërprerja e këtyre aktiviteteve ngre pyetje për pavarësinë e tyre. Këshilli i Prokurorëve Publikë ka vazhduar punën edhe gjatë periudhës zgjedhore. Është ndërprerë edhe procesi i rekrutimit në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (detajet më poshtë nën "Cilësia e Drejtësisë").

Më 15 maj 2024, Gjykata Kushtetuese konsideroi se pretendimet e Këshillit Gjyqësor dhe Shoqatës së Gjyqtarëve se ndryshimet në Ligjin për pagat e gjyqtarëve dhe Ligjin për pagat e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, nga shkurti 2024, kërcënojnë pavarësinë e gjyqësorit, janë të papranueshme. Gjykata vlerësoi se rritja e pagës minimale do të korrespondojë me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, pasi ata do të jenë ndër zyrtarët publikë me të ardhurat më të larta në vend.


### Llogaridhënia

Llogaridhënia në sistemin e drejtësisë duhet të përmirësohet. Vendimi i Këshillit Gjyqësor për të gjobitur një gjyqtar nga Gjykata e Apelit të Shkupit në vend që ta shkarkojë atë, për zvarritjen e një prej rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë të ish-Prokurorisë Speciale Publike (PSP), në masë të madhe është parë si konfirmim i ndërhyrjes politike.

Gjykatësi i Gjykatës Supreme dhe anëtari i Këshillit të Prokurorëve Publikë janë përfshirë në rastin e pranimit të shpërblimit për ndikim të kundërligjshëm. Këshilli Gjyqësor mbajti dy seanca urgjente më 20 maj dhe 16 gusht 2024, në të cilat vendosi heqjen e imunitetit të gjyqtarit të Gjykatës Supreme, duke aprovuar paraburgimin e tij. Edhe ish-gjykatësi i Gjykatës Supreme, edhe anëtari i PSP-së lidhën marrëveshje për pranimin e fajësisë. I pari u dënua me 3 vjet burg; i dyti u dënua me një vit me kusht. Në shtator 2024, Kuvendi pranoi dorëheqjen e anëtarit të PSP-së. Dënimet pas marrëveshjeve për pranimin e fajësisë u pranuan kryesisht si të buta dhe joproporcionale me peshën e veprës. Si përgjigje, Këshilli Gjyqësor krijoi komision për të hetuar pretendimet për veprime të paligjshme nga gjykata që gjykoi çështjen.

Trupi këshillimor i Shoqatës së Gjyqtarëve për Etikë Gjyqësore nuk ka marrë asnjë kërkesë të re për mendim që nga viti 2022. Këshilli i Prokurorëve Publikë, pas propozimit të Shoqatës së Prokurorëve Publikë, ndryshoi Kodin e Etikës në nëntor 2023 për të zbatuar rekomandimet e GREKO-s nga Raundi i Katërt i Vlerësimit. Ndryshimet u referohen dispozitave për sjelljen e prokurorëve publikë gjatë paraqitjeve publike dhe përcaktimit të "mikpritjes", në lidhje me ngjarjet protokollare.

Këshilli i Prokurorëve Publikë, duke pranuar propozimin e një komisioni ad hok disiplinor pranë Prokurorisë Publike, në nëntor 2023 njëzëri shkarkoi prokuror publik, i cili ishte ish-prokuror publik themelor i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK), duke u thirrur në shkeljen e rëndë disiplinore. Këshilli ka shqiptuar edhe gjobë për bashkëpunëtorin e prokurorit publik, në formën e uljes së pagës prej 30% për 6 muajt e ardhshëm. Prokurorja publike e shkarkuar në një deklaratë për publikun tha se nuk do të ankohet, por do të iniciojë procedurë për pensionimin e saj, gjë që ngriti dyshime për ndërhyrje të mundshme politike.



## Cilësia e drejtësisë

### Cilësia

të përmirësohet. Planifikimi i dobët dhe vonesa në procedurën e prokurimit publik për kryerjen e testeve elektronike për disa institucione publike, përfaqësojnë pranimin e Gjykatës së Gjykatës Themelore e Gjykatës Supreme Në 100 000 banorë – Maqedonia e Veriut


rezultatet ndryshime ligjore.

Gjykata Kushtetuese në qershor 2024, duke vendosur për një nismë të paraqitur nga Akademia dhe dy avokatë për të kontestuar nenin e gabuar, e anuloi nismën.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) pranoi ankesat e kandidatit për president dhe një avokati, për ndërprerjen e testeve pranuese të Akademisë gjatë periudhës zgjedhore. Gjykata Administrative fillimisht i kërkoi KSHPK-së ta rishqyrtojë, por Gjykata e Lartë Administrative në fund e vërtetoi vendimin, duke e ndërprerë procesin e përzgjedhjes deri në formimin e Qeverisë së re, pasi kjo konsiderohet punësim. Këto veprime e prolonguan deri tani punësimin më të madh të 130 kandidatëve në Akademi, qëllimi i të cilëve ishte tejkalmimi i mungesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë. Drejtoresha e Akademisë dha dorëheqjen në korrik 2024.

Në dhjetor 2023, Ministria e Drejtësisë miratoi Rregulloren e re për përbërjen dhe funksionimin e Këshillit për koordinimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet e drejtësisë (Këshilli i TIK-ut). Këshilli i TIK-ut, i cili për herë të parë përfshin përfaqësues të sektorit civil dhe të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, ka për detyrë të përgatisë Strategjinë e re për TIK-un në sistemin e drejtësisë. Sistemi i automatizuar informatik për lëndëve gjyqësore (AKMIS) duhet të përditësohet në përputhje me ndryshimet në ligjet procedurale dhe softueri duhet të përshtatet me masat e reja për rastet e ndërlikuara. Komisioni për mbikëqyrjen e funksionalitetit të AKMIS ka kryer tetë nga gjithsej 19 mbikëqyrje të planifikuara për vitin 2023. Është konstatuar se të gjitha gjykatat nën mbikëqyrje përdorin AKMIS dhe se asnjë lëndë nuk ndahet në mënyrë manuale.

Nevojiten për më shumë përpjekje për digjitalizim të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në lidhje me komunikimin me gjykatat dhe përdorimin e videokonferencave për seanca gjyqësore.



Në shtator të vitit 2024, gjykatat e Gjykatës së Gjykatës Themelore e Gjykatës Supreme Në 100 000 banorë – Maqedonia e Veriut ndryshime alternative e kontesteve - 2023 procedurës, të cilat rregullojnë praninë e publikut dhe të medias në seancat e përgjithshme gjyqësore. Këto ndryshime u miratuan për të rritur transparencën dhe për të



përmirësuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Gjykata Supreme dhe katër gjykatat e apelit vazhduan përpjekjet e tyre për të siguruar konsekuencë të vendimeve të tyre. Marrëveshjet për ujdi e përfunduara gjyqësore. Medicionet e përfunduara gjyqësore. Përmbledhje të vendimeve gjyqësore. Përgjithshme në prani të mediave, ku u diskutuan ndosj Lëndët e meditacionit Burimi: SEREJ

Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë dhe Shoqata e Gjykatësve duhet të vazhdojnë të promovojnë ndërmjetësimin dhe metodat e tjera alternative për zgjidhjen e kontesteve.



### Efikasiteti

Efikasiteti i sistemit të drejtësisë duhet të përmirësohet. Sipas vlerësimit të Këshillit Gjyqësor nevojiten 162 gjyqtarë të rinj (gjithsej do të nevojiten 434 gjyqtarë, ndërsa aktualisht janë emëruar vetëm 272 dhe 40 do të dalin në pension në 3 vitet e ardhshme). Është vështirësuar plotësimi i vendeve vakante në gjyqësor, për shembull, nga shtatë vende të lira për kryetarë të gjykatave themelore, disa janë përsëritur, pasi asnjë kandidat nuk ka aplikuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë. Po ashtu, sipas raportit vjetor të Këshillit të Prokurorëve Publikë për vitin 2023, aktualisht në vend punojnë 179 prokurorë publikë, që është më pak se nevoja e parashikuar e 279 prokurorëve publikë për të plotësuar në mënyrë adekuate të gjitha pozitat e nevojshme.

Interpretimi rigid i Kodit Zgjedhor që ndalon procedurat e punësimit të gjyqtarëve gjatë periudhave zgjedhore i prolongoi edhe më tej procedurat e punësimit dhe avancimit. Mungesa e masave për t'u përballur me ndikimin e pensioneve të planifikuara dhe mungesa e progresit në zbatimin e strategjive për burime njerëzore për gjyqësorin dhe prokurorinë publike ndikuan gjithashtu në efikasitet.

Buxheti i ndarë për gjyqësorin në vitin 2024 ishte 0.29% e PBV-së, që është e ulët duke pasur parasysh se shumica e parashikuar me ligj është 0.8% e PBV-së. Duhet të sigurohen burime të mjaftueshme financiare për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të drejtësisë dhe për të siguruar autonominë e tij financiare.



Rekomandimet e Komisionit Venecian për rishqyrtim të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve lidhur me dygjuhësinë në procedurat gjyqësore nuk janë marrë parasysh.



## Lufta kundër korrupsionit

### Evidenca

Evidenca në luftën kundër korrupsionit është përkeqësuar. Ende ekzistojnë modele shqetësuese lidhur me numrin e rritur të procedurave të prolonguara gjyqësore dhe rritjen e aktgjyqimeve të anuluar gjyqësore për korrupsion dhe krim të organizuar. Arsyeja më e shpeshtë për prolongim është mungesa e të pandehurve apo mbrojtësve dhe prokurorëve publikë në proceset gjyqësore – kryesisht për arsye shëndetësore, por edhe mungesës së anëtarëve të këshillave gjyqësore, kur ata emërohen në një gjykatë tjetër. Gjykatësit dhe prokurorët publikë duhet të menaxhojnë në mënyrë proaktive dhe efikase rastet e tyre për të siguruar drejtësi në kohë. Në këtë drejtim, duhet të sigurohet llogaridhënia gjyqësore.



Në shtator 2023, Maqedonia e Veriut ndryshoi Kodin Penal me procedure të përshpejtuar. Ndryshimet në lidhje me veprën penale keqpërdorim të detyrës dhe bashkimit kriminal kanë ngritur shqetësime sepse ato ulin dënimet maksimale dhe ndikojnë në parashkrimet dhe krijojnë rrezikun e mosndëshkimit për krimet e kaluara dhe të ardhshme. Veçanërisht problematike konsiderohet kufizimi i një kategorie të caktuar kundërvajtjesh, veçanërisht “keqpërdorimi i pozitës zyrtare gjatë prokurimit publik”. Ndryshimet cenojnë gjithashtu

procedurat penale të aplikueshme, duke kufizuar fushëveprimin dhe metodat specifike të hetimit, gjë që e vështirëson detyrën e prokurorisë publike. Ndryshimet në Kodin Penal kishin ndikim të drejtpërdrejtë në disa lëndë të profilit të lartë. Prokurorët publikë e kanë pasur veçanërisht të vështirë të riklasifikojnë akuzat për të siguruar llogaridhënie për rastet e trajtuara më parë nga ish-PSP, dhe shumë raste në vazhdim janë ndërprerë ose për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit ose për shkak se vepra penale keqpërdorim të detyrës në prokurimet publike nuk ekziston më. Për ta kontestuar praktikën e tillë, kryeprokurori publik ka paraqitur iniciativë për mjet të jashtëzakonshëm juridik – kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së PSP dhe vendosi kundër arsytimit të Gjykatës së Apelit se vepra penale keqpërdorim të pozitës zyrtare gjatë prokurimit publik është e dekriminalizuar.

### Korniza institucionale

Korniza institucionale për luftimin e korrupsionit është vendosur dhe është e kënaqshme për sa i përket masave parandaluese. Megjithatë, zbatimi i ligjit duhet të përmirësohet. KSHPK vazhdoi të këshillojë në mënyrë proaktive institucionet publike për politikën dhe hapi disa raste të reja. Pas emërimeve nga Kuvendi, përbërja e re e Komisionit Shtetëror mbajti seancën konstituive më 16 shkurt 2024. Disa organizata civile vlerësuan se procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të KSHPK-së nuk është plotësisht transparent dhe se është i njëanshëm politik.

KSHPK-ja duhet të forcojë më tej kapacitetin e saj për të nisur në mënyrë proaktive iniciativa përpara autoriteteve kompetente, duke identifikuar parregullsitë e mundshme që ende nuk janë raportuar në media. Shumë shpesh, institucionet përkatëse nuk ndjekin konkluzionet e raporteve të KSHPK-së. Sistemi elektronik i paraqitjes së deklaratës për gjendjen pronësore dhe interesat ka funksionuar që nga janari i vitit 2024. Megjithatë, kapaciteti i -së KSHPK-së për të verifikuar deklaratat e interesave dhe deklaratat është ende i kufizuar. Duhet të krijohet softueri që mundëson komunikim ndërmjet sistemeve të TI-së të Kadastrës, Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Regjistrisë Qendrore për të kryer kontrole më efektive në deklaratat e gjendjes pronësore. Mbikëqyrja e KSHPK-së mbi financimin e fushatës zgjedhore është e dobët për shkak të resurseve të kufizuara dhe faktit që të dhënat përpunohen në mënyrë manuale. Aktivitete të mëtejshme nevojiten për të forcuar dhe mbështetur KSHPK-në dhe sigurim të resurseve adekuate, veçanërisht staf profesional me përvojë hetimore. KSHPK-ja do të përfitonte nga staf profesional me përvojë hetimore, i cili do të mund të përgatiste më mirë dokumentacionin që do t'i dorëzohej PTHP-së, t'i verifikojë në mënyrë më efektive deklaratat për gjendjen pronësore dhe të sigurojë mbikëqyrjen e duhur të financimit të fushatës zgjedhore.

**Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK)** është zhvendosur në objekte të reja. Buxheti dhe stafi janë ende të pamjaftueshëm për të zgjidhur në mënyrë efektive rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Nuk ka ekspertë apo analistë financiarë dhe ende nuk ka një planifikim strategjik për të vepruar ndaj hetimeve dhe rasteve, gjë që ndikon në efektivitetin e përgjithshëm të saj. PTHPNKOK-ja do të bëjë më efikase nëse do të futeshin më shumë specializime dhe resurset t'u kushtoheshin lëndëve më të ndërlikuara. Kjo duhet të rrisë bashkëpunimin, shpërndarjen e informacioneve dhe monitorimin e vazhdueshëm të iniciativave dhe rekomandimeve të KSHPK-së. Pas ndryshimeve në Kodin Penal që çuan në uljen e dënimeve, prokuroritë themelore publike (PTHP) morën kompetencë për rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivel të lartë. Megjithatë, ekspertiza dhe resurset e pamjaftueshme profesionale mund të pengojnë ndjekjen efektive të kundërvajtjeve të tilla.

**Enti Shtetëror për Revizion**, qendra hetimore/policia gjyqësore në PTHP dhe policia nuk kanë resurse të mjaftueshme. Nevojiten të përmirësohen cilësia dhe efikasiteti i hetimeve. Krahas kësaj, shpesh paraqitet nevoja që hetimet të ndiqen paralelisht me hetime financiare

për individë dhe shoqëri tregtare për të cilat ekziston dyshim se janë përzier në aktivitete kriminele. Mekanizmat për ngrirje dhe konfiskim përdoren në masë të kufizuar. Me qëllim të rritjes së numrit të hetimeve financiare, prokurorisë duhet t'i ndahen resurse adekuate financiare dhe njerëzore. Nevojitet të përforcohet koordinimi ndërinstytucional dhe të vendoset qasje në baza të integruara të të dhënave.

### Dokumente strategjike

Dokumentet strategjike janë vendosur. Zbatimi i Strategjisë Nacionale **për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave** me plan veprim për zbatimin e saj (2021-2025) vazhdon të zhvillohet ngadalë, gjë që tregon mungesë të përgjithshme të përkushtimit dhe ndjenjës së përgjegjësisë në institucionet. Vetëm 13% të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2023 u realizuan në tërësi, 33% janë në vijim e sipër, ndërsa 54% nuk janë realizuar. Kjo përbën një rritje shumë të kufizuar lidhur me vitin paraprak kur 10% të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021 u realizuan në tërësi, 35% ishin në vijim e sipër, ndërsa 55% nuk u realizuan. Kuvendi fillimisht duhet të diskutojë për raportin e KSHPK për zgjedhjet lokale në vitin 2021.

### Korniza juridike

Korniza ligjore për luftimin e korrupsionit është vendosur, por ai duhet të përmirësohet si në aspektin e masave parandaluese ashtu edhe në aspektin e zbatimit të ligjit.

Vendi është palë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Ajo nuk është nënshkruese e Konventës së OECD-së kundër ryshfetit. Sipas vërejtjeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO), Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ofron një mekanizëm adekuat për sanksionimin e shkeljeve të rregullave për konfliktin e interesit, integritetin dhe luftën kundër korrupsionit.

Ligji për financimin e partive politike përcakton se si financimi i partive politike mund të sigurohet dhe menaxhohet si duhet. Kodi Zgjedhor përcakton rregullat për financimin e fushatave zgjedhore. Ligji për Qasje të Lirë në Informatat Publike u mundëson kërkuesve të marrin informacione për financimin publik të partive politike. Është e nevojshme të sigurohet konsistenca e kornizës ligjore për të mundësuar siguri ligjore dhe mbikëqyrje efektive mbi financimin e partive politike. Ligji për lobimin ka hyrë në fuqi në qershor 2022. Deri më sot është regjistruar një organizatë. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve duhet të harmonizohet më tej me ligjin e BE-së.

## **Të drejtat fundamentale**

### Korniza e përgjithshme


Korniza e përgjithshme për të drejtat fundamentale është në masë të madhe e kënaqshme.

### Instrumentet ndërnacionale për të drejtat e njeriut

Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar shumicën e instrumenteve ndërnacionale për të drejtat e njeriut. Vendi duhet të zhvillojë sistem gjithëpërfshirës për ndjekje dhe mbledhje të të dhënave për ta vlerësuar nivelin e zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për të drejtat e njeriut dhe në tërësi të ketë dobi nga statusi i mbikëqyrjes në Agjencinë për të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian (ADF).

### Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut


Maqedonia e Veriut ka nivel të mirë të bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjatë periudhës së raportit, GJEDNJ konstatoi



shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kanë të bëjnë me të drejtën e gjyqimit të drejtë, të drejtën e lirisë dhe sigurisë dhe mbrojtjen e pronësisë. Momentalisht, shtatë lëndë janë në mbikëqyrje të fuqishme nga Komiteti Ministror. Maqedonia e Veriut duhet të bëjë përpjekje për t'i zgjidhur çështjet sistemore ose strukturore të ngritura në këto lëndë, e veçanërisht ato lidhur me lirinë e bashkimit, veprimet jonjerëzor nga policia dhe diskriminimi dhe të sigurojë zbatim sistemor të aktgjykimeve të GJEDNJ-së.

### Avancimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut

Korniza juridike për mbrojtjen e të drejtave fundamentale është pjesërisht e harmonizuar me të drejtën e BE-së dhe me standardet evropiane. Vendi vazhdon t'i përmbushë detyrimet e saj të përgjithshme për të drejtat fundamentale, por



por legjislacioni dhe strategjitë adekuate duhet të zbatohen në mënyrë sistemore. Kuvendi nuk arriti ta miratojë ndryshimin e shumëpritur të Ligjit për Avokatin e Popullit, që është i nevojshëm për përplotësimin e akreditimit

me status “B” në bazë të Parimeve parisiane dhe nuk arriti të zgjedhë gjashtë nga 10 zëvendësit e Avokatit të popullit.

Në nëntor 2023, Kuvendi e emëroi *Shoqatën e Juristëve të Rinj të Maqedonisë* (SHJRM) dhe Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHDNJ) në rolin e mekanizmit për kontroll civil në zyrën e Avokatit të Popullit. Organet nuk arritën përmirësime të dukshme në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në fund të vitit 2023, Kuvendi zgjodhi anëtarë të rinj të komisioneve për mbrojtje nga diskriminimi dhe i plotësoi vendet e lira të punës. Kjo u mundësoi Komisionit që ta përfundojë mandatin e tij me përbërje të plotë. Ndërtimi i kapaciteteve të Komisionit në masë të madhe mbështetet në mbështetjen e donatorëve dhe bashkëpunimi me OC.

### Parandalimi i torturës dhe veprimi jonjerëzor

Maqedonia e Veriut momentalisht është ndërmjet vendeve për të cilat ekziston shqetësim më i madh për kushtet në paraburgim. Vendi duhet urgjentisht të përballet me problemin e vazhdueshëm me kushtet joadekuate të paraburgimit në burgjet, stacionet policore, mbrojtjen sociale dhe institucionet psikiatrike. Megjithëse infrastruktura rinovohej dhe u përmirësua në disa institucione të burgjeve, kushtet në disa pjesë të burgut Idrizovë dhe njësitë tjera të paraburgimit në institucionet ndëshkuese-përmirësuese mbeten tejet problematike. Praktika gjyqësore e GJEDNJ tregon se kushtet e këqija të paraburgimit mund të konsiderohen si bazë për shkelje të nenit 3 për ndalim të torturës.

Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë me mekanizmin e dialogut për zbatimin e rekomandimeve të publikuara në vitin 2021 nga Komiteti për Parandalim të Torturës të Këshillit të Evropës (KPT) dhe ato nga raportet paraprake. KPT-ja bëri vizitë të rregullt në Maqedoninë e Veriut në tetor 2023 dhe në maj 2024 parashtroi raport me rekomandime.

Mekanizmi për mbikëqyrje të jashtme të policisë, përfshirë edhe policinë e burgut, u rrrumbullakësua me zgjedhjen e tre përfaqësuesve nga Kuvendi. Ai duhet t'i përforcojë metodat e punës përmes bashkëpunimit me zyrën e Avokatit të Popullit.

### Ekzekutimi i sanksioneve penale



Burgjet janë plot. Ndryshimet e Ligjit për ekzekutimin e detyrës së burgut në procedurat për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve të burgjeve dhe i përfshijnë rekomandimet e UNICEF-it për ndarjen e vazhdate nga personat e rritur në institucionet edukative për mirëmbajtje të burgjeve. Shkalla e plotësisë % Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit (muaj)


n/a: nuk ka të dhëna  
Burimi: Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Burgut

pagë për punë në kushte të vështira, mungesa e mbrojtjes shëndetësore adekuate ose masave për mjekim të varësisë nga droga në burgjet mbetet çështje për shqetësim serioz

Sistemi i shërbimit të provës përmirësohet me atë që nëpunësit e shërbimit të provës kanë zgjidhur më shumë lëndë dhe ekziston koordinim më i mirë ndërmjet palëve të interesuara. Nuk është arritur progres lidhur me ndryshimin e kornizës juridike për dënime alternative ose për përballje me mungesën e aktiviteteve me dedikim për të burgosurit. Në të gjitha institucionet ndëshkimore-përmirësuese duhet të ketë shërbime arsimore dhe shërbime për risocializim, si dhe programe për mjekim.

### Mbrojtja e të dhënave personale

Nuk është arritur progres në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Edhe më tutje vijon harmonizimi i plotë me Rregullativën e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe miratimin e legjislacionit nacional për harmonizim me Direktivën e BE-së për zbatimin e Ligjit. Puna e Agjenc



Personale (AMDHP) është e kufizuar sepse nuk ka pavarësi për angazhim autonom të personelit dhe shpenzim të buxhetit. Numri i të punësuarve u zvogëluar më tej për shkak të pagave të ulëta dhe tani është vetëm 20. Kjo, së bashku me mjetet e pamjaftueshme, e pengon plotësisht Agjencinë për t'i kryer detyrat dhe autorizimet e saj. AMDHP-ja nuk konsultohet në mënyrë sistematike për ligjet sektoriale ose legjisllacionin për zbatim. Koordinimi, komunikimi dhe monitorimi i rekomandimeve të Agjencisë janë ende të pamjaftueshme. Kuvendi nuk e monitoron vazhdimisht raportin vjetor të Agjencisë dhe raportet për çështje konkrete, siç është ndjekja e komunikimeve.

### Liria e fesë dhe besimit

Kushtetuta edhe më tutje i garanton të drejtat e lirisë së fesë ose besimit dhe ato zbatohen në praktikë.

---

### **Liria e shprehjes**

#### Mbrojtja e gazetarëve

Në vitin 2023, Ministria e Punëve të Brendshme evidentoi shtatë raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe hapi hetime për to. *Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë* evidentoi pesë incidente kundër gazetarëve. Prej tyre, tre kanë të bëjnë me rreziqet dhe shqetësimet jofizike, e dy ndaj kërcënimeve me jetë dhe sigurisë fizike të gazetarëve. Gjykatat kanë paraqitur më pak padi për shpifje (19) kundër gazetarëve në vitin 2023 nga viti paraprak dhe regjistruan gjashtë padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP), duke theksuar mungesë të mekanizmave për mbështetje për SLAPP.

Politikanët dhe personalitetet publike përdorën gjuhë të papranueshme kundër gazetarëve. Është caktuar prokuror special për t'i ndjekur sulmet ndaj gazetarëve, ndërsa incidentet e maltremit online mund të paraqiten në Sektorin për krim kompjuterik të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### Mjedisi legjisllativ

Korniza juridike që i rregullon mediat nuk është harmonizuar plotësisht me të drejtën e BE-së, më saktësisht me Ligjin evropian për lirinë e mediave. Pas revizioneve nga korriku 2023, Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i shfuqizon të drejtat diskrecionale të Qeverisë gjatë ndarjes së mjeteve për sektorin radiodifuziv. Edhe krahas kësaj, Qeveria vazhdoi të ndajë mjete me shumë të zvogëluar. Në shkurt 2024, përsëri u fut reklamimi qeveritar në mediat komerciale, duke e rritur rrezikun nga keqpërdorimi potencial të fondeve politike, duke e rrezikuar pavarësinë e mediave dhe duke e cenuar tregun.

Kuvendi përsëri nuk arriti të emërojë anëtarë të rinj të Këshillit programor të servisit radiodifuziv publik dhe Këshillit të rregullatorit mediatik.

#### Zbatimi i legjisllacionit/institucioneve

Në vitin 2023, rregullatori mediatik vazhdoi me mbikëqyrjen e mediave radiodifuzive dhe përqendrimit dhe pronësisë së paligjshme mediatike. Bashkëpunoi me organizatat civile dhe mediat për promovimin e edukimit mediatik dhe të drejtave të njeriut.

#### Servisi radiodifuziv publik

Servisi radiodifuziv publik duhet të modernizohet dhe të përmirësohet konkurrenca, pavarësia dhe standardet profesionale. Financimi i organizimit ishte jokonsekuent, duke shkaktuar pasiguri në planifikimin. Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nga muaji korrik 2023 e rriti financimin e përgjithshëm, por organet transferuan më pak mjete nga ato të parapara me ligj.

## Faktorët ekonomikë

Edhe më tutje janë të pranishme sfidat në aspekt të transparencës së pronësisë mediatike dhe përqendrimit mediatik. Partitë politike vazhdojnë të përdorin mjetet shtetërore për reklamim, e mostransparenca për reklamim të paguar politik edhe më tutje mbijeton. Edhe mediat e shtypit dhe radiodifuzive janë të obliguar ligjërisht t'ia zbardhin informacionet për strukturën pronësore të trupit rregullator për mediat audiovizuale, por nuk ekziston legjislacioni për zbardhjen e pronësisë dhe të dhënave financiare të mediave nacionale online. Regjistri i mediave profesionale online është mekanizëm vetërregullues.

## Internet

Neutraliteti i rrjetit është garantuar, si në lidhje me dispozitat ligjore, ashtu edhe në lidhje me zbatimin praktik. Megjithatë, ka sfida në sektorin e mediave online në aspekt të rreziqeve të zmadhuara që dalin nga dezinformatat, gjuha e urrejtjes dhe shkelja e të drejtave nga pronësia intelektuale. Këshilli për etikë në mediat vërejtën rritje të katërfishtë të parashtrësive për gjuhën e urrejtjes në krahasim me vitin paraprak.

## Organizatat profesionale dhe kushtet për punë

Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve mediatikë i mbron të drejtat e punëtorëve dhe sociale të gazetarëve. Sindikatat e veçanta i mbrojnë të drejtat e gazetarëve që punojnë për serviset radiodifuzive publike dhe ato që punojnë për agjencitë gazetareske. Edhe më tutje ka mangësi në kushtet për punën e gazetarëve, veçanërisht në lidhje me kontratat afatshkurtër dhe honorar pa sigurim shëndetësor dhe social, orët e punës jashtë orarit të papaguara dhe pagat e ulëta, që kontribuojnë për vetëcensurë, ndërsa pronarët e mediave të ndikojnë mbi përmbajtjen redaktuese.

*(Shihni gjithashtu Kapitulli 10 – Transformimi digjital dhe mediat)*

---

## Liria e mbledhjes dhe bashkimi

E drejta e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit është e garantuar me Kushtetutën. Korniza juridike e vendit është në masë të madhe e harmonizuar me detyrimet e saj ndërnacionale për lirinë e bashkimit. Nevojiten përpjekje shtesë për zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së që kanë të bëjnë me regjistrimin e shoqatave.

Ndryshimet ligjore duhet të harmonizohen me standardet ndërnacionale. Një mënyrë që të arrihet është të konsultohet Komisioni i Venecias para se të miratohet Ligji për shoqatat dhe fondacionet, në pajtim me Rekomandimin e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe mostolerancës (KERM).

Të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat e organizimit sindikal janë përfshirë në Kapitullin 19 – Politika sociale dhe punësimi.

## Të drejtat e pronësisë

Progresi lidhur me të drejtat e pronësisë mbetet i kufizuar për shkak të procedurave të gjata dhe të shtrenjta. Nuk ka progres lidhur me Strategjinë nacionale për të drejtat e pronësisë. Regjistrat pronësore në nivel të komunës nuk përditësohen rregullisht dhe ende ruhen në formën analoge. Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive e zvogëloi përqindjen e lëndëve të pazgjidhura dhe të ngecura për 62% dhe 5%, dhe e përfundoi evidentimin e tokës dhe pronave. Organet që menaxhojnë me procedurat për kthim të pronës janë ngarkuar tej mase për shkak të kuadrit të pamjaftueshëm dhe financave të kufizuara. Mbi 6.000 lëndë për denacionalizim mbeten të hapura, edhe krahas asaj që procesi ishte mbyllur zyrtarisht në vitin 2013.



## Mosdiskriminimi

Korniza juridike dhe institucionale për mosdiskriminim mbetet e harmonizuar pjesërisht me të drejtën e BE-së dhe standardet evropiane.


Strategjia Nacionale për Barazi dhe Mosdiskriminim 2021-2026 nuk dha rezultate të rëndësishme. Në fund të vitit 2023, Kuvendi zgjodhi anëtarët e rinj të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe plotësoi vendet vakante. Edhe pse Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi përballet në mënyrë efektive me numrin në rritje të ankesave, ai ende ka nevojë për më shumë resurse dhe mbështetje nga donatorët dhe organizatat civile. Sfidat kryesore që pengojnë punën e Komisionit janë mungesa e pavarësisë financiare dhe numri i vogël i stafit administrativ. Komisioni në vitin 2023 ka lëshuar 117 mendime juridike dhe në 59 raste ka konstatuar diskriminim dhe ka dhënë rekomandime. Rastet e diskriminimit ishin më të përfaqësuara në fushën e punësimit, informimit publik dhe medias, si dhe qasjes në mallra dhe shërbime.

Nevojitet të përmirësohet më tej korniza ligjore dhe kapaciteti ndërinstitucional për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, veçanërisht duke përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë e gjuhës së urrejtjes. Vendi duhet ta ndjekë vazhdimisht rekomandimin e përgjithshëm për nr. 15 të KERM për luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe zbatimin e plotë të gjetjeve dhe rekomandimeve të përshkruara në raportin e KERM të shtatorit 2023.

Organet ende nuk mbledhin të dhëna për gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes në mënyrë sistematike. Organizatat civile regjistrojnë vazhdimisht rastet e krimeve të urrejtjes në një bazë të dhënash. Në vitin 2023 janë regjistruar 1171 raste të gjuhës së urrejtjes, nga të cilat më të përfaqësuara kanë qenë ato në bazë të përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor dhe kombësisë.

## Barazia gjinore

Maqedonia e Veriut nuk ka progres në përmirësimin e barazisë gjinore dhe nuk ka progres në kornizën politike nacionale dhe harmonizimin me të drejtën e BE-së. Lëvizja antigjinore në vend. Kjo ndikoi mbi procesin legjislativ dhe procesin e krijimit të politikave. Zbatimi i Strategjisë Nacionale për Barazi Gjinore (2022-2027) është e dobët dhe nevojitet të përforcohen mekanizmat për zbatim dhe monitorim të politikave për barazi gjinore. As zbatimi i Konventës së Stambollit nuk është optimale për shkak të financimit të pamjaftueshëm dhe protokolleve ndërinstitucionale joefektive. Në vitin 2023, Grupi i ekspertëve për aksion kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare



(GREVIO) konstatoi një numër i madh i problemeve që kërkojnë zgjidhje urgjente të organeve që të arrihet harmonizim i plotë me dispozitat e Konventës. Qasja në shërbimet shëndetësore për viktimat e dhunës së bazuar gjinore është e penguar për shkak të kapaciteteve të kufizuara akomoduese dhe mungesës së personalit.

### E drejta e fëmijës

Korniza legjislative dhe institucionale për të drejtat e fëmijës në masë të madhe është harmonizuar me të drejtën e BE-së dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por zbatimi efektiv edhe më tutje është sfidë për shkak të problemeve me llogaridhënien, kapacitetin, ndjekjen dhe financimin.

Sferat kryesore të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje janë arsimi, shëndetësia, mbrojtja nga dhuna dhe mosdiskriminimi. Nevojitet mbështetje më e madhe për mekanizmat për luftë kundër dhunës dhe financimin e mjaftueshëm për Strategjinë nacionale për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna (2020-2025). Fillimisht duhet të formohet trupi nacional për koordinim të të gjitha politikave që kanë të bëjnë zbatimin e Konventës së KB-së për të drejtat e fëmijës dhe Protokollin fakultativ të Konventës. Plani i veprimit për luftë kundër trafikimit me fëmijë (2021-2025) duhet të harmonizohet me Konventën nga Llanzarote dhe Legjislacionin e BE-së për keqpërdorim seksual të fëmijëve (Direktiva 2011/93).

Zbatimi i Strategjisë nacionale për deinstitutionalizim (2018-2027) vazhdon edhe të gjithë fëmijët janë zhvendosur në familje përkujdesëse ose shtëpi të vogla grupe.

Nevojitet të bëhen përpjekje të mëtutjeshme për zbutje të varfërisë për fëmijë dhe përmirësim të mbrojtjes sociale. Duhet të përforcohet bashkëpunimi me palët e prekura lokale dhe kapaciteti i qendrave për punë sociale, veçanërisht për fëmijët e ekspozuara ndaj rrezikut, përfshirë edhe Romët dhe personat me aftësi të kufizuara. Politika për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta përballet me sfidat.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e rregullt të institucioneve edukative-përmirësuese dhe burgjet është me rëndësi kryesore për mbrojtjen dhe sigurimin e shërbimeve të fëmijëve në paraburgim. Qasja në drejtësi, përfaqësimi i drejtë, si dhe kapaciteti i nëpunësve publikë që punojnë me fëmijët viktimë, fëmijët dëshmitarë dhe fëmijët në konflikt me ligjin momentalisht janë të pamjaftueshme.

### Personat me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë ende në gjendje të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre sepse legjislacioni dhe politikat e qeverisë nuk janë në përputhje me Konventën e KB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). Kapaciteti i organeve shtetërore duhet të forcohet në mënyrë që korniza institucionale dhe legjislative për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të jetë në përputhje me ligjin e BE-së për personat me aftësi të kufizuara. Zyra e Avokatit të Popullit monitoron zbatimin e KDKPAK-së së KB-së në bashkëpunim të ngushtë me OC-të. Me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të kenë të drejta të barabarta, Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është miratuar në dhjetor 2023 dhe zbatimi është në fazën fillestare. Plani i veprimit për Strategjinë Nacionale për Deinstitutionalizim 2022-2024 është pothuajse nga fundi, dhe mbetet për t'u përfunduar zhvendosja e shfrytëzuesve nga Enti special Demir Kapi.

Gjithsej 2200 nxënës me nevoja të veçanta janë integruar në shkollat e rregullta fillore dhe 314 të tjerë janë regjistruar në shkollat e mesme me mbështetjen e asistentëve arsimorë për

të forcuar iniciativat e gjithëpërfshirjes. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me forma të konsiderueshme diskriminimi që vijnë nga barrierat e infrastrukturës, qasja e pamjaftueshme në informatat dhe shërbimet, qëndrimet diskriminuese dhe marginalizimi social.

*(shihni Kapitulli 19 – Politika sociale dhe punësimi për aspektet lidhur me shërbimet sociale, ndihmën dhe benefitet).*

### Personat LGBTIK

Nuk ka pasur përparim në përmirësimin e kornizës ligjore ose të politikave për të mbrojtur të drejtat e personave lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjjinorë, interseks dhe queer (LGBTIQ). Korniza ligjore aktuale nuk lejon njohjen e çifteve të të njëjtit seks. Më 22 qershor 2024, Parada e Krenarisë LGBTIK u organizua me sukses, por gjuha e urrejtjes kundër komunitetit është ende e pranishme në mediat sociale. Si vëzhgues i punës së Agjencisë për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian, Maqedonia e Veriut ishte pjesë e Anketës III të besimit LGBTIK, që tregoi se në përgjithësi, në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023, 39% janë ndier të diskriminuar të paktën në një fushë të jetës në vitin para anketës (në BE-27 përqindja ishte 37%). Nuk ka progres në zbatimin e aktgjykimit të GJEDNJ-së nga janari 2019 për njohjen ligjore të seksit.

Organizatrat civile kanë regjistruar 298 raste të gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, por pasojat ligjore janë ende joadekuate. Në mars të vitit 2024, gjykata themelore shqiptoi dënim me burg me kusht ndaj një qytetari për gjuhë të urrejtjes ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTIK dhe ky ishte aktgjykimi i parë mbi këtë bazë në vend. Organizatat civile dokumentuan 27 raste të dhunës së motivuar nga urrejtja ndaj personave LGBTIK. Nuk ka progres në hetimin e sulmeve ndaj qendrës së mbështetjes LGBTIK që ndodhën më shumë se një dekadë më parë, as për vandalizmin e zyrës së një organizate LGBTIK dhe kërcënimet me vdekje drejtuar aktivistëve.

### Të drejtat procedurale dhe të drejtat e viktimave

Vendi është ende vetëm pjesërisht në përputhje me ligjin e BE-së që mbron të drejtat procedurale të personave të akuzuar ose të dyshuar për vepra penale. Në mars 2024, Kuvendi miratoi Ligjin për drejtësinë për fëmijët, i cili reflekton në masë të madhe kërkesën për masa mbrojtëse procedurale për fëmijët që dyshohen ose akuzohen në procedurë penale. Në shtator 2024, u ndryshua Ligji për ndihmën juridike falas. Vendi ka një rrjet solid që ofron ndihmë juridike parësore dhe dytësore, përfshirë viktimat e veprave penale. Që të përmirësohet qasja në drejtësi, nevojitet një reformë e sistemit të ndihmës juridike në procedurën penale. Organet kompetente duhet t'i rishikojnë kriteret e përshtatshmërisë për ndihmë juridike në procedurën penale në lidhje me mbrojtjen e detyrueshme, mbrojtjen e personave të varfër dhe përfaqësimin e interesave të viktimave të veprave penale.

Vendi nuk është ende i harmonizuar me Direktivën për urdhër evropian të mbrojtjes. Pritet miratimi i Ligjit të ndryshuar për procedurë penale pritet të sigurojë harmonizimin me Direktivën për mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Në fillim të vitit 2024, Komisioni për Zbatimin e Ligjit për pagesën e kompensimit në para të viktimave të veprave penale me dhunë dhe filloi të mbajë mbledhje.

### Mbrojtja e pakicave

Rekomandimet e Komitetit Këshillimor për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale për avancimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së strategjisë nacionale për

mbështetje të shoqërisë multietnike "Një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizëm" nuk u zbatuan plotësisht.

Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Komuniteteve publikoi Strategjinë Nacionale për Zhvillimin e Ndërkulturalizmit dhe Kohezionit Shoqëror 2024-2026, të cilën Parlamenti ende nuk e ka miratuar. Organet kompetente duhet të ofrojnë mbështetje politike të nivelit të lartë, financim dhe prani në media për të mbështetur Strategjinë.

Maqedonia e Veriut ende nuk e ka ratifikuar Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, të nënshkruar në vitin 1996.

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës dhe Agjencia për Realizimin e të Drejtave të Komuniteteve vazhdojnë të kenë mungesë të stafit të mjaftueshëm dhe nuk financohen në mënyrë adekuate.

### Romët

Maqedonia e Veriut arrit progres të kënaqshëm në sferën e inkluzionit të Romëve, duke e krahasuar Strategjinë për inkluzion të Romëve 2022-2030. Janë përgatitur plane të reja të veprimit për vitin 2024/2025 dhe është emëruar këshilltar për inkluzion të Romëve që do t'i ndihmojë Kryeministrit. Megjithatë, strategjia nuk ka qasje të qartë për pjesëmarrje, përforsim dhe ndërtim të kapaciteteve. Pjesërisht zbatohet Plan veprimi për mbrojtje, promovim dhe përmbushje të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave romë. Sfida tjera janë shkuarja e parregullt në shkolla, fëmijë në rrugë dhe segregacioni në shkolla. Qeveria mbetet e përkushtuar në zbatimin e prioritetëve nga Deklarata e Poznanit.

### Të drejtat e shtetësisë

Në dhjetor 2012, Maqedonia e Veriut e ndryshoi ligjin me të cilin lejohet marrja e shtetësisë me interes të veçantë ekonomik. Programi mund të shkaktojë rreziqe të migracionit dhe të sigurisë, veçanërisht duke marrë parasysh kriteret e ndryshme për ndarje të shtetësisë. Komisioni mbetet në qëndrimin nga raporti i saj i gjashtë në kuadër të mekanizmit për supsendim të regjimit të vizës, se Maqedonia e Veriut duhet të përmbahet nga ndarja sistemore e shtetësive në bazë të interesit të veçantë ekonomik, sepse programet e tilla për shtetësi të investuesve paraqesin rreziqe serioze dhe nuk përkojnë me të drejtën e BE-së. Në vitin 2023 u parashtruan pesë kërkesa të tilla.

## **2.2.2 Kapitulli 24: E drejta, liria dhe siguria**

*BE-ja ka rregulla të përbashkëta për kontroll kufitar, viza, migracion të jashtëm dhe azil. Bashkëpunimi në pjesën e Shengenit imponon heqje të kontrolleve kufitare në kuadër të BE-së. Ekziston edhe bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit edhe për çështje gjyqësore, policore dhe doganore, të gjithë me mbështetje nga agjencitë e BE-së për drejtësi dhe punë të brendshme.*

### **Lufta kundër krimit të organizuar**

Maqedonia e Veriut vazhdoi të punojë në harmonizimin e kornizës së saj juridike për krimin e organizuar me të drejtën e BE-së.

### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

Maqedonia e Veriut është harmonizuar pjesërisht me të drejtën e BE-së në luftimin e krimit të organizuar. Është harmonizuar me më shumë **dokumente strategjike** për krimin e organizuar dhe format tjera të krimit serioz, në bazë të strategjisë adekuate të BE-së. Me ndihmën e metodologjisë dhe politikës së Europollit u përgatit "Vlerësimi nacional i rreziqeve nga krimi

serioz dhe i organizuar (SOKTA) 2021”, i prezantuar në vitin 2022, dhe i rishikuar nga organet kompetente në dhjetor 2023.

Lidhur me **strukturën institucionale**, Qendra koordinatave nacionale për çrënjosjen e krimit të organizuar dhe serioz është operativ, por nevojitet të ketë më shumë persona të punësuar në kohë të pacaktuar. Në prokurorinë publike formohen katër qendra hetuese për mbështetjen e hetimeve për lëndë të ndërlikuara të krimit të organizuar. Të gjithë qendrat janë operative dhe në përdorim, por nuk kanë resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, qasje adekuate në bazat e nevojshme të të dhënave, kurset për trajnim dhe pajisje profesionale.

Pas reformës në sektorin e sigurisë dhe zbulimit në vitin 2018, Agjencia e Sigurisë Nacionale është vendosur në hapësirat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që mund ta rrezikojë pavarësinë. Gjithashtu edhe Agjencia Operative-Teknike e cila është përgjegjëse për ndjekjen e komunikimeve, punon nga hapësirat e një operatori nacional të telekomunikimeve, gjë që gjithashtu mund ta rrezikojë pavarësinë e saj. Agjencia Teknike-Operative e përfundoi procesin e digjitalizimit të procedurës për arritje dhe realizim të ndjekjes së autorizuar të komunikimeve. Organet nacionale relevante ende nuk e përdorin procedurën e digjitalizuar për shkak të mungesës së rregullativës ligjore adekuate për zbatimin e saj. Në fund të muajit nëntor 2023 u emërua drejtor i ri.

Lidhur me **kthimin e pronës**, në mars 2024 u miratua Ligji për zyrën për kthim të pronës, që u harmonizua me të drejtën e BE-së. Zyrës e cila është pjesë e Prokurorisë Publike, ende i nevojitet legjislacioni i nevojshëm për zbatim, buxhet adekuat, qasje në bazat e të dhënave dhe personel. Në Zyrën për kthimin e pronës (ARO) punon vetëm një prokuror. Ligji për menaxhim me pronën e konfiskuar, dobi pronësore dhe sende të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse u ndryshua në mars 2024 që të harmonizohet më tej me të drejtën e BE-së. Agjencisë për Menaxhim me Pronën e Konfiskuar i mungon kuadër, depo, pajisje dhe buxhet, si dhe sistem efikas për menaxhim me sende. Krahas kësaj, në shkurt 2024, Kuvendi e miratoi Ligjin për konfiskim të pronës në procedurë penale, me të cilin propozohet sistem pa aktgjykime dënuese për konfiskimin e pronës për të cilën supozohet se është marrë në mënyrë kundërligjore. Ekziston shqetësim në lidhje me fushëveprimin e Ligjit sepse mund çojë në huti lidhur me legjislacionin tjetër, e me atë edhe në pasigurinë juridike.

Në lidhje me **trafikimin e njerëzve**, në fillim të vitit 2024 u formua Komisioni për Kompensimin Monetar të Viktimave të Veprave Penale me Dhunë, i cili është i ngarkuar për ofrimin e mbështetjes për viktimat veprave penale me dhunë. Kodi Penal duhet të harmonizohet më tej me ligjin e BE-së në fushën e trafikimit të njerëzve, veçanërisht në lidhje me dënimet për vepra të caktuara. Kapacitetet për zbatimin e ligjit duhet të forcohet më tej për të mundësuar hetime më proaktive.

Lidhur me krimin që lidhet me **armët e zjarrit**, në nëntor të vitit 2023 është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike dhe Drejtorisë Doganore për të forcuar bashkëpunimin në ndjekjen e krimeve lidhur me armët e zjarrit. Ndryshimet në Kodin Penal të shtatorit 2023 kriminalizojnë posedimin e materialeve për prodhimin e armëve 3D dhe prodhimin aktual të armëve të tilla, në përputhje me Protokollin e KB-së për Armët e Zjarrit.

Sa i përket **abuzimit seksual të fëmijëve**, Seksioni i Krimeve Kibernetike dhe Forenzikës Digjitale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme fitoi qasje në bazën e të dhënave të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Megjithatë, vendi ende nuk është i lidhur me sistemin për eksploatim seksual të fëmijëve Interpol I-24/7.

Lidhur me **krimin kibernetik**, nuk ka raste të reja rreth ratifikimit të Protokollit të dytë plotësues të Konventës së Budapestit.

## Kapaciteti për zbatim dhe ekzekutim


Maqedonia e Veriut vazhdon të punojë në evidentimin e sendeve për ndjekje të krimit të organizuar. Numri i hetimeve mbetet i qëndrueshëm, megjithëse numri i aktgjykimeve të miratuara u zvogëluar dukshëm. U rrit numri i personave të akuzuar.

Shkëmbimi i informacioneve me Europoll për çështje penale dhe për projekte analitike u rrit dukshëm në vitin 2023 në krahasim me vitin paraprak. Numri i sendeve të hapura të reja në vitin 2023 në bazë të informacioneve të shkëmbyera u rrit, si dhe numri i mesazheve të shkëmbyera përmes aplikacioneve për shkëmbim të sigurt të informacioneve (SIENA).

Me Interpollin u shkëmbyen informacione për çështje të ndryshme lidhur me vepra penale, por Maqedonia e Veriut nuk është e lidhur me të gjitha bazat e të dhënave të Interpollit, për shembull, baza e të dhënave për eksploatim seksual të fëmijëve – ICSE.

Në vitin 2023, Maqedonia e Veriut mori pjesë në disa plane veprime operative të EMPAKT, në disa raste edhe si bashkëudhëheqës i aksioneve, si dhe në ditët për aksion të përbashkët (JAD). Shkupi ishte nikoqir i Qendrës Koordinuese Ndërkombëtare gjatë Ditëve për Aksion të Përbashkët për Evropën Juglindore (JAD EYL) 2023 të EMPAKT për përbashkët me tregti me armë zjarri, tregti me drogë, kontrabandë me emigrantë dhe trafikim me njerëz, si dhe rrjetet kriminale me rrezik të lartë. Maqedonia e Veriut merr pjesë në Aleancën Globale për luftë kundër kontrabandës së emigrantëve në nëntor 2023.

Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar planin vjetor për vitin 2024, i cili përmban aktivitete për politikën e zbulimit. Strukturat përgjegjëse për shtypjen e krimit të organizuar duhet të përmirësojnë kapacitetet operacionale dhe bashkëpunimin. U nevojitet financim të shtuar, pajisje, qasje në baza të të dhënave, personel dhe trajnim, si dhe harmonizim të legjislacionit me standardet evropiane dhe në



\*Të dhënat për lëndët e krimit serioz dalin nga të gjitha lëndët e pastrimit të parave, krimit kompjuterik, prodhimit dhe tregtisë me drogë, veprat penale lidhur me armën e zjarrit, terrorizmin, tregtinë me njerëz dhe kontrabandën me njerëz. Lëndët e korrupsionit janë dhënë në Kapitullin 23.

Në vitin 2023 janë evidentuar gjithsej 293 krime kompjuterike. Ashtu si në vitin 2022, sulmet me softuer shantazhimi (ransomware) janë krimet më të raportuara.

Veprat penale për eksploatim seksual të fëmijëve nëpërmjet internetit janë rritur me 28,6% në vitin 2023, pra janë regjistruar 18 vepra penale. Nga rastet e evidentuara janë zbardhur 13 krime dhe janë akuzuar 14 autorë.

Maqedonia e Veriut ka bërë përparim në ndjekjen e rekomandimeve të raundit të pestë të vlerësimit të Moneyval për vitin 2023.

Hetimet financiare mbeten një pikë e dobët e Maqedonisë së Veriut. Drejtoria e Policisë Financiare pranë Ministrisë së Financave ka hapur 220 hetime financiare në vitin 2023.

Gjithashtu, Drejtoria doganore ka nisur 20 hetime financiare, 18 prej të cilave janë edhe hetime financiare.

Në vitin 2023, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuara ka konfiskuar pronë dhe dobi pronësore, si dhe sendet në procedurë penale dhe kundërvajtëse, përkatësisht: dy pasuri të paluajtshme, 150 mjete motorike dhe 535.000 euro pasuri monetare pas aktgjykimit të formës së prerë.

### Bashkëpunimi në sferën e drogës

Bashkëpunimi në sferën e drogës duhet të përmirësohet.

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

Organi kryesor koordinues, Komisioni Shtetëror Ndërinstitucional për Luftimin e Prodhimit të Paligjshëm, Tregtisë dhe Keqpërdorimit të Drogave (IMCND), nuk është operativ. Vendi ka një Strategji Nacionale për Droga 2021-2025, e cila është e harmonizuar me strategjinë e BE-së. Kapaciteti operacional i Observatorit Nacional për Droga mbetet i kufizuar, pasi Observatorit i mungojnë resurset për të kryer detyrat e tij të përditshme për ndjekje të drogave. Ende nuk është krijuar një sistem për paralajmërim të hershëm.


Në vijim e sipër është procesi për përtëritjen e marrëveshjes me Agjencinë Evropiane të Barnave (EMA).

Legjislacioni nacional për drogat, substancat psikotropike dhe prekursorët nuk është në përputhje me ligjin e BE-së apo standardet ndërkombëtare, veçanërisht për krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm dhe shkëmbimin e shpejtë të të dhënave për substancat e reja psikotrope.

#### Kapaciteti për zbatim dhe ekzekutim

Numri i veprave penale të regjistruara në lidhje me tregtinë me drogë dhe numri i grupeve të shpërbëra të krimit të organizuar mbetet i qëndrueshëm, ndërsa numri i kryerësve të regjistruar është rritur. Maqedonia e Veriut ende nuk shkatërron droga.

Bashkëpunimi ndërkombëtar policor për të parandaluar tregtinë me drogë është i mirë. Në vitin 2023, rregullisht shkëmbehen informacione përmes kanaleve të krijuara me Europol, Interpol dhe Qendrën për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC). Gjithsej 789 mesazhe janë shkëmbyer përmes sistemit SIGMA të Evropës. Sipas SELEC, Maqedonia e Veriut ka iniciuar dy raste të tregtisë me drogë.



Gjatë periudhës raportuese nuk është shkatërruar asnjë drogë e konfiskuar.

### Lufta kundër terrorizmit

Lufta kundër terrorizmit është nivel të kënaqshëm. Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë t'i realizojë aksionet që janë dakorduar me Plan veprimin e përbashkët për luftë kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, ndërsa kornizën strategjike dhe

legjislative ta mbajë të përditësuar dhe të harmonizuar me të *drejtën* e BE-së dhe prioritetet e politikës.

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

Korniza legjislative e Maqedonisë së Veriut në masë të madhe është harmonizuar me të *drejtën* e BE-së dhe instrumentet ndërkombëtare për luftë kundër terrorizmit.

Maqedonia e Veriut ka koordinator të emëruar nacional për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit, pasi ish-koordinatori nacional dhe dy zëvendësit e tyre u shkarkuan në korrik 2024, para skadimit të mandateve të tyre. Maqedonia e Veriut parashtron raporte të rregullta dhe i zbaton aksionet që janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të Plan veprimit të përbashkët për luftë kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor.

Në janar 2024, Qeveria e miratoi Vlerësimin nacional të rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, që u përgatit sipas metodologjisë nga Raporti për gjendjen dhe trendin e terrorizmit në BE (TE-SAT).

Vendi nuk ka mekanizëm për udhëzim me qëllim parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.

#### Kapaciteti për zbatim dhe ekzekutim

Maqedonia e Veriut e zbaton Plan veprimin e përbashkët për luftimin e terrorizmit në Ballkanin Perëndimor dhe paraqet rregullisht raporte.

Ekziston nevoja për një ndarje më të qartë të pushteteve, detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet aktorëve në nivel lokal dhe qendror të përfshirë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Aktualisht, masat zbatohen nga këshillat lokale për parandalim, gjashtë ekipe të veprimit në komunitet dhe nëntë ekipe lokale multidisiplinare.

Strategjia për zhvillimin e sistemit penitenciar (2021-2025) përfshin masa kundër radikalizimit në burgje. Aktualisht, burgjet lejojnë ndërveprimin midis njerëzve të dënuar për vepra terroriste dhe të burgosurve të tjerë, gjë që rrit rrezikun e radikalizimit dhe potencialisht mund të çojë në lidhje midis terrorizmit dhe krimit të organizuar. Shërbimet e sigurisë duhet të përfshihen më aktivisht në aktivitetet dhe proceset para dhe pas lirimit të personave nga burgju.

Radikalizimi online mbetet një nga format më të përhapura të radikalizimit. Për përballimin e këtij fenomeni nevojiten resurse adekuate financiare dhe njerëzore, pajisje dhe trajnim profesional. Në periudhën raportuese nuk është regjistruar asnjë rast i riadhesimit të luftëtarëve të huaj terroristë.

Në periudhën raportuese, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Njësia e Hetimeve Financiare pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe sektorët tjera kompetente pranë Agjencisë së Sigurisë Nacionale dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë dorëzuar 18 urdhëresa dhe iniciativa për kryerjen e analizës bazuar në dyshimet për financim të terrorizmit dhe pastrim parash.


#### **Bashkëpunimi gjyqësor në materie civile dhe penale**

Bashkëpunimi gjyqësor në materie civile dhe penale duhet të përmirësohet.

Numri i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në materie civile bie vazhdimisht, ndërsa numri i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në materie penale mbetet i qëndrueshëm.



Progresi lidhur me kornizën juridike për bashkëpunim në materien civile dhe penale është kufizuar. Propozim-ligji për ratifikimin e Konventës së Hagës nga 30 qershori 2005 për zgjedhjen e marrëveshjeve gjyqësore është në procedurë të Kuvendit. Maqedonia e Veriut duhet ta ratifikojë Konventën e Hagës për mbrojtje të fëmijëve nga viti 1966, Konventa e Hagës për mbështetjen e fëmijëve nga viti 2007 dhe Protokolli për të drejtën meritorë që do të aplikohet në detyrimet për mbajtje, që tashmë janë nënshkruar. Vendi duhet t'i ndëmarrë masat e domosdoshme në lëndët civile ose tregtare nga viti 2019 ("Konventa e Hagës për aktgjykime").



Në shkurt 2024, Ministri i Drejtësisë nënshkroi Konventën Lubjanë-Hagë për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Hetimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit, Krimeve Kundër Njerëzimit, Krimet e Luftës dhe Krimet e tjera Ndërkombëtare.

Vazhdon bashkëpunimi me Eurodrejtësi. Prokurori për lidhje me Eurodrejtësinë i Maqedonisë së Veriut zyrtarisht u emërua në shkurt të vitit 2024, por Qeveria ende nuk ka siguruar fondet e nevojshme që të bëhet plotësisht operativ. Prokurori me lidhje me Eurodrejtësi u përfshi në mënyrë aktive në asistimin e hetimeve. Në vitin 2023, objekti i punës përfshinte 95 lëndë, nga të cilat 36 ishin të reja. Maqedonia e Veriut ka një angazhim pune me EPPD.

Janë nënshkruar katër marrëveshje të ekipit të përbashkët hetimor (EPH).

### **Emigracioni ligjor dhe kundërligjor**

Menaxhimi me emigracionin ligjor dhe joligjor duhet të përmirësohet.

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

Maqedonia e Veriut ka dokumente strategjike për migracionin, duke përfshirë Strategjinë Nacionale për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2021-2025 dhe Planin e Veprimit shoqëruar për 2022-2025 dhe Rezolutën e Politikës së Migracionit 2021-2025.

Vendi vazhdon të menaxhojë në mënyrë aktive flukset e përziera të migracionit. Korniza ligjore është kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Kapaciteti institucional dhe administrativ duhet të forcohet duke shtuar burimet njerëzore, teknike dhe materiale.

Ligji për punësimin dhe punën e të huajve dhe legjislacioni për të drejtën e bashkimit familjar në rastin e partneriteteve të regjistruara duhet të harmonizohet më tej me ligjin e BE-së.

Në përgjithësi, Maqedonia e Veriut duhet të forcojë kapacitetet institucionale dhe administrative për menaxhimin e migracionit duke rritur numrin e të punësuarve dhe duke siguruar resurse shtesë materiale dhe teknike.


Në vitin 2023, gjithsej 235 romë, ashkali dhe egjiptianë nga Kosova mbetën në vend, prej të cilëve 160 kishin skaduar mbrojtjen ndërkombëtare. Këta persona ishin në pozitë vulnerable për shkak të mungesës së statusit ligjor dhe qasjes së mjaftueshme në të drejtat themelore. Megjithatë, kjo çështje është zgjidhur. Shumica e 190 refugjatëve morën dokumente që u

jepnin të drejtën për të qëndruar në Maqedoninë e Veriut dhe disa morën shtetësi nga Kosova.

### Kapaciteti për zbatim dhe aplikim

Arritjet nga Siria shënuan rënie në vitin 2023, ndërsa arritjet nga Aganistani vazhdimisht shënojnë rënie. Megjithatë, arritjet nga Maroko janë në rritje. Numri i rasteve të emigrantëve të kontrabanduar në vitin 2023 shënuan rritje, ndërsa numri i emigrantëve të kontrabanduar të zbuluar në vitin 2023 ishte i ngjashëm me atë të vitit 2022.

Evidentimi sistematik i migrantëve dhe profilizimi i ndjeshëm ndaj mbrojtjes mbeten prioritet. Fragmentimi i detyrave nëpër institucione e bën menaxhimin e migracionit më pak efikas. Në përputhje me kërkesat e BE-së, Fronteks ka kryer një analizë të thellë, duke ofruar një plan zbatimi gjithëpërfshirës



dhe të detajuar për zhvillimin e sistemeve të TI-së që janë interoperabilë me sistemet e TI-së të BE-së dhe infrastrukturën e komunikimit për të përcaktuar dhe evidentuar flukset e migracionit.

Dy qendrat e përkohshme transite për akomodim afatshkurtër, me një kapacitet total prej 2000 personash, janë të papërshtatshme për qëndrime më të gjata. Statusi i tyre ende nuk është në përputhje me standardet ligjore kombëtare dhe atyre u mungojnë shërbimet adekuate të mbrojtjes si ndihma dhe interpretimi mjekësor ose psiko-social.

Evidenca e emigrantëve të paligjshëm të arrestuar është përmirësuar ndjeshëm që kur Fronteks filloi të operojë në kufirin jugor. Ekziston nevoja për të forcuar luftën kundër kontrabandës së emigrantëve duke synuar anëtarët individualë të grupeve të kontrabandës së emigrantëve, duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Maqedonia e Veriut vazhdon të zbatojë marrëveshjet e ripranimit me vendet e BE-së. Vendi ka një marrëveshje me BE-në dhe protokolle zbatuese me 11 shtete anëtare dhe marrëveshje dypalëshe ripranimi me tetë vende jashtë BE-së. Maqedonia e Veriut po negocion protokolle shtesë. Sfidë mbetet numri i pamjaftueshëm i marrëveshjeve të ripranimit me vendet e origjinës.

Ndalimi arbitrar i migrantëve të paligjshëm në qendrën e paraburgimit në Gazi Babë, që do të silllet në Gjykatën Penale për të dhënë deklaratë, mbetet shqetësuese edhe më tutje. Evidentimi i kërkesave për azil u rrit ndjeshëm në vitin 2023 në 59.3% (nga 19.6% në 2022). Mungon një kontroll efektiv gjyqësor mbi praktikën e ndalimit dhe emigrantët e ndaluar marrin vetëm këshilla ligjore dhe ndihmë në procedurën e azilit. Kushtet e jetesës janë ende të pakënaqshme, sipas Mekanizmit Parandalues Nacional pranë Avokatit të Popullit.

### **Azil**

Duhet të përmirësohet menaxhimi me azilin.

### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

Pavarësisht harmonizimit të pjesshëm me të drejtën e BE-së, legjislacioni për azilin nuk përparoi gjatë periudhës raportuese dhe cilësia e procedurave të azilit mbetet një shqetësim.

Mungesa e numrave personal të identifikimit për azilkërkuarit mbetet një pengesë kritike për qasjen e tyre sistematik në të drejta të tilla si punësimi, hapja e një llogarie bankare ose marrja e diplomave për arsim të mbaruar. Letërnjoftimet nuk lëshohen menjëherë pas paraqitjes së kërkesës për azil dhe nuk janë në një format të lexueshëm nga makina, ndryshe nga dokumentet që u lëshohen shtetasve të tjerë joshtetas.

Vendimet për azil nuk kanë arsyetim ligjor dhe vlerësime të individualizuara. Nevojitet staf i kualifikuar për të punuar në rastet e azilit në nivel administrativ. Mungesa e shërbimeve të përkthimit të financuara nga shteti gjatë procedurës së azilit është ende një mungesë e madhe.


Nevojiten gjithashtu përpjekje për të përmirësuar sigurimin e informacioneve dhe këshillimit për mbrojtjen ndërkombëtare në objektet e paraburgimit dhe në pikat kufitare. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të adresuar bashkimin e vonuar familjar për personat nën mbrojtje shtesë, dhe veçanërisht për të miturit e pashoqëruar.

Është krijuar gjenerata e tretë e Udhërrëfyesit për bashkëpunim për të cilin është rënë dakord ndërmjet Agjencisë për Azil të Bashkimit Evropian (AABE) dhe Maqedonisë së Veriut për 2023-2025, e cila mbetet një mjet kryesor për forcimin e sistemit të azilit dhe pranimit. Bashkëpunimi me AABE është i mirë, por nevojitet përparim i mëtejshëm, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të kushteve të pritjes, duke përfshirë edhe azilkërkuarit me nevoja të veçanta.

### Cilësia për zbatim dhe ekzekutim

Maqedonia e Veriut mbetet një vend transit. Megjithatë, kërkesat për azil në vend u rritën ndjeshëm nga 168 në vitin 2022 në 604 në vitin 2023. Ka pasur një rritje të madhe të kërkesave për azil nga Maroku. Megjithatë, asnjë individ nuk i është dhënë statusi i refugjatit që nga viti 2016.

Zbatimi i procedurës së azilit nuk është në përputhje me ligjin e BE-së. Vendimet e dëbimit



merren pa vlerësim cilësor dhe pa u siguruar që azilkërkuesit e kthyer të mos përballen me persekutim në vendin e tyre të origjinës. Procedurat e azilit janë të gjata dhe mund të zgjasin disa vite nga data e regjistrimit të parë.

Nuk ka asnjë kornizë ligjore për integrimin e azilkërkuesve dhe asnjë qasje gjithëpërfshirëse ndaj integritimit. Aktivizimi i ndihmës sociale dhe sigurimit shëndetësor për personat me mbrojtje ndërkombëtare është vonuar.

Regjistrimi i fëmijëve të azilkërkuesve në arsimin fillor vazhdoi siç parashihet në Ligjin për arsimin fillor, por jo gjithmonë menjëherë pas mbërritjes. Një proces i gjatë verifikimi i diplomës ose pamundësia për të siguruar dokumente nuk duhet të prolongohet regjistrimi në shkollë. E njëjta gjë duhet të vlejë edhe për arsimin e mesëm.

### **Politika e vizës**

Regjimi i vizave është kryesisht në përputhje me listat e BE-së për vendet të cilat detyrimisht duhet doemos të posedojnë viza dhe ato me regjim pa viza, përveç Turqisë, shtetasit e së cilës i nënshtrohen vizave për të hyrë në zonën Shengen, por mund të hyjnë në Maqedoninë e Veriut pa vizë. Në raportin e gjashtë të Komisionit në kuadër të Mekanizmit për pezullimin e regjimit të vizave për vitin 2023, thuhet se Maqedonia e Veriut ka vazhduar të ndër marrë veprime për të vepruar sipas rekomandimeve të mëparshme të Komisionit dhe rekomandon që Maqedonia e Veriut të vazhdojë me këtë progres të mirë. Sipas Eurostat, në vitin 2023, 6,760 qytetarë të Maqedonisë së Veriut kanë aplikuar për azil në BE27 (një rritje e lehtë prej 2% krahasuar me 6,605 në 2022).

### **Shengeni dhe kufijtë e jashtëm**

Korniza legjislative për menaxhimin me kufijtë e jashtëm në masë të madhe është harmonizuar me të drejtën e BE-së.

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

Në periudhën e raportit nuk ka ndryshime më të mëdha në Njësinë për punë kufitare dhe emigracione. Marrëveshja e statusit për bashkëpunim të Maqedonisë së Veriut dhe BE-së zbatohet pa probleme, përmes operacionit të përbashkët të Fronteksit dhe Maqedonisë së Veriut.

Zbatimi i Strategjisë për menaxhim të integruar kufitar dhe plani adekuat i veprimit është në vijim e sipër. Vazhdon bashkëpunimi tejkufitar me vendet fqinje.

Megjithëse për vonesë, vendi është në proces të ndryshimit të të gjitha dokumenteve të udhëtimit që ta fusë emrin Maqedonia e Veriut, në pajtim me Marrëveshjen e Prespës. Dokumentet e vjetra të udhëtimit nuk vlejnë nga 12 prilli 2024 dhe Maqedonia e Veriut nuk lejoi hyrje nga shteti të qytetarëve me dokumentet e vjetra të udhëtimit.

#### Kapaciteti për zbatim dhe ekzekutim

Bashkëpunimi me shërbimet kufitare kompetente të Shqipërisë, Bullgarisë, Kosovës dhe Serbisë zbatohet në pajtim me Katalogun e Shengenit me rekomandimet dhe praktikat më të mira. Marrëveshjet vijuese u nënshkruan dhe zbatohen: Marrëveshja për lirinë e qarkullimit me letërnjoftime (Ballkani Perëndimor); Marrëveshja për rregullimin e regjimit për qarkullim kufitar lokal; dhe Marrëveshja për ndjekje sistimore të kryerësve të veprave penale.

## Falsifikimin e euros (aspekti i të drejtës penale)

Legjislacioni relevant në masë të madhe është harmonizuar me të drejtën e BE-së për çrrënjosje të valutave të falsifikuara.

Të gjitha aspektet e bashkëpunimit doganor janë përfshirë në Kapitullin 29 – Unioni Doganor.

### 2.3. KRITERET EKONOMIKE

<i>Tabela 7.1:</i>	2015-20	2021	2022	2023
<b>Maqedonia e Veriut – numrat ekonomike kryesore</b>	mesatare			
<b>PBV për kokë banorë (% од BE-27 në P.P.)<sup>1)</sup></b>	41	33	42	41
<b>Rritje reale e PBV-së</b>	1,6	4,5	2,2,	1,0
<b>Shkalla e aktivitetit ekonomik e popullsisë në moshë 15-64 vjet (%)</b> , gjithsej	65,3	66,8	66,4	65,4
<i>Femra</i>	52,6	55,1	54,3	54,7
<i>Meshkuj</i>	77,7	78,4	78,4	76,0
<b>Shkalla e papunësisë së popullsisë në moshë 15-64 vjet (%)</b> , gjithsej <sup>2)</sup>	21,3	15,8	14,5	13,2
<i>Femra</i>	20,8	13,8	12,6	11,4
<i>Meshkuj</i>	21,6	16,9	15,9	14,4
<b>Punësia e popullsisë në moshë 15-64 vjet (rritja vjetore %)<sup>2)</sup></b>	2,3	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	-0,2
<b>Pagat nominale (rritja vjetore %)</b>	4,4,	5,7	11,1	15,3
<b>Indeksi i çmimeve të konsumit (rritja vjetore %)</b>	0,7	3,2	14,2	9,4
<b>Kursi devizor në raport me EUR</b>	61,58	61,63	61,62	61,56
<b>Saldoja e llogarive rrjedhëse (% e PBV-së)</b>	-1,8	-2,8	-6,1	0,7
<b>Investimet e drejtpërdrejta neto-të huaja, IDH (% e PBV-së)</b>	2,9	3,3	5,0	3,8
<b>Bilanci i përgjithshëm shtetëror (% e PBV-së)</b>	-3,4	-5,3	-4,4	-4,9
<b>Borxhi i përgjithshëm shtetëror (% e PBV-së)</b>	41,5	51,4	50,5	53,1

#### Shënime:

1) Eurostati

2) Nga tremujori në vitin 2022, Anketa për fuqinë punëtore bazohet në rezultatet e Regjistrimit të popullsisë nga viti 2021, me çka kufizohet krahasueshmëria me të dhënat nga viti paraprak. Deri më tani, Enti i Statistikës i ka rishikuar të dhënat nga viti 2017 deri në vitin 2021 në bazë të të dhënave nga Regjistrimi.

Burimi: burime nacionale

#### 2.3.1. Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut

##### Menaxhimi ekonomik

**Qeveria filloi punën për reformat kryesore.** U formua Këshilli i ri fiskal, pavarësisht disa pengesave në punësim, dhe u miratuan rregullat dhe statutet e tij. Në Ministrinë e Financave u formua Sektor i ri për menaxhim me investimet publike, por puna e tij ende është vështirësuar për shkak të çështjeve kadrovike dhe TI-së. Qeveria hoqi disa masa jo të synuara për mbështetjen e energjisë dhe, në fund të vitit 2023, futi disa reforma në tregun e energjisë elektrike, duke përfshirë një reduktim gradual të tregut të rregulluar, i cili pritet të


çojë në një ngarkesë fiskale më të ulët. Kuvendi miratoi ndryshime në disa ligje tatimore, të cilat reduktojnë shpenzimet tatimore dhe zgjerojnë bazën e të ardhurave.

**Udhëzimet e politikave që u dakorduan bashkërisht në Dialogun Financiar dhe Ekonomik në maj 2023 janë zbatuar pjesërisht.** Krahas reformave fiskale, qeveria ka marrë masa për përballimin e ekonomisë informale dhe nxitjen e investimeve për efikasitet energjetik. Gjithashtu miratoi tre ligje kryesore në fushën e arsimit dhe forcoi politikat aktive të tregut të punës. Maqedonia e Veriut përmbushi kushtet e politikës në lidhje me këstin e parë (50 milionë euro) të ndihmës makro-financiare të BE-së, e cila u pagua në maj 2024. Në janar, FMN-ja përfundoi shqyrtimin e parë të linjës për kujdes dhe likuiditet (LKL), e cila u mundëson organeve qasje në rreth 200 milionë euro.

### Stabiliteti makroekonomik


#### Rimëkëmbja e ekonomisë pas pandemisë ka mbetur e dobët.

Rritja vjetore e PBV-së ra në rreth 1% në vitin 2023, që paraqet ulje prej 2.2% në vitin 2022, për shkak të kërkesës së dobët vendore. Formimi i kapitalit bruto u zvogëluua ndjeshëm, kryesisht si rezultat i reduktimit të rezervave. Rritja e konsumit të familjeve u ngadalësua pavarësisht forcimit të rritjes së pagave, remitançave dhe mbështetjes së qeverisë. Bilanci i jashtëm kontribuoi ndjeshëm në rritjen ekonomike, ndërkohë që importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie të theksuar, në kuadër të rënies së çmimeve globale të energjisë. Në gjysmën e parë të vitit 2024, PBV-ja u rrit mesatarisht me 1.8%, kryesisht si pasojë e rënies së madhe të importeve, duke kompensuar tej mase për rënieën e njëkohshme të eksporteve. Kërkesa vendore mbeti e dobët dhe rritja e konsumit familjar u ngadalësua më tej, përkatësisht mesatarisht 1,4%, pas rritjes prej 2,4% në vitin 2023, ndërkohë që kontributi pozitiv nga investimet reflektoi në masë të madhe efektet bazë. Konvergjenca me nivelet e të ardhurave të BE-së ka mbetur e ngadaltë, me ç'rast PBV-ja reale për kokë banorë u rrit prej 37% e mesatares së BE-27 në vitin 2017 në 43% në vitin 2021 dhe më pas duke rënë gradualisht në 41% në vitin 2023.



#### Pozita e jashtme e vendit u përmirësua dukshëm.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse i cili u rrit në 6.1% të PBV-së në vitin 2022 për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, u përmirësua gradualisht gjatë vitit 2023 në një suficit vjetor prej 0.7% të PBV-së. Me uljen e çmimeve të energjisë dhe rritjen e prodhimit vendor të energjisë elektrike, e cila uli nevojën për import të energjisë, deficiti tregtar u ul me 7.6 pikë përqindje (p.p) në 18.9% të PBV-së. Kjo u shoqërua me rritje të remitançave, ndërkohë që suficiti në bilancin e




shërbimeve u zvogëlua dhe deficitin në bilancin primar u përkeqësua. Megjithatë, në gjysmën e parë të vitit 2024 llogaria rrjedhëse kaloi përsëri në deficit pasi bilanci tregtar u përkeqësua dhe remitancat u zvogëluan, në krahasim me nivelin vjetor. Investimet e huaja të drejtpërdrejta, me rreth 3.8% të PBV-së, ishin më të ulëta se në vitin 2022 (5%), por ende mbi mesataren 5-vjeçare. Ato u rikuperuan ndjeshëm në gjysmën e parë të 2024 dhe arritën në 4.9% të PBV-së. Megjithatë, ekonomia mbetet e ndjeshme ndaj një rritjeje potenciale të mëtejshme të çmimeve të energjisë, duke pasur parasysh intensitetin e lartë të energjisë së vendit dhe varësinë ende të lartë nga importet e energjisë. Rezervat valutore u rritën ndjeshëm në vitin 2023 dhe shënuan rritje prej 16.5% nga viti në vit në fund të korrikut 2024, duke mbuluar rreth 4.2 muaj importe të mundshme. Borxhi i jashtëm bruto, pa transaksionet e Bankës Popullore, në fund të tremujorit të parë arriti në 85% të PBV-së, ndërsa struktura e tij, e dominuar nga financimi afatgjatë dhe financimi me normë fikse interesi, paraqet rrezik të vogël.

**Inflacioni u ngadalësua, gjë që i mundësoi Bankës Popullore të ndërpresë shtrëngimin e politikës monetare.** Inflacioni vjetor arriti kulmin në tetor 2022 në 19.8%, pas së cilës shënonte rënie gradualisht në vitin 2023 për shkak të nivelimit global të çmimeve të ushqimeve dhe energjisë dhe shtrëngimit të politikës monetare. Inflacioni mesatar vjetor ra nga 9.6% në vitin 2023 në 3.8% mesatarisht në gjysmën e parë të vitit 2024, duke u ulur në 2.2% në gusht. Me një rritje të lartë të pagës nominale, edhe inflacioni bazë u ngadalësua, megjithëse me ritme më të ngadalta. Nga shtatori 2023, Banka Popullore e mbajti të pandryshuar normën bazë të interesit në 6.3%.

**Deficiti fiskal është rritur, pavarësisht masave tatimore për rritjen e të ardhurave.** Me 4,9% të BPV-së, deficiti buxhetor për vitin 2023 u rrit dhe ishte pak më i lartë se qëllimi fillestar i Qeverisë (4,8%), pjesërisht për shkak të rritjes së BPV-së më të dobët se rritja e projektuar. Në shtator 2023, i domosdoshëm ishte rishpërndarja e buxhetit, kryesisht për t'i përshtatur rrogat e larta në sektorin publik, pensionet dhe transfertat sociale, ndërsa qëllimi fillestar i deficitit mbeti i pandryshuar. Realizimi i lartë i shpenzimeve kapitale në vitin 2023, përkatësisht 97% e qëllimit fillestar të Qeverisë, që është dukshëm mbi mesataren e 5 viteve të mëparshme (83%), është kryesisht për shkak të pagesës së parakohshme të 230 milionë euro në favor të konsorciumit ndërtimor të ngarkuar për ndërtimin e segmenteve rrugore të Korridoreve 8 dhe 10d, si dhe 80 milionë euro subvencione për prodhuesin vendas të energjisë elektrike. Në vitin 2023, të ardhurat u rritën për 14% në nivel vjetor, të inkurajuar nga "tatimi i njehershëm i solidaritetit" mbi tepricën e fitimit korporativ. Ndryshimet në disa ligje tatimore për të zgjeruar bazën tatimore hynë në fuqi në tetor 2023. Në vjeshtën e vitit 2023, Kuvendi miratoi ndryshime të mëtejshme në disa ligje për shfuqizimin e lirimeve tatimore, veçanërisht në Ligjin për akcizat, Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, Ligjin për tatimin mbi fitim dhe Urdhëresën për mënyrën e llogaritjes së tatimit të mjeteve motorike, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2024. Në shtatë muajt e parë të vitit 2024, të ardhurat kanë qenë më të larta për 12,6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kryesisht si pasojë e rritjes së tatimeve dhe kontributeve, ndërsa shpenzimet janë rritur për 7,8%. Deficiti i përgjithshëm i Qeverisë është ulur për 19,5% gjatë kësaj periudhe. Në korrik, Qeveria e re miratoi rebalancin e buxhetit për vitin 2024, ndërsa Kuvendi e miratoi në gusht. Me rebalancin parashikohet rritja e të ardhurave dhe shpenzimeve krahasuar me qëllimet fillestare, me ç'rast rritja e deficitit të planifikuar do të rritet nga 3,4% të planifikuar më parë - siç ishte rënë dakord me FMN-në - në 4,9% të BPV-së së parashikuar.

**Borxhi publik në mënyrë shtesë u rrit gjatë periudhës raportuese, dhe megjithëse është ende relativisht i lartë, struktura e tij paraqet rrezik të ulët.** Në vitin 2023, shkalla e borxhit publik u rrit për 3 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2022. Ai ishte 62,1% të BPV-së, që ishte dukshëm mbi nivelin e pesë viteve më parë (48,4%). Rritja e reflekton kryesisht rritjen e borxhit total dhe të përgjithshëm shtetëror gjatë kësaj periudhe (+12,7 p.p.), ndërsa pjesa tjetër i referohet borxhit më të lartë të ndërmarrjeve të sektorit publik që i financojnë projektet e mëdha qeveritare për infrastrukturën energjetike dhe transportuese. Pjesa e borxhit me shkallë kamatare fikse në borxhin e përgjithshëm ka mbetur e lartë dhe është 74%. Borxhi në valutat e huaja, kryesisht i denominuar në euro, është 71% të borxhit të përgjithshëm, diçka më pak krahasuar me vitin 2022<sup>10</sup>. Kursi devizor *de facto* i lidhur me euron nënkupton cenueshmëri të kufizuar të borxhit që rezultojn nga fluktuacionet në vlerën e denarit. Duke pasur parasysh investimet e



referohet borxhit më të lartë të ndërmarrjeve të sektorit publik që i financojnë projektet e mëdha qeveritare për infrastrukturën energjetike dhe transportuese. Pjesa e borxhit me shkallë kamatare fikse në borxhin e përgjithshëm ka mbetur e lartë dhe është 74%. Borxhi në valutat e huaja, kryesisht i denominuar në euro, është 71% të borxhit të përgjithshëm, diçka më pak krahasuar me vitin 2022<sup>10</sup>. Kursi devizor *de facto* i lidhur me euron nënkupton cenueshmëri të kufizuar të borxhit që rezultojn nga fluktuacionet në vlerën e denarit. Duke pasur parasysh investimet e

<sup>10</sup> Në vitin 2023, Qeveria rriti lëshimet e brendshme mbi planin fillestar, pasi disa pagesa të planifikuara për hua të huaja ishin afatgjata.



mëdha të nevojshme për t'i arritur qëllimet e dekarbonizimit të vendit dhe nevojën për të mobilizuar burime të reja të financimit, Qeveria e emetoi obligacionin e parë të gjelbër në tetor 2023.

**Miratimi i legjislacionit për zbatimin e Ligjit për buxhete (LB) po përparon ngadalë.** LB-ja, i cili u miratua nga Kuvendi në shtator të vitit 2022 dhe duhet të hyjë plotësisht në fuqi deri më 1 janar 2025, prezanton rregullat fiskale<sup>11</sup> dhe Këshillin Fiskal dhe e forcon procedurën buxhetore afatmesme. Kuvendi i emëroi anëtarët e Këshillit Fiskal dhe u caktoi detyra pune, por rekrutimi i personalit në Sekretariatit e Këshillit ishte i vështirë. Ishte vonuar miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e LB-së. Kjo i përfshin aktet kryesore zbatuese për futjen e klasifikimeve buxhetore, për shembull, që do të futen për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit deri në vitin 2025. Rreziqet fiskale janë të rëndësishme, të ndjekura në mënyrë të pamjaftueshme, ndërsa disa prej tyre, të tilla si detyrimet e paparapara që rrjedhin nga partneritetet private publike (PPP) dhe subjektet e tjera jashtë buxhetit, nuk paraqiten sistematikisht në pushtetin qendror<sup>12</sup>. Ndërtimi i segmenteve rrugore të Korridoreve 8 dhe 10d, të cilat parashihen të kushtojnë 1,3 miliardë euro (11,5% të BPV-së në vitin 2023) dhe të përfundojnë brenda 6 viteve, është lëndë e kushteve të paqarta kontraktuese dhe ekziston rreziku i tejkalimeve të konsiderueshme të shpenzimeve dhe për shkak të mungesës së kontrollit të duhur, me të cilin Qeveria është përballur pjesërisht në vitin 2023 me kërkesë të FMN-së. Reformat për modernizimin e kornizës juridike për PPP-të janë në ngecje.

**Kombinimi i politikave nuk ka arritur t'i tejkalojë plotësisht sfidat e paraqitura nga inflacioni i lartë.** Politika monetare ishte zgjatur në mënyrën e duhur për shkak të rritjes së shpejtë të inflacionit. Më pas u bë neutrale kur inflacioni u zvogëlua, ndërsa politika fiskale u zgjerua, duke siguruar rritje ad hok të rrogave në sektorin publik për 10%, që hyri në fuqi në shtator 2023, dhe rritje ad hok të pensioneve (përshtatja prej 5,3% nga marsi 2024 dhe shuma lineare prej 2.500 denarë për të gjithë pensionistët në dy raste). Kjo jo vetëm që i rrit rreziqet e brendshme nëse ka rritje të mëtejshme të inflacionit, por i rrit edhe rreziqet fiskale tashmë të rritura.

#### Funksionimi i tregjeve të produkteve

##### *Mjedisi afarist*

**Sfidat e sjella nga ekonomia e madhe joformale nuk u tejkaluan me vendosmëri.** Ekonomia e madhe joformale, e cila, sipas vlerësimeve të FMN-së, merr pjesë deri në 38% të BPV-së, e minon konkurrencën e shoqërive tregtare vendase. Sektori joformal në vend ka forma të ndryshme, ndër të cilat më të spikatura janë fuqia punëtore e paparazitur, rrogat pjesërisht të paparazitura dhe parregullsitë e tjera në zbatimin e Ligjit për marrëdhënie pune. Kjo i shqetëson subjektet afariste lokale, pasi e prish konkurrencën, e zvogëlon cilësinë e mjedisit afarist, çon në të ardhura të pamjaftueshme publike, ndërsa disa punëtorë mbesin pa mbrojtje sociale. Në qershor 2023, Qeveria e miratoi strategjinë e re dhe planin e veprimit për vitet 2023-2025 për formalizimin e ekonomisë joformale. Zbatimi i strategjisë qeveritare dhe planit të veprimit për vitin 2018 për luftën kundër ekonominë joformale ka qenë i ngadalshëm.

---

<sup>11</sup> Ligji i ri për buxhete fut kufizimin prej 3% për deficitin e përgjithshëm shtetëror dhe kufizimin prej 60% për borxhin e përgjithshëm shtetëror (në thelb zbatohet nga viti 2023, por është pezulluar deri në vitin 2025 si përgjigje e klauzolës së largimit).

<sup>12</sup> Ligji i ri për buxhete kërkon që Qeveria të përfshijë përkrahim të rreziqeve fiskale (të paktën ato që janë pjesë e detyrimeve potenciale të Qeverisë) në strategjinë fiskale vjetore, ndërsa Këshilli Fiskal t'i vlerësojë rreziqet fiskale që lidhen me subjektet e ndryshme publike, duke përfshirë ndërmarrjet publike dhe partneritetet private publike.

## *Ndikimi i shtetit në tregun e produkteve*

**Transparenca dhe efikasiteti i ndihmës shtetërore janë ende të pakënaqshme.** Transparenca dhe efikasiteti i ndihmës shtetërore ndikohet nga numri i lartë i ofruesve të ndihmës shtetërore, mungesa e regjistrimit të përditësuar dhe kompetencat ende marginale të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) në mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore. Informacionet publike për ndihmën shtetërore që Qeveria ua jep shoqërive tregtare nuk janë të plota, ndërsa kriteret për zgjedhjen e shfrytëzuesve janë shpesh të paqarta. Si parakusht për hartimin e regjistrimit për ndihmën shtetërore, Qeveria vendos sistem të informacioneve të menaxhimit që lidh institucione të ndryshme, por procesi vonohet.

## *Privatizimi dhe ristrukturimi*

**Pjesa e sektorit publik në ekonomi është e ulët.** Në vitin 2023, numri i ndërmarrjeve në pronësi të plotë shtetërore u zvogëlua për një, në 14. Numri i ndërmarrjeve në pronësi pjesërisht shtetërore mbeti 38, me ç'rast në shumicën e të cilave pjesa e pronësisë shtetërore është nën 1% të kapitalit të emetuar<sup>13</sup>. Vlera e përgjithshme e pronësisë shtetërore në ndërmarrje u zvogëlua, nga rreth 10% të BPV-së në vitet e mëparshme, në 8%.

## Funksionimi i tregut financiar

**Sektori bankar u tregua i rezistueshëm, ndërsa pakoja e masave makroprudente u forcua.** Shkalla e adekuatshmërisë së kapitalit të bankave u rrit në 17,2% në fund të vitit 2023, duke tejkaluar ndjeshëm minimumin rregullator prej 8%. Kontributi i tyre i kapitalit u rrit në 16,1%. Likuiditeti ishte i mjaftueshëm, ndërsa mjetet likuide përbënin mbi një të tretën e mjeteve të përgjithshme në fund të vitit 2023. Raporti i kredive jofunksionale në kreditë e përgjithshme për sektorin jofinanciar ra në nivel të ulët rekord prej 2,8%. Megjithatë, ndërmjetësimi financiar është ende relativisht i dobët, me mjetet e sektorit financiar nën 90% të BPV-së. Diversifikimi po përparon ngadalë, me ç'rast bankat përbëjnë pothuajse 80% të mjeteve të përgjithshme të sektorit financiar në fund të vitit 2023. Pjesa e kapitalit të huaj në kapitalin e përgjithshëm të bankave vazhdon të jetë e lartë, përkatësisht rreth 79%. Rritja vjetore e depozitave u përshpejtua në vitin 2023 në kushtet e shkallëve më të larta kamatare, ndërsa kreditimi bankar i sektorit privat e humbi dinamikën (-3,4 p.p. në nivel vjetor deri në 6,2%). Financimi i huave nëpërmjet depozitave mbeti solid, me ç'rast raporti kredi-depozita për klientët jofinanciarë ishte 81,6% në fund të vitit 2023. Në mënyrë shtesë, korniza makroprudente u forcua. Banka Popullore vazhdoi të zbatojë rritje graduale në shtresën mbrojtëse kundërciklike të kapitalit dhe vendosi masa makroprudente që synojnë shfrytëzuesit e kredive për të reduktuar cenueshmëritë në tregun e patundshmërive. Në tetor 2023, Kuvendi e miratoi Ligjin për zgjidhjen e bankave, ndërsa Ligji për Fondin e Sigurimit të Depozitave nuk është miratuar ende.


## Funksionimi i tregut të punës

**Tregu i punës e ka humbur pjesërisht dinamikën.** Rritja e punësimit në mënyrë të pakonsiderueshme u zvogëlua në vitin 2023 krahasuar me vitet e mëparshme, ndërsa daljet e fuqisë punëtore u bënë më të theksuara. Mesatarisht, shkalla e papunësisë ra në 13,2% në vitin 2023, krahasuar me 14,5% në vitin 2022. Pjesa e tregut të punës u zvogëlua në 65,4% (-1 p.p. në vit), si rezultat i shkallës më të ulët të aktivitetit të meshkujt, ndërsa shkalla e femrave u rrit lehtë. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (nga 15 deri në 24 vjeç) u zvogëlua për 3,2 p.p., në 29,3%, duke reflektuar rënien e fortë të fuqisë punëtore në këtë grupmoshë (-5,5% në nivel vjetor).

---

<sup>13</sup> Numrat bazohen në informacionet e Qeverisë. Baza globale e re e të dhënave e harmonizuar dhe e standardizuar ndërkombëtare për ndërmarrjet me pronësi shtetërore (NPSH) e Bankës Botërore tregon se ekzistojnë 88 NPSH, nga të cilat 35 janë 100% në pronësi të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut.

Maqedonia e Veriut ka zbatuar Garancinë për të Rinjtë që nga viti 2018, e cila ka ndihmuar në uljen e ndjeshme të papunësisë së të rinjve në vitet e fundit, por megjithatë, ajo është ende e lartë. Rroga nominale mesatare bruto u rrit për 15,3% në nivel vjetor në vitin 2023, me ç'rast rritja vjetore arriti 16,8% në janar. Në thelb, rrogat u rritën për 5,4% në vitin 2023 dhe për 13,2% shtesë në janar 2024, duke reflektuar rënie të mprehtë të mëtejshme të inflacionit.



### 2.3.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut në Bashkimin Evropian

#### Arsimi dhe inovacionet

**Reforma në arsimin dhe trajnimin profesional (ATP) zhvillohet ngadalë, ndërsa mosharmonizimi i aftësive është ende i pranishëm.** Numri i njerëzve që mbarojnë arsimin e lartë po rritet, por programet mësimore nuk po arrijnë t'i aftësojnë nxënësit që mbarojnë ATP-në me aftësitë e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesës për fuqinë punëtore. Në veçanti, subjektet afariste e konsiderojnë mungesën e aftësive teknike në mesin e nxënësve me ATP të mbaruar si pengesë kryesore. Në vitin 2023, Qeveria e miratoi Ligjin për ATP-në me qëllim të tejkalimit të fragmentimit të institucioneve që janë kompetente për arsimin dhe trajnimin profesional. Kuvendi duhet së shpejti të miratojë Ligjin. Në vitin 2023, shpenzimet publike për arsimin dhe trajnimin mbeten të qëndrueshme në 3,7% të BPV-së (nën nivelin e BE-së prej 5%). Megjithatë, shpenzimet janë joefikase, kryesisht për shkak të formulave të vjetruara për rishpërndarjen e mjeteve publike për arsimin nga komunat. Në 0,4% të BPV-së (duke përfshirë një pjesë të vogël të sektorit privat), shpenzimet e ekonomisë për kërkime dhe inovacione mbeten shumë të ulëta. Në dhjetor 2023, Qeveria e miratoi Strategjinë e re për Specializimin e Mençur dhe Planin e Veprimit për orientimin e kërkimeve dhe inovacioneve për çdo sektor.

#### Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

**Pavarësisht nevojës urgjente për modernizimin e infrastrukturës së ekonomisë, investimet në këtë fushë janë të dobëta.** Ekziston nevojë e madhe për të modernizuar fondin kapital të vendit, veçanërisht rjetet transportuese dhe energjetike, ndërsa punët për disa projekte të rëndësishme, të tilla si korridoret rrugore 8 dhe 10d, janë vonuar. Megjithëse, investimet publike si pjesë e BPV-së u rritën ndjeshëm në vitin 2023, investimet e përgjithshme ranë me shpejtësi, kryesisht pasi shoqëritë tregtare i reduktuan rezervat e grumbulluara gjatë krizës energjetike.

**Digjitalizimi i ekonomisë po përparon ngadalë.** Midis viteve 2017 dhe 2021, përqindja e familjeve me qasje në internet në shtëpi u rrit për 10,1 p.p., në 83,6%. Interneti me shtrirje të gjerë fikse përdoret nga 88% e familjeve shfrytëzuese dhe 92% e subjekteve të mëdha afariste, ndërsa shoqëritë e vogla afariste dhe zonat rurale ende përballen me pengesa. Nevojiten përpjekje të mëdha për t'i përmirësuar aftësitë digjitale, duke përfshirë: (i) vendosjen e kornizës nacionale të aftësive digjitale për nxënësit dhe mësimdhënësit; (ii) numrin më të madh të mjeteve të TI-së në shkollat fillore dhe të mesme; dhe (iii) zgjerimin e qasjes në internet të shpejtë për subjektet e vogla afariste dhe në zonat jurbane.


**Masat për përmirësimin e efikasitetit energjetik janë vonuar.** Ekonomia karakterizohet nga intensiteti i lartë energjetik me efikasitet të ulët në prodhimin dhe konsumin e energjisë. Efikasiteti energjetik është një nga shtyllat kryesore për arritjen e qëllimeve nacionale ambicioze për energjetikën dhe klimën. Fondi i ri i Efikasitetit Energjetik (FEE) u themelua në vitin 2023 si njësi e veçantë brenda Bankës Zhvillimore, pasi në tetor 2023 Kuvendi i miratoi ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Bankën Zhvillimore. FEE-ja e parë do të fokusohet në komunitatet dhe subjektet e tjera publike, me mundësinë e zgjerimit dhe të përfshirjes së sektorit rezident.

**Qeveria i rriti kapacitetet për energjinë e rinovueshme.** Megjithëse ekonomia vazhdon të mbështetet shumë në prodhimin e energjisë elektrike me qymyr, kapaciteti i instaluar i centraleve elektrike të burimeve të rinovueshme është rritur në 50% në vitin 2023, nga rreth 17% në vitin 2021. Burimet e rinovueshme përbëjnë 33% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Rritja më e dukshme është në prodhimin e **energjisë elektrike** nga centralet fotovoltaike, ku shënohet rritje prej 287% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Megjithatë, progresi në politikat për reduktimin e ndryshimeve klimatike është duke ngecur. Ishte vonuar miratimi i Ligjit për aksionin klimatik, i cili parasheh futjen e mekanizmave për përcaktimin e çmimit të karbonit.

#### Struktura sektoriale dhe struktura e ndërmarrjeve

**Tregtia dhe shërbimet po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për ekonominë.** Struktura e prodhimit ekonomik mbështetet gjithnjë e më shumë në shërbimet dhe tregtinë (67,3% të vlerës së përgjithshme të shtuar në vitin 2023, krahasuar me 66% në vitin 2022). Pjesa e industrisë së përpunimit në vlerën e shtuar u reduktua në mënyrë shtesë në vitin 2023, për të tretin vit radhazi, në 14,3%, pasi ishte forcuar në mënyrë progresive në vitet para pandemisë. Pjesa e ndërtimitarisë u rrit lehtë në 6,3% në nivel vjetor, pavarësisht aktivitetit të dobët investues, por gjithsesi mbeti nën mesataren prej 7% në periudhën 2017-2021. Pjesa e bujqësisë ra në 8,1% të vlerës së shtuar.

#### Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve



**Transparenca tregtare është reduktuar, por është ende në nivele të larta historikisht.** Eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve si pjesë e BPV-së u zvogëluan për 12 p.p., në 159% në vitin 2023, kryesisht për shkak të zvogëlimit të vlerës së importit pas rënies së çmimeve të energjisë, por mbeten mbi mesataren e tyre 5-vjeçare prej 120% para pandemisë KOVID. Pjesa e produkteve me vlerë të shtuar më të lartë në strukturën e eksportit u rrit në mënyrë shtesë në vitin 2023, duke përfshirë kimikalet (38% të eksportit të përgjithshëm të mallrave) dhe makineritë dhe pajisjet e transportit (34%). BE-ja është partneri kryesor tregtar i vendit, me 59,6% të tregtisë së përgjithshme. CEFTA është partneri i dytë tregtar më i madh i vendit me 10%. Vendet e BE-së janë, gjithashtu, investitorët më të mëdhenj në Maqedoninë e Veriut, me rreth 47,4% të të ardhurave të përgjithshme të IHD-ve në vitin 2023, pas nivelit të lartë rekord prej 69,7% në vitin 2022. Pjesa e BE-27 në aksionet e përgjithshme u rrit në 65%

në vitin 2022, nga 64,2% në vitin 2021.

**Konkurreshmëria e jashtme ka rënë paksa.** Kursi devizor efektiv real (KDER), i reduktuar nga indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), si masë e konkurreshmërisë së jashtme, u rrit për 2,5% në vitin 2023, duke vazhduar trendin e viteve të mëparshme. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së kursit devizor efektiv nominal për 2,8%, kryesisht për shkak të korelacionit të tij me lirën turke, ku çmimet relative kanë mbetur të qëndrueshme. Shpenzimet nominale të punës për njësi u rritën për 8% në vitin 2023, duke reflektuar rritje të madhe të rrogave nominale në kushtet e rritjes së dobët të produktivitetit. Gjatë 5 viteve të mëparshme, KDER-ja e denarit, e cila u zvogëluar për shkak të inflacionit, pothuajse nuk ndryshoi në asnjë drejtim (mesatarisht një rritje e vogël prej 1%).

## 2.4. PROKURIMET PUBLIKE, STATISTIKA, KONTROLI FINANCIAR

### Kapitulli 5: Prokurimet publike

*Rregullat e BE-së sigurojnë që prokurimet publike të mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo vend anëtar janë transparente për të gjitha kompanitë e BE-së në bazë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.*

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi juridik

**Korniza juridike** për prokurimet publike është kryesisht e harmonizuar me të drejtën e BE-së. Ende ekziston praktika e regjistrimit të kompanive "në listën e zezë" për shkak të abuzimeve profesionale në fazën e prokurimeve, gjë që nuk është në përputhje me rregullat e BE-së. Në vitin 2023 janë lëshuar 35 referenca negative për 32 operatorë ekonomikë, nga të cilët 9 kanë skaduar dhe 3 janë hequr nga Byroja e Prokurimeve Publike (BPP). Deri në fund të vitit 2023, ishin aktive 23 referenca negative. Më 30 tetor 2023, Maqedonia e Veriut u bë anëtare e Marrëveshjes së Prokurimeve Qeveritare të OBT-së (GPA) dhe kështu fitoi mundësi të reja të qasjes në treg, më pas duke hapur tregun e saj të prokurimeve për palët e tjera të GPA-së.

Finalizimi dhe miratimi i Ligjit për PPP-në dhe Ligjit për koncesionet janë me vonesë. Kapacitetet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës që merret me koncesionet dhe PPP-në, mbeten të kufizuara. Gjatë vitit 2023 janë lidhur dy kontrata të reja për themelimin e PPP-ve. Është ende e nevojshme të vendoset regjistri për PPP-të dhe regjistri për koncesionet.

Projektet e Korridorit 8 dhe Korridorit 10d vazhdojnë të ngrenë shqetësime në lidhje me përdorimin e Ligjit për investimet strategjike për t'i anashkuar rregullativat e prokurimeve publike. Kontrata për ndërtimin e projektit më të madh infrastrukturor në historinë e vendit iu dha drejtpërdrejt konsorciumit ndërkombëtar pa proces të ankandit konkurrues. Në mënyrë shtesë, kontrata është e shënuar si konfidenciale dhe nuk është bërë publike për opinionin. Sistemi elektronik i prokurimeve publike funksionon në mënyrë efikase. Gjatë vitit 2023, sistemi i e-tregut është përdorur për të dhënë 258 prokurime me vlerë të ulët.

#### Kapaciteti për të zbatuar dhe aplikuar

Në vitin 2023, **tregu i prokurimeve publike**<sup>14</sup> ishte 10,9% të BPV-së së vendit krahasuar me 8,6% në vitin 2022. Ajo përfaqësonte 28,3% të buxhetit të shtetit. Konkurrenca në prokurimet publike mbetet e kufizuar. Përdorimi i procedurave të prokurimit me negociim u zvogëluar në 1,6% në vitin 2023, krahasuar me 6,6% në vitin 2022. Anulimi i ofertave të prokurimeve publike u zvogëluar në 26,95% (19% anulimi i plotë dhe 7,95% anulimi i pjesshëm) në vitin 2023 krahasuar me 31% (21% anulimi i plotë dhe 10% anulimi i pjesshëm) në vitin 2022.

---

<sup>14</sup> Statistika nuk e përfshin kontratën për Korridorin 8 dhe Korridorin 10d, sepse ishte lidhur me ligj të veçantë dhe duke mos respektuar procedurat e zakonshme të prokurimeve publike.

Pavarësisht shpalljes së përdorimit të kriterëve cilësorë të dhënies, përdorimi i ofertës ekonomikisht më të favorshme (OEF) si kriter i dhënies është ende i kufizuar. Në vitin 2023, nga 24.005 njoftime për prokurimet publike, vetëm 1.383 i aplikuan kriteret e OEF-së (5,6%). Për sa i përket vlerës, vetëm 9% e ofertave të prokurimeve publike i përdorën kriteret e OEF-së. Është e nevojshme të organizohen trajnime dhe udhëzime shtesë për aplikimin e OEF-së.

**Kapaciteti për t'i menaxhuar proceset e prokurimeve publike** duhet të forcohet në mënyrë shtesë, veçanërisht në nivel lokal, në mënyrë që të sigurohet qasje më koherente për menaxhimin e ciklit të prokurimeve. Cilësia e dokumentacionit të tenderit mbetet sfidë për organet e vogla kontraktuese. Në fund të vitit 2023, ishin 1.142 nëpunës të certifikuar të prokurimeve publike.

Strategjia e prokurimeve publike përfshin masa për **luftën kundër korrupsionit** dhe konfliktit të interesave. Në këtë drejtim, sistemet e menaxhimit të rreziqeve të inkorporuara në ciklin e prokurimeve dhe njoftimi për praktikën apo parregullsitë e mundshme korruptive duhet të forcohen. Raportet për flamujt e kuq janë publikuar në faqen e internetit të BPP-së, por ndjekja është ende e pamjaftueshme.

#### Sistemi efikas i mbrojtjes juridike

Legjislacioni për të **drejtën e mjetit juridik** është kryesisht i harmonizuar me të *drejtën* e BE-së. **Kapaciteti i zbatimit** i Komisionit Shtetëror për Ankesat për Prokurimet Publike (KSHAPP) mbetet i pamjaftueshëm duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të ankesave (1.019 në vitin 2023, 967 në vitin 2022). Ekziston nevoja për kuadër shtesë të kualifikuar për të siguruar veprimin në kohë të ankesave. Në vitin 2023, në Gjykatën Administrative janë parashtruar 88 ankesa kundër vendimeve të Komisionit Shtetëror për Ankesat për Prokurimet Publike.

### **Kapitulli 18: Statistika**

*Statistika evropiane zhvillohet, përgatitet dhe shpërndahet nga vendet anëtare të BE-së, të udhëhequra nga parimet dhe kriteret e cilësisë së elaboruar në Rregullativën e Statistikës Evropiane, të tilla si pavarësia profesionale, paanshmëria, besueshmëria, transparenca dhe konfidencialiteti. Për metodologjinë, përgatitjen dhe shpërndarjen e informacioneve statistikore janë siguruar rregulla të përbashkëta, të cilat specifikohen në mënyrë shtesë në legjislacionin sektorial që e përbën të drejtën e BE-së për statistikën.*

Derisa **infrastruktura statistikore** ka arritur nivel të lartë të harmonizimit me të *drejtën* e BE-së, niveli i resurseve njerëzore në Entin Shtetëror të Statistikës (ESHS) paraqet sfidë të rëndësishme për zbatimin efikas. Nevojiten përpjekje shtesë për të modernizuar prodhimin statistikor duke përdorur informacionet ekzistuese administrative.

Për sa u përket **klasifikimeve dhe regjistrave**, klasifikimet kryesore janë vendosur dhe janë në përputhje me të *drejtën* e BE-së. Klasifikimi rajonal është shumë i harmonizuar, por nuk ka harmonizim për sa u përket tipologjive territoriale.

Në fushën e **statistikës makroekonomike**, janë përpiluar statistikat e procedurës së deficitit tejmase (EPD) dhe statistikës financiare qeveritare (GFS), por të dhënat nuk janë të plota dhe të shënuara për publikim. Për t'i reduktuar boshllëqet e rëndësishme në bazën e evidentimit dhe mbulimit të njësive, përmbledhja e plotë e të dhënave për GFS-në duhet të plotësohet dhe të harmonizohet me metodologjinë ESA 2010 (ESA 2010). Klasifikimi sektorial duhet të përditësohet dhe çështjet e hapura që lidhen me sektorizimin e njësive duhet të zgjidhen. Duhet të vendoset transparenca për GFS-në dhe EPD-në. Është shënuar njëfarë progresi në llogaritë nacionale dhe rajonale, por nevojiten përmirësime të mëtejshme. Krahas përgatitjes së llogarive financiare vjetore dhe rezervave, Banka Popullore ka filluar përgatitjen, publikimin dhe shpërndarjen e rregullt të të dhënave për llogaritë dhe rezervat tremujore

financiare nga tetori 2023, por nevojiten përpjekje shtesë për të siguruar harmonizimin e plotë me standardet e BE-së.

Është arritur njëfarë progresi në **statistikën afariste dhe tregtare**. Të dhënat statistikore afatshkurtra në fushën e industrisë, ndërtimitarisë dhe tregtisë me pakicë përgatiten rregullisht sipas Statistikës Afariste Evropiane. Vendi nuk ka dorëzuar asnjë të dhënë për çmimet e prodhuesve të shërbimeve në Eurostat. Maqedonia e Veriut ende duhet të harmonizohet plotësisht me kërkesat e reja në statistikën afariste.

Sa i përket **statistikës sociale**, statistika e tregut të punës është pjesërisht e harmonizuar dhe nevojiten përmirësime shtesë, duke përfshirë edhe zgjidhjen e disa çështjeve të TI-së. Anketa e fuqisë punëtore dhe statistika e vendeve të lira të punës kryhen në baza tremujore. Afati kohor i kërkimit të të ardhurave dhe kushteve të jetesës duhet të përmirësohet.

Sa i përket **statistikës bujqësore**, pas zbatimit të regjistrimit provues në qershor 2022, përgatitjet për regjistrimin bujqësor kryesor u ndërprejnë për shkak të mungesës së mjeteve dhe resurseve të nevojshme. Vendi duhet t'i vazhdojë përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë dhe ta zbatojë atë. Llogaritë janë hartuar për herë të parë në pylltari.

Sa i përket **statistikës së energjetikës dhe mjedisit jetësor**, statistika vjetore e energjetikës dhe statistikave mujore dhe afatshkurtra të energjetikës i dorëzohen Eurostatit. Metodologjia e përdorur për statistikën e energjetikës është shumë e harmonizuar me të *drejtën* e BE-së. Treguesit për mjedisin jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm janë pjesërisht të harmonizuara me të *drejtën* e BE-së. Vendi vazhdoi të dorëzonte të dhëna në Eurostat për shpërndarje. Harmonizimi i llogarive të rrjedhës së energjisë fizike duhet të përmirësohet.

## **Kapitulli 32: Kontrolli financiar**

*BE-ja e promovon reformën e sistemeve nacionale të menaxhimit, me qëllim të përmirësimit të përgjegjësisë menaxheriale, menaxhimit të qëndrueshëm financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe revizionit të jashtëm të financave publike. Rregullat e kontrollit financiar i mbrojnë në mënyrë shtesë interesat financiare të BE-së nga mashtrimet në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe nga falsifikimi i euros.*

### Kontrolli i brendshëm financiar publik

Iniciativat e KBFP-së përfshihen në shtyllën VII të Programit për Reformat në Menaxhimin e Financave Publike për vitet 2024-2027 me 3 prioritetet të ndryshme që mbulojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, revizionin e brendshëm dhe inspektimin financiar. Më tutje, Njësia Qendrore e Harmonizimit e përgatiti raportin vjetor për funksionimin e kontroleve të brendshme financiare publike, por ai ishte ende në pritje të miratimit nga Qeveria deri në shtator 2024. Zbatimi i reformave të KBFP-së vazhdoi të pengohet nga anulimet e konsiderueshme në miratimin e Ligjit për KBFP-në, i cili është ende në procedurë parlamentare për më shumë se tre vjet, dhe nga kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve kryesore.

Korniza juridike për **kontrollin e brendshëm** është kryesisht e harmonizuar me standardet ndërkombëtare, por zbatimi duhet të forcohet në mënyrë shtesë. Zbatimi efikas i **përgjegjësisë menaxheriale** mbetet sfidë për shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal. Është i nevojshëm të sigurohet zbatimi koherent i Doracakut të Llogaridhënies Menaxheriale. **Menaxhimi i rreziqeve** duhet të forcohet në mënyrë shtesë. Në vitin 2022, 70% e institucioneve në nivel qendror kishin strategji të menaxhimit të rreziqeve, ndërsa vetëm 59,8% kishin përgatitur regjistra të rreziqeve.

Progres i mirë është arritur në zhvillimin e legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit për inspektimin financiar. Megjithatë, **inspektimi financiar** ende nuk funksionon në mënyrë efektive. Struktura dhe kapaciteti i resurseve njerëzore të inspektimit financiar mbeten të

pamjaftueshme për t'i zbatuar detyrat e tij. Në vitin 2023, ka pranuar 2.052 kërkesa, por ka mundur të zbatojë vetëm 499.

Fragmentimi dhe përgatitja joadekuate e kuadrit për **revizionin e brendshëm** reduktojnë kapacitetin organizativ dhe sigurimin e cilësisë. Sipas raportit të fundit për funksionimin e KBFP-së nga viti 2023, i cili mbulon vitin fiskal 2022, janë themeluar 118 njësi për revizion të brendshëm të subjekteve të sektorit publik në nivel qendror, në të cilat janë të punësuar 116 revizorë të brendshëm. Njësitë e revizionit të brendshëm në nivel qendror kanë kryer 128 revizione në vitin 2023. Ekziston ende nevoja për të futur sistem nacional të certifikimit për revizorët e brendshëm.

**Njësia Qendrore e Harmonizimit** vazhdon të ofrojë udhëzime metodologjike dhe të koordinojë menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe revizionin e brendshëm në sektorin publik. Kapacitetet e saj mbeten të pamjaftueshme për ndjekjen dhe raportimin e funksionimit të sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm, i cili përfshin 1.380 subjekte publike.

#### Revizioni i jashtëm

Ligji i ri për **revizionin shtetëror**, i cili duhet të forcojë pavarësinë e ESHR-së dhe rolin e Kuvendit në ndjekjen e vazhdueshme të raporteve të veçanta të revizorit, është ende në procedurë qeveritare. ESHR-ja bën revizionin e harmonizimit të llogarive përfundimtare të Qeverisë me buxhetin themelor deri në qershor të çdo viti. Raporti vjetor i revizionit ishte dorëzuar në Kuvend dhe ishte publikuar në qershor 2024.

**Cilësia e punës së revizorit** është e mjaftueshme. Në vitin 2023, ESHR-ja ka zbatuar plotësisht Programin e Punës së Revizioneve për vitin 2023, i cili parashikonte 66 revizione. ESHR-ja ka parashtruar 11 raporte në Prokurorinë Publike për informim dhe ndjekje të vazhdueshme.

**Kapaciteti institucional** i ESHR-së mbetet i pamjaftueshëm. Akti i sistemit, i miratuar në dhjetor 2022, parashikon 245 vende pune, nga të cilat 118 (48%) janë plotësuar. Buxheti i ESHR-së për vitin 2024 u miratua sipas kërkesës dhe mori mjete shtesë për katër punësime të reja dhe 13 avancime.

Për sa i përket **ndikimit të punës së revizorit**, rekomandimet e ESHR-së nuk zbatohen në mënyrë efikase nga subjektet e revizionit dhe duhet të forcohet ndjekja e vazhdueshme parlamentare e raporteve të veçanta të revizorit. Deri në momentin e publikimit të raportit vjetor, subjektet e revizionit kishin ndërmarrë masa për t'iu përgjigjur 71% të rekomandimeve të revizionit në vitin 2023.

#### Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Legjislacioni nacional është kryesisht i harmonizuar me Direktivën e BE-së 2017/1371 për luftën kundër mashtrimit në lidhje me interesat financiare të Bashkimit Evropian duke zbatuar të drejtën penale. Duhet të forcohen kapacitetet e Departamentit të Koordinimit të Luftës kundër Mashtrimit (Rrjeti i Koordinimit kundër Mashtrimit) në kuadër të Ministrisë së Financave, pasi ka vetëm tre punonjës. Në vitin 2023, organet nacionale paraqitën katër raste të parregullsive përmes sistemit të menaxhimit të parregullsive, që është në rënie në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese. Organet nacionale duhet të vazhdojnë të ndërtojnë evidencë të bashkëpunimit me Komisionin Evropian për hetimet dhe njoftimin e parregullsive.

#### Mbrojtja nga falsifikimi i euros

Legjislacioni nacional është pjesërisht i harmonizuar me rregullativat e BE-së që e përkufizojnë sistemin për luftën kundër falsifikimit të euros. Kapacitetet e Bankës Popullore dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të forcohen në mënyrë shtesë. Banka



Popullore vazhdoi të mbajë trajnime të rregullta dhe të detyrueshme për punonjësit e institucioneve kreditore dhe qendrave private të arkës për kontrollin manual të origjinalitetit të parave të gatshme në qarkullim.

### 3. MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal janë pjesë thelbësore e procesit të integritimit evropian të Maqedonisë së Veriut. Ato kontribuojnë në stabilitetin, pajtimin dhe klimën e favorshme për zgjidhjen e çështjeve të hapura bilaterale dhe trashëgimisë të së kaluarës.

Vendi vazhdoi të angazhohej në një sërë iniciativash rajonale të bashkëpunimit, të tilla si Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Komuniteti Energjetik, Komuniteti i Transportit dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Në korrik 2023, Maqedonia e Veriut mori kryesimin njëvjeçar me Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore. Gjithashtu, Maqedonia e Veriut mori pjesë aktive në iniciativat, të tilla si Iniciativa e Evropës Qendrore dhe Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë.

**Samiti i Katërt Vjetor BE-Ballkani Perëndimor** u mbajt në Bruksel në dhjetor 2023, ku u konfirmua perspektiva e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE dhe u hulumtuan masat për avancimin e mëtejshëm të integritimit gradual.

Maqedonia e Veriut u përfshi në mënyrë aktive në dimensionin rajonal të **Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor**. Vendi mori pjesë aktive në takimet ministrore dhe të liderëve dhe ishte organizator i takimit të liderëve në shkurt në Shkup.

Për sa i përket **Tregut të Përbashkët Rajonal**, në tetor 2023 u mbajt samiti i Procesit të Berlinit për herë të parë në rajon në Tiranë. U miratua marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermieret, kirurgët veterinarë, farmacistët dhe mamitë. **Udhërrëfyeti për roaming** ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së ka hyrë në fazën e parë të zbatimit. Maqedonia e Veriut ka ratifikuar tre nga katër marrëveshjet e lëvizshmërisë të nënshkruara në samitin e Procesit të Berlinit në nëntor 2022 dhe ka deponuar instrumentet përkatëse të njoftimit. 12 vendime kryesore u miratuan nga Komiteti i Përzier të CEFTA-s në tetor 2024.

Në janar 2024, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Serbia nënshkruan Protokollin e parë për Zbatimin e Marrëveshjes për Kushtet për Qasje të Lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor.

Vendi ruan kryesisht bashkëpunim të mirë dhe **marrëdhënie të mira bilaterale** me vendet e tjera të përfshira në procesin e zgjerimit dhe vendet fqinje anëtare të BE-së.

Marrëdhëniet me **Shqipërinë** mbeten të mira. Të dy vendet festuan 30-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike. Të dy vendet kanë nënshkruar disa marrëveshje për bashkëpunim të përbashkët në shumë fusha, duke përfshirë sigurinë, mbrojtjen, infrastrukturën, energjetikën, arsimin, shkencën dhe kulturën.

Marrëdhëniet me **Bosnjë e Hercegovinën** vazhdojnë të jenë të mira. Disa marrëveshje bilaterale janë në fuqi, duke përfshirë edhe bashkëpunimin për integritimin në BE dhe, nga nëntori 2023, për bashkëpunimin ekonomik.

Bashkëpunimi me **Kosovën** vazhdon të jetë gjithëpërfshirës dhe konstruktiv, me disa takime të mbajtura në nivelin më të lartë. Para zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në Maqedoninë e Veriut në maj 2024, kryeministri i Kosovës, Kurti u takua me përfaqësuesit e partive opozitare.

Marrëdhëniet me **Malin e Zi** mbeten të mira. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takime

të nivelit të lartë ndërmjet përfaqësuesve të të dy vendeve.

Marrëdhëniet me **Serbinë** janë të mira. U nënshkruan Memorandumi i Bashkëpunimit për hekurudhën e shpejtë Shkup-Nish dhe Memorandumi i Bashkëpunimit për vendosjen e rrjetit hekurudhor me performanca të larta.

Marrëdhëniet me **Turqinë** janë të mira. Maqedonia e Veriut hapi konsullatë nderi në Amasia dhe Antalia. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takime të nivelit të lartë ndërmjet përfaqësuesve të të dy vendeve. Në shtator 2024, ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë vizitoi Shkupin dhe u takua me kolegun e tij, duke shprehur qëllimin për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe forcimin e shkëmbimit tregtar ndërmjet dy vendeve.

Marrëdhëniet me **Ukrainën** u intensifikuan pasi Rusia filloi agresionin ushtarak kundër vendit. Maqedonia e Veriut ka ofruar ndihmë humanitare dhe ushtarake dhe është plotësisht e harmonizuar me pakon e masave restriktive të BE-së kundër Rusisë. Maqedonia e Veriut dhe Ukraina kanë marrëveshje për tregtinë, mbrojtjen e investimeve, kulturën, arsimin, turizmin, transportin dhe bashkëpunimin ushtarak. Që nga viti 2019, është futur regjimi pa viza për qëndrime të shkurtra.

Marrëdhëniet me **Gjeorgjinë** janë të mira. Në fuqi është marrëveshja për kulturë.

Marrëdhëniet me **Republikën e Moldavisë** janë të mira. Ka lidhur marrëveshje për transport, tregti, dogana, financa, mjekësi dhe shëndetësi, polici, punë të jashtme dhe çështje konsullore. Nuk ka regjim pa viza ndërmjet dy vendeve.

Gjatë periudhës raportuese, marrëdhëniet me **Bullgarinë** u fokusuan në hapat e ardhshëm në procesin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE. Rezultatet reale dhe zbatimi i marrëveshjeve bilaterale me vullnet të mirë, duke përfshirë edhe Marrëveshjen e Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit dhe Protokollin e saj, mbeten të rëndësishme. Në tetor 2023, në Shkup u mbajtën takime të grupeve të punës të ekspertëve për të ndjekur zbatimin e Marrëveshjes së Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit dhe Protokollit të saj. Komisioni i Përbashkët Multidisiplinar i Ekspertëve për Çështje Historike dhe Arsimore ka mbajtur disa takime gjatë periudhës raportuese. Muajt e fundit, deklaratat e politikanëve individualë kanë ndikuar negativisht në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Nevojiten përpjekje shtesë për të promovuar atmosferë dialogu dhe respekti të ndërsjellë.

Bashkëpunimi me **Greqinë** është intensifikuar, veçanërisht në fushat kryesore me interes të përbashkët. Rezultatet reale dhe zbatimi i marrëveshjeve bilaterale me vullnet të mirë, përfshirë edhe Marrëveshjen e Prespës, mbeten të rëndësishme. Në mars 2024, në Shkup u mbajt takimi i tetë i Komitetit të Përbashkët Ndërdisiplinor të Ekspertëve për Çështje Historike, Arkeologjike dhe Arsimore. Në maj, derisa bënte betimin në Kuvend, Presidenti i sapozgjedhur i Maqedonisë së Veriut e quajti vendin "Maqedoni" në vend që të përdorte emrin kushtetues, praktikë e ndjekur më vonë nga disa funksionarë qeveritarë, e cila është çështja kryesore në zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. Të dy vendet e intensifikuan bashkëpunimin në ndërtimin e interkonektorit të gazit natyror midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë dhe në lidhje me Terminalin e Gazit të Lëngshëm të Naftës (GLN) në Aleksandropoli.

#### 4. AFTËSIA PËR MARRJEN E PËRGJEGJËSIVE TË ANËTARËSIMIT

##### KLASTERI 2: TREGU I BRENDSHËM

Ky klaster përfshin: lëvizjen e lirë të mallrave (Kapitulli 1); lëvizjen e lirë të punëtorëve (Kapitulli 2); të drejtën e themelimit dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve (Kapitulli 3); lëvizjen e lirë të kapitalit (Kapitulli 4); të drejtën për shoqëritë tregtare (Kapitulli 6); Ligjin për pronësinë

intelektuale (Kapitulli 7); politikën e konkurrencës (Kapitulli 8); shërbimet financiare (Kapitulli 9); dhe mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbrojtjen shëndetësore (Kapitulli 28). Ky klaster është vendimtar për përgatitjet e Maqedonisë së Veriut për kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe është veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal.

## **Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave**

*Lëvizja e lirë e mallrave siguron tregtinë e lirë të shumë produkteve brenda BE-së, bazuar në rregulla dhe procedura të përbashkëta. Nëse produktet rregullohen me rregulla nacionale, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave i parandalon që këto rregulla të krijojnë pengesa të pajustificuara në tregti.*

### Parimet e përgjithshme

Vendi vendosi kornizë institucionale funksionale për **prodhimin, shpërndarjen dhe vendosjen në treg të produkteve industriale**. Edhe pse Ligji për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësimi i konformitetit dhe Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve, i miratuar në vitin 2022, kishin për qëllim të harmonizohen me të *drejtën* relevante të BE-së, legjislacioni relevant ende nuk është miratuar për zbatim. Së shpejti duhet të miratohet Strategjia e re për lëvizjen e lirë të mallrave dhe Plani i Veprimit dhe Plani i ri i Veprimit për vitet 2024-2028 për heqjen e barrierave jotarifore në tregti dhe sigurimin e harmonizimit me nenet prej 34 deri në 36 të MFBE-së. Kapaciteti i ministrisë përgjegjëse për këtë fushë dhe për harmonizimin e duhur juridik me të *drejtën* e BE-së është shumë i kufizuar.

### Fusha e harmonizuar: Infrastruktura e cilësisë

Janë vendosur struktura e nevojshme institucionale dhe juridike për rregullat teknike, standardet, vlerësimin e konformitetit, akreditimin, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut. Instituti Nacional për **Standardizim** miratoi 24.357 standarde evropiane si standarde nacionale.

Instituti i **Akreditimit** i Republikës së Maqedonisë së Veriut ofron procedura akreditimi për testimin, kalibrimin dhe laboratorët mjekësorë, trupat e vlerësimin të konformitetit dhe trupat inspektues. Janë 213 trupa aktivë të **vlerësimin të konformitetit** në vend. Së shpejti duhet të miratohet ligj i ri i menduar për t'u harmonizuar me të *drejtën* e fundit të BE-së për **mbikëqyrjen e tregut**. Në vitin 2023, Inspektorati Shtetëror i Tregut (ISHT) ka kryer 679 mbikëqyrje inspektuese në treg, të cilat kanë çuar në tërheqjen nga tregu të 37 produkteve të dëmshme, kryesisht tekstil dhe lodra. ISHT-ja angazhoi 40 punonjës shtesë, por nuk arriti kurrfarë progresi në digjitalizimin e procedurave të brendshme operative për mbikëqyrjen e tregut.

### Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Për sa i përket **legjislacionit të produkteve sipas "qasjes së re dhe globale"**, niveli i harmonizimit me të *drejtën* e BE-së mbetet i ulët.

Nuk është arritur progres lidhur me harmonizimin e së *drejtës* së **BE-së për produktet** sipas **"qasjes së vjetër"** me të *drejtën* e BE-së, duke përfshirë automjetet, kimikalet ose **detergjentët** ose **armët e zjarrit**. Gjithashtu, nuk ka ndryshim në lidhje me **masat procedurale dhe procedurat** e njoftimit për standardet dhe rregullat teknike. Legjislacioni nacional për kthimin e të **mirave kulturore** mbetet pjesërisht i harmonizuar me të *drejtën* relevante të BE-së.

Nuk është vepruar sipas rekomandimeve të strategjisë nacionale për parandalimin e korrupsionit në lidhje me mbikëqyrjen e tregut dhe sigurinë e produkteve.

## Kapitulli 2: Lëvizja e lirë e punëtorëve

*Qytetarët e një vendi anëtar kanë të drejtë të punojnë në vend tjetër anëtar dhe duhet t'u sigurohen të njëjtat kushte pune dhe sociale, si edhe punëtorët e tjerë.*

Nuk është arritur progres në harmonizimin e legjislacionit nacional me të drejtën e BE-së në lidhje me **qasjen në tregun e punës**. Ligji për punësimin dhe punën e të huajve nuk bën dallime ndërmjet qytetarëve të BE-së dhe të huajve të tjerë. Kuota e lejeve të punës përcaktohet çdo vit dhe lejohet bashkimi familjar.

Qytetarët e BE-së nuk mund të kenë qasje në vende pune në administratën publike, përveç listës së ngushtë të pozicioneve në shëndetësi dhe arsim të lartë. Gjithashtu, disa vende pune në kompani private janë të rezervuara ekskluzivisht për qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2023, Maqedonia e Veriut lëshoi 834 leje pune për punëtorët e huaj. Vendi ka nënshkruar tre marrëveshje bilaterale për punëtorët sezonalë me Gjermaninë, Slloveninë dhe Katarin, nga të cilat vetëm marrëveshja me Gjermaninë ka filluar të zbatohet.

Nuk u paraqitën ngjarje në lidhje me pjesëmarrjen në **EURES** (Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit).

Vendi ka lidhur 22 marrëveshje bilaterale për koordinimin e sistemeve të sigurimit social, 13 prej të cilave janë me vendet anëtare të BE-së. Derisa në vitin 2023 vendi filloi negociatat për marrëveshje bilaterale të sigurimit social me Italinë, SHBA-në dhe Greqinë, nuk u nënshkruan marrëveshje të reja për **koordinimin bilateral të sistemeve të sigurimit social** ose për njohjen reciproke të shërbimeve shëndetësore. Ligji për regjistrin e sigurimit të detyrueshëm social, i cili e rregullon formimin dhe funksionimin e regjistrin, u miratua në tetor 2023.

Nuk ka progres në fushën e **Kartelës Evropiane të Sigurimit Shëndetësor (EHIC)**, pasi vetëm nëntë vende anëtare të BE-së (Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Gjermania, Luksemburgu, Holanda, Sllovakia dhe Sllovenia) kanë qasje në shërbimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike dhe disa private në vend.

Korniza specifike për parandalimin e korrupsionit në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve mbetet e dobët. Agjencia e Punësimit zbaton Kodin e Nëpunësve Administrativë, por ende nuk ka miratuar Politikë të Integritetit për të forcuar përpjekjet në luftën kundër korrupsionit.

## Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve

*Personat fizikë dhe juridikë të BE-së kanë të drejtë të themelohen në çdo vend anëtar dhe të ofrojnë shërbime tejkufitare. Për disa profesione të rregulluara, ekzistojnë rregulla për njohjen reciproke të kualifikimeve. Rregullat e shërbimeve postare të BE-së kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit universal, hapjen graduale të tregut ndaj konkurrencës dhe vendosjen e trupit të pavarur rregullator.*

Në lidhje me të **drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime tejkufitare**, Maqedonia e Veriut vazhdoi të harmonizojë legjislacionin e saj me Direktivën e Shërbimeve të BE-së duke i miratuar ndryshimet e Ligjit për kryerjen e punëve të kontabilitet dhe Ligjit për lëndët e para minerale. Pika e vetme e kontaktit ([www.uslugi.gov.mk](http://www.uslugi.gov.mk)) duhet të përmirësohet për t'i përmbushur kërkesat e përcaktuara në Direktivën e Shërbimeve. Deri në shtator 2024, 124 shërbime për qytetarët dhe subjektet afariste ishin në dispozicion online (kërkesat mund të parashtrihen në mënyrë elektronike).

Në fushën e **shërbimeve postare**, legjislacioni nacional është harmonizuar me Direktivën e Parë dhe të Dytë të Shërbimeve Postare dhe pjesërisht me Direktivën e Tretë të Shërbimeve Postare. Ofruesi i shërbimit universal ka të drejtën ekskluzive për të ofruar shërbime të rezervuara postare. Legjislacioni nacional ende duhet të harmonizohet me Rregullativën e Dorëzimit Tejkufitar të Dërgesave. Agjencia e Postave është trup i pavarur rregullator që siguron harmonizimin me Ligjin për shërbimet postare. Për momentin, ekziston një ofrues i

shërbimeve universale dhe 33 operatorë të tjerë postarë. Maqedonia e Veriut duhet të finalizojë harmonizimin me të drejtën e BE-së për shërbimet postare dhe të sigurojë kapacitet të mjaftueshëm institucional për të ndjekur dhe zbatuar rregullat e reja në tregun postar.

Nuk është arritur progres në lidhje me **njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale**. Ende nuk është miratuar ligji që synon të harmonizohet me të drejtën relevante të BE-së. Legjislacioni nacional ende duhet të harmonizohet me Direktivën e BE-së 2005/36/BE lidhur me kërkesat minimale të trajnimit. Së shpejti duhet të vihet në funksion lista transparente e të gjitha profesioneve të rregulluara dhe regjistri elektronik. Duhet të forcohet kapaciteti institucional i departamentit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës që merret me njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale.

#### **Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit**

*Në BE, kapitali dhe investimet duhet të jenë në gjendje të lëvizin pa kufizime, me rregulla të përbashkëta për pagesat tejkufitare. Bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë zbatojnë rregulla të caktuara për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.*

Në lidhje me **lëvizjet e kapitalit dhe pagesat**, udhërrëfyeni i zbatimit i hartuar nga organet në vitin 2022 duhet të përmirësohet me më shumë detaje mbi veprimet konkrete dhe afatet kohore në lidhje me kufizimet ekzistuese për lëvizjet e kapitalit, duke përfshirë edhe liberalizimin e blerjes së tokës bujqësore në përputhje me detyrimet e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit (MSA). Shkalla e zbatimit të saj gjatë viteve 2023 dhe 2024 dhe arritjet e deritanishme nuk janë të qarta, pasi nuk janë ndarë raporte për zbatim me Komisionin.

Për sa u përket **sistemeve të pagesave**, transparencja e kushteve për përdorimin e shërbimeve të pagesave është përmirësuar me vendosjen nga Banka Popullore të mjetit për krahasimin e kompensimeve për shërbimet e pagesave më të përdorura të ofruara nga bankat lokale. Ligji për shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave përfshin dispozita që kanë për qëllim harmonizimin me Direktivën e Shërbimeve të Pagesave 2, Direktivën për E-Paratë 2 dhe Rregullativën e Shkëmbimit të Provizioneve, por duhet të sigurohet harmonizimi i plotë. Vendi ka filluar përgatitjet për lansimin e denarit digjital dhe për vendosjen e sistemit të pagesave për pagesat tejkufitare ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në korrik 2024, Maqedonia e Veriut e parashtroi kërkesën e saj formale për t'iu bashkëngjitur Fushës Unike të Pagesave në Euro (SEPA).

Për sa i përket **luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/FT)**, legjislacioni për zbatimin e ligjeve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ende duhet të miratohet. Në përputhje me kërkesat e Direktivës së Pestë kundër Pastrimit të Parave (AML), duhet të formohet regjistri i unifikuar i llogarive bankare.

Në dhjetor 2023, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimit ka miratuar udhëzime për vlerësimin e rrezikut të LPP/CTF. Strategjia 3-vjeçare e këtij institucioni për AML/LFT është finalizuar, por nuk është miratuar. Në tetor 2023, ka hyrë në fuqi vendimi i Bankës Popullore, i cili përcakton masat e AML/LFT që duhet t'i zbatojnë subjektet e mbikëqyrjes, përfshirë edhe institucionet e pagesave dhe këmbimoret. Drejtoria e Zbulimit Financiar ka zhvilluar në mënyrë shtesë kapacitetet e saj për përpunimin e të dhënave, analizën financiare dhe vlerësimin e intensifikuar të bazuar në rrezik.

Siç u përmend në raportin e fundit të MONEYVAL në korrik 2023, Maqedonia e Veriut e ka forcuar kornizën e saj juridike që nga vlerësimi i fundit i përbashkët dhe i ka hedhur themelet për regjim të qëndrueshëm për t'u përballur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësimin e zbatimit të masave në më shumë fusha. Nevojitet ndjekja gjithëpërfshirëse dhe e vazhdueshme e veprimeve prioritare të

identifikuara për të përmirësuar harmonizimin, si dhe për t'u përgatitur për vlerësimin e ardhshëm të MONEYVAL që pritet në vitin 2025.

## **Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare**

*BE-ja ka rregulla të përbashkëta për kërkesat e themelimit, regjistrimit dhe deklarimit të një shoqërie tregtare, me rregulla shtesë për kontabilitetin dhe njoftimin financiar dhe revizionin ligjor.*

Për sa i përket së **drejtës së shoqërive tregtare dhe menaxhimit korporativ**, në lidhje me formimin e kompanive, Maqedonia e Veriut duhet të harmonizohet në mënyrë shtesë me Direktivën për përdorimin e mjeteve dhe proceseve digjitale në të drejtën e shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe kontrollin e lëndës së kompanisë dhe procedurat e verifikimit të emërimit dhe përjashtimit të drejtorëve. Maqedonia e Veriut, gjithashtu, duhet të harmonizohet në mënyrë shtesë me kërkesa të caktuara për kapital të parashikuara nga Direktiva 2017/1132. Në të ardhmen, regjistri afarist nacional duhet të jetë teknikisht i gatshëm për t'u lidhur me Sistemin e Interkoneksionit të Regjistrave të Subjekteve Afariste (BRIS).

Kodi i Menaxhimit Korporativ nga viti 2021 është i detyrueshëm vetëm për kompanitë e kotuara që plotësojnë kritere të caktuara dhe duhet t'i mbulojnë të gjitha kompanitë e kotuara. Legjislacioni nacional është kryesisht i harmonizuar me të *drejtën* e BE-së në lidhje me format juridike të Societas Europaea dhe Grupacioni Evropian i Interesit Ekonomik, ndërsa draft-legjislacioni për harmonizimin e pjesëshëm me të *drejtën* e BE-së për Shoqërinë Koorporative Evropiane është në pritje të miratimit nga Kuvendi. Nevojitet harmonizimi në mënyrë shtesë me të *drejtën* e BE-së për aspekte të caktuara të bashkimeve të brendshme, ndarjeve të brendshme dhe operacioneve tejkufitare (bashkimet, ndarjet, konverzimet), ofertat për marrje, si dhe me rregullat për të inkurajuar angazhimin afatgjatë të aksionarëve (Direktiva SRD II).

Sa i përket **njoftimit të shoqërive**, Maqedonia e Veriut është pjesërisht e harmonizuar, ndër të tjera, sa i përket kornizës së kontabilitetit për kompanitë e vogla dhe njoftimit nga vendi në vend. Draft-ligji për kontabilitet, që synon harmonizimin e mëtejshëm me të *drejtën* e BE-së në këtë fushë, është ende në proces të miratimit. Maqedonia e Veriut, gjithashtu, do të duhet të harmonizohet me të *drejtën* e fundit të BE-së (nga viti 2022) për njoftimin e qëndrueshmërisë korporative. Megjithëse dispozita të caktuara të së drejtës për kërkesat e transparencës për kompanitë e kotuara tashmë janë të mbuluara mirë në legjislacionin nacional aktual, nevojitet harmonizim i mëtejshëm në këtë fushë, me fokus në njoftimin e ekonomive kryesore dhe regjimet e sanksionimit. Pritet edhe miratimi i Propozim-ligjit të ri për revizion, qëllimi i të cilit është të arrihet harmonizimi më i madh me të *drejtën* e BE-së, duke përfshirë edhe fushën e hetimeve dhe sanksioneve. Për momentin, nuk ka trup me përgjegjësi përfundimtare për mbikëqyrjen ligjore të revizorit, siç kërkohet nga Direktiva e Revizionit të BE-së. Dukshmëria dhe rezultatet e përgjithshme të Këshillit për Avancimin dhe Mbikëqyrjen e Revizionit mbeten të dobëta. Nevojiten përpjekje për të siguruar pavarësinë e tij.

## **Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale**

*BE-ja i ka harmonizuar rregullat për mbrojtjen juridike të të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI), të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta. Rregullat e mbrojtjes juridike të DPI-së mbulojnë, për shembull, patentat dhe markat tregtare, dizajnet, shpikjet bioteknologjike dhe produktet farmaceutike. Rregullat për mbrojtjen juridike të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta mbulojnë, për shembull, librat, filmat, softuerin dhe radiodifuzionin.*

Në fushën e së **drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta**, miratimi i ndryshimeve në Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, që synojnë harmonizimin me të

*drejtën* e BE-së për menaxhimin e të drejtave kolektive, veprave jetime dhe zbatimit të detyrimeve të Marrëveshjes së Marrakeshit mbeten të anuluar. Maqedonia e Veriut ende nuk është e harmonizuar me Direktivën për të realizuar të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të zbatueshme për transmetime të caktuara online të organizatave radiodifuzive dhe ritransmetimin e programeve televizive dhe radioprogrameve, si dhe me Direktivën për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në Tregun Digjital Unik.

Sa u përket të **drejtave të pronësisë industriale**, Enti Shtetëror për Pronësi Industriale (ESHPI) e vazhdoi bashkëpunimin me BE-në dhe trupat ndërkombëtarë, në veçanti me Zyrën e BE-së për Pronësi Intelektuale (EUIPO). Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë të harmonizojë legjislacionin e saj me të *drejtën* e BE-së në këtë fushë, veçanërisht për patentat, sekretet tregtare dhe Direktivën për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.

Për sa i përket **zbatimit**, ESHPI-ja nuk ka kapacitet për të zhvilluar infrastrukturën harduerike për të ofruar inspektim të plotë në veprimin institucional të shkeljeve të DPI-së. Trupi koordinues për mbrojtjen e pronësisë intelektuale duhet t'i forcojë aktivitetet e tij për t'i zgjidhur sfidat kryesore që lidhen me DPI-në.

Strategjia e Pronësisë Intelektuale për vitet 2021-2026 mbetet për t'u miratuar.

Sipas Drejtorisë së Doganave, nga janari deri në fund të marsit 2024 janë regjistruar 12 raste të reja të dyshuara për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Janë gjithsej 189 raste aktive që përfshijnë 1.059 marka tregtare për të cilat është kërkuar mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale. Në të njëjtën kohë, shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale u konfirmua në tre raste (për 1.338 copë) që përfshinin 7 marka tregtare ndërkombëtare.

Njësia relevante e të drejtave të pronësisë intelektuale në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit edhe më tutje është me numër të pamjaftueshëm të punonjësve, gjë që e minon kapacitetin e saj për t'i kryer detyrat e saj.

## **Kapitulli 8: Politika e konkurrencës**

*Rregullat e BE-së e mbrojnë konkurrencën e lirë. Këto përfshijnë rregullat antimonopole kundër marrëveshjeve restriktive ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimin me pozitën dominuese, dhe gjithashtu përfshijnë rregulla mbi përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve të cilat do të shtrembëronin ndjeshëm konkurrencën efektive. Rregullat e BE-së përcaktojnë gjithashtu sistem për kontrollin e ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse plotësohen kushtet restriktive, për të parandaluar prishjen e konkurrencës.*

### Antimonopoli dhe bashkimet

**Korniza legjislative** është kryesisht e harmonizuar me të *drejtën* e BE-së për antimonopol dhe bashkime, megjithëse pjesë të legjislacionit për zbatim së shpejti duhet të harmonizohen.

Për sa i përket **kornizës institucionale**, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) vazhdon të ketë kuadër të pamjaftueshëm, gjë që çon në kapacitet të kufizuar për zbatim me kapacitetet teknike joadekuate. Buxheti i tij vjetor mbetet i pamjaftueshëm.

Për sa i përket **zbatimit**, numri i vendimeve për bashkim është rritur nga 101 në vitin 2022 në 121 në vitin 2023, duke përfshirë edhe vendimet për rastet e vogla. Numri i ndërhyrjeve me detyrë zyrtare dhe në terren mbetet i vogël. Nevojiten përpjekje serioze për të rritur përdorimin e instrumentit të lehtësimit në mënyrë që të përmirësohet zbatimi.

### Ndihma shtetërore

**Korniza legislative** për ndihmën shtetërore reflekton kryesisht nenet 107 dhe 108 të MFBE-së. Ligji për ndihmën shtetërore dhe legjislacioni për zbatimin e tij duhet të harmonizohen në mënyrë shtesë me të *drejtën* e BE-së. Regjistrimi i ndihmës shtetërore nuk është ende transparent.

Për sa i përket **kornizës institucionale**, KMK-ja është përgjegjëse edhe për zbatimin e Ligjit për ndihmën shtetërore. KMK-ja lëshon mendime jodetyruese dhe vendime detyruese për ndihmën shtetërore. Për sa i përket kapacitetit për zbatim, ende është i pamjaftueshëm kuadri i KMK-së që merret me kontrollin e ndihmës shtetërore. Nevojitet forcimi shtesë, duke përfshirë edhe trajnimin e profesionistëve gjyqësorë, për aplikimin e ndihmës shtetërore.

Për sa i përket **zbatimit**, në vitin 2023 KMK-ja ka lëshuar 21 vendime dhe 16 mendime për ndihmën shtetërore. KMK-ja nuk ka miratuar asnjë vendim negativ apo të kushtëzuar.

### Liberalizimi

Rregullat antimonopole dhe rregullat e ndihmës shtetërore zbatohen, si për ndërmarrjet shtetërore, ashtu edhe për ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç nëse zbatimi i tyre nuk e pengon kryerjen e detyrave konkrete që u janë caktuar. Nuk ka dëshmi për ekzistimin e monopoleve me karakter komercial në kuadër të kuptimit të nenit 37 të MFBE-së.

### **Kapitulli 9: Shërbimet financiare**

*Rregullat e BE-së kanë për qëllim të sigurojnë konkurrencë të drejtë midis institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre, përkatësisht në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimit, pensioneve shtesë, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë. Ato përfshijnë rregullat për autorizimin, punën dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.*

Për sa u përket **bankave dhe konglomerateve financiare**, është vendosur korniza institucionale dhe juridike, me nivel të mirë të harmonizimit me versionin e mëparshëm të Rregullativës për Kërkesat Kapitale dhe Direktivën për Kërkesat Kapitale (RRKK/DKK). Puna për të harmonizuar me versionet e fundit të Rregullativës për Kërkesat Kapitale dhe Direktivës për Kërkesat Kapitale duhet të vazhdojë. Është miratuar Ligji për zgjidhjen e bankave, me ndryshimet përcjellëse të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Legjislacioni për zbatimin e Ligjit për zgjidhjen e bankave mbetet për t'u miratuar. Meqë Ligji për sigurimin e depozitave nuk u ndryshua, mbetet të përmirësohet sigurimi i depozitave, duke përfshirë edhe futjen e përparësisë së deponentit, në përputhje me kërkesat e BE-së. Kapaciteti i Ministrisë së Financave për të rregulluar dhe mbikëqyrur shoqëritë financiare nuk është i mjaftueshëm për t'i mbrojtur konsumatorët. Banka Qendrore ka ndryshuar strukturën e saj organizative për të mundësuar shqyrtimin e përmirësuar të ankesave të konsumatorëve. Struktura juridike dhe institucionale për themelimin e Avokatit të Popullit Financiar së shpejti duhet të finalizohet.

Nuk ka progres në lidhje me **sigurimet dhe pensionet profesionale**. Vendi nuk e ka harmonizuar ende legjislacionin me Direktivën e Solvencës II. Legjislacioni ende i lejon Ministrisë së Financave t'i përcaktojë premittë e sigurimit të mjeteve motorike, gjë që është në kundërshtim me të *drejtën* e BE-së. Vlerësohet se në vitin 2023 rreth 5,8% të automjeteve mbeten të pasiguruara [Nuk janë ndërmarrë masa sistematike për të parandaluar qarkullimin e automjeteve të pasiguruara. Limiti prej 50% mbetet për investimin në letra me vlerë të huaja nga fondet pensionale. Kjo është në kundërshtim me të *drejtën* e BE-së dhe fazën e dytë të MSA-së.

Për sa i përket **infrastrukturës së tregut financiar**, Ligji i ri për instrumentet financiare i miratuar në fillim të vitit 2024 ka për qëllim të harmonizohet me Direktivën e Përfundimit të Barazimit, veçanërisht në lidhje me përfundimin e transaksioneve me letrat me vlerë. Vendi mbetet pjesërisht i harmonizuar me Rregullativën për depozitat qendrore të letrave me vlerë



dhe nuk është harmonizuar me legjislacionin e BE-së për kolateralin financiar, transaksionet e financimit të letrave me vlerë dhe derivatet përmes sportelit, palët kontraktuese qendrore dhe depot tregtare.

Lidhur me **tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimeve**, në mars 2024 u miratua Ligji i ri për prospektet dhe detyrimet e transparencës për emetuesit e letrave me vlerë. Ky ligj, bashkë me Ligjin për instrumentet financiare, kanë për qëllim të harmonizojnë pjesërisht legjislacionin nacional me të drejtën e BE-së. Para hyrjes së tyre në fuqi mbetet për t'u miratuar legjislacioni për zbatimin e këtyre ligjeve, si dhe Ligji për instrumentet financiare. Nuk është arritur progres në fondet e investimeve dhe ndryshimet mbeten të domosdoshme për të harmonizuar më tej me të drejtën e BE-së, duke përfshirë edhe ndryshimet e prezantuara së fundi në shoqëritë për investimin kolektiv në letrat me vlerë të transferueshme dhe menaxherët e fondeve alternative të investimeve.

Për sa u përket **financave të qëndrueshme dhe digjitale**, nuk filloi harmonizimi me të drejtën e BE-së për kornizën e financave të qëndrueshme, duke përfshirë edhe taksonominë e BE-së, dhe Përcaktimet e BE-së për Tranzicionin Klimatik, Përcaktimet e harmonizuara me Marrëveshjen e Parisit të BE-së dhe zbulimet e lidhura me qëndrueshmërinë mbi përcaktimet. Në vitin 2023, Banka Popullore publikoi udhëzimet për menaxhimin e rreziqeve të lidhura me klimën si praktikë më të mira që bankat pritet t'i ndjekin, bazuar në standardet dhe praktikët e publikuara nga Banka Qendrore Evropiane, Drejtoria Bankare Evropiane dhe Komiteti i Bazelit. Banka Popullore nënshkroi marrëveshje të bashkëpunimit me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI) Global për marrjen e shërbimeve këshillëdhënëse për avancimin e praktikave të saj rregullatore dhe mbikëqyrëse për menaxhimin e rrezikut klimatik, si dhe kapacitetet raportuese të sektorit financiar në vend. Nevojitet punë shtesë për të harmonizuar me të drejtën e BE-së për financat digjitale.

## **Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtja shëndetësore**

*Rregullat e BE-së i mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe gjithashtu ofrojnë sigurinë e produkteve, parandalojnë imitimet e rrezikshme dhe përcaktojnë përgjegjësinë për produktet e parregullta. BE-ja garanton, gjithashtu, nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik dhe, në veçanti, siguron standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, si dhe ilaçeve për përdorim njerëzor dhe veterinar. BE-ja, gjithashtu, ka rregulla për respektimin e të drejtave të pacientëve në mbrojtjen shëndetësore tejkufitare dhe për përgatitjen dhe përballjen me kërcënimet shëndetësore tejkufitare.*

### Mbrojtja e konsumatorëve

Ligji për **mbrojtjen e konsumatorëve** është kryesisht në harmonizim me pjesën më të madhe të së drejtës së BE-së për konsumatorët dhe i përkufizon qartë përgjegjësitë e trupave fizikë dhe juridikë komercialë ndaj konsumatorëve. Megjithatë, legjislacioni nacional ende nuk është harmonizuar me të drejtën e BE-së për udhëzimet përmes pakove të aranzhmanit. Strategjia e ardhshme trevjeçare për mbrojtjen e konsumatorëve (2025-2028) së shpejti duhet të miratohet, ndërsa ueb-platforma që ofron informacione për mbrojtjen e konsumatorëve ende duhet të zhvillohet. Ka ndërmjetësim në kontestet e konsumatorëve, bazuar në dispozitat e Ligjit nacional për ndërmjetësim, i miratuar në vitin 2022, por është ende e vështirë për konsumatorët që të kenë qasje në shërbimet e ndërmjetësimit.

Legjislacioni nacional ka nivel të lartë të harmonizimit me të drejtën e BE-së për **sigurinë e përgjithshme të produkteve**, përveç disa përkufizimeve, si dhe për imitimet e rrezikshme. Është pjesërisht në harmonizim me kërkesat ligjore për sistemin e BE-së për paralajmërim të shpejtë për produktet e rrezikshme joushqimore (portali "Safety Gate"). Në vitin 2023, Inspektorati Shtetëror i Tregut ka siguruar 809 inspeksione të mbikëqyrjes së tregut, të cilat kanë rezultuar në tërheqjen e 37 produkteve nga tregu. Lista e këtyre produkteve të tërhequra është publikuar në faqen e internetit të Inspektoratit Shtetëror të Tregut. Numri i

inspektorëve (170) ende nuk është i mjaftueshëm dhe shumica e tyre janë në prag të pensionit. Lidhur me **çështjet që nuk lidhen me sigurinë**, nevojiten përpjekje shtesë për të zhvilluar udhëzime dhe procedura për ankesat e konsumatorëve dhe mjetet e kompensimit.

### Shëndeti publik

Megjithëse **mbrojtja shëndetësore primare** në Maqedoninë e Veriut ofrohet falas, financimi i saj është dukshëm nën mesataren e BE-së. Fushëveprimi i shërbimeve shëndetësore dhe disponueshmëria e tyre, veçanërisht e shërbimeve të specializuara mjekësore, dhe shpërndarja e tyre gjeografike janë joadekuate. Nuk ka specialistë të mjaftueshëm dhe korelacioni i infermiereve në 100.000 banorë është nën mesataren e BE-së. Personali mjekësor vazhdon të largohet nga sektori shëndetësor publik për të punuar në sektorin privat ose për të punuar jashtë vendit. Mbulimi i shpenzimeve për kujdesin shëndetësor nga xhepi janë në nivel të lartë, gjë që është pengesë për qasje të barabartë në mbrojtjen shëndetësore. Pavarësisht ekzistimit të aplikacioni **e-shëndetësia**, fletudhëzimet bëhen ende në letër, ndërsa aplikacioni nuk është interoperabil me të dhënat e Fondit të Sigurimit Shëndetësor.

Legjislacioni nacional për **kontrollin e duhanit** është kryesisht në harmonizim me të *drejtën* e BE-së, por nuk zbatohet ose aplikohet në mënyrë sistematike – pirja e duhanit ende tolerohet gjerësisht dhe nuk sanksionohet në restorante dhe ambiente të tjera të mbyllura, duke përfshirë edhe zyrat publike dhe disa institucione mjekësore. Vendi nuk e ka ratifikuar ende Protokollin për Eliminimin e Tregtisë së Palejuar të Produkteve të Duhanit. Për sa u përket **sëmundjeve infektive**, ndërkohë që ka përfunduar plotësimi i sistemit të paraqitjes së çrregullimeve sindromike, harmonizimi me të *drejtën* relevante të BE-së mbetet i paplotë dhe, ndërkohë që niveli i përgjithshëm i vaksinimit është rritur deri diku, shkalla e vaksinimit është e ulët për disa sëmundje. Ndërgjegjësimi dhe numri i transplantëve të **gjakut, indeve, qelizave dhe organeve** të kryera janë rritur, megjithëse korniza juridike nuk është ende plotësisht në harmonizim me të *drejtën* e BE-së dhe ende nuk është vendosur moduli i TI-së për transplantimin e indeve. Harmonizimi me të *drejtën* e BE-së për të **drejtat e pacientëve në mbrojtjen shëndetësore tejkufitar** nuk ka filluar ende.

Ka pasur progres në harmonizimin në lidhje me **mjetet ndihmëse mjekësore**, por nuk kishte zhvillim në lidhje me **barnat për përdorim njerëzor** ose **barnat për përdorim veterinar**, të cilat mbeten pjesërisht të harmonizuara. Legjislacioni nacional nuk është në harmonizim me të *drejtën* e BE-së për **kozmetikën**. Vendi ka nisur fushatën e parë të **skringut të kancerit** të gjirit. Ndërkohë që numri i skringjeve të kancerit të qafës së mitrës u dyfishua në vitin 2023 në kuadër të programit relevant të skringut, dhe u kryen disa skringje kolorektale, nevojitet qasje më gjithëpërfshirëse dhe më proaktive ndaj skringut të bazuar në popullsinë. Financimi lidhur me **sëmundjet e rralla** është rritur, por nuk mjafton për t'i mbuluar shpenzimet e trajtimit mjekësor për të gjithë pacientët e regjistruar. Ndjekja e **parandalimit të abuzimit me drogën dhe reduktimi i dëmeve të lidhura me alkoolin** tregojnë nivele të mesme të abuzimit. Nuk ka progres në **mjedise të shëndetshme**. Përpjekjet për të luftuar kundër **pabarazive shëndetësore**, veçanërisht për romët, dhe për njerëzit që jetojnë në varfëri dhe ata që jetojnë në zona të largëta, janë udhëhequr kryesisht nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare, në vend nga organet shëndetësore.

Shëndetësia është një nga shfrytëzuesit më të mëdhenj të buxhetit nacional, ndërsa shërbimet e inspektimit janë të prirura ndaj korrupsionit. Nuk ka kritere efektive për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve shëndetësore ose barnave. Procedurat e mjekimit jashtë vendit nuk janë as transparente dhe as objektive. Trupat e mbikëqyrjes së tregut janë ende me kuadër të pamjaftueshëm dhe kanë kompetenca të paqarta dhe të mbivendosura. Shumica e aktiviteteve të lidhura me shëndetësinë në strategjinë kundër korrupsionit mbeten të pazbatuara. Forcimi i integritetit, deklaratimet e gjendjes pronësore dhe digjitalizimi janë të

nevojshme për të ndihmuar në parandalimin e korrupsionit në mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbrojtjen shëndetësore.

### **KLASTERI 3: KONKURRENCA DHE RRIJTJA GJITHËPËRFSHIRËSE**

Ky klaster përfshin: transformimin digjital dhe mediat (Kapitulli 10); tatimimin (Kapitulli 16); politikën ekonomike dhe monetare (Kapitulli 17); politikën sociale dhe punësimin (Kapitulli 19); politikën e ndërmarrjeve dhe politikën industriale (Kapitulli 20); shkencën dhe kërkimin (Kapitulli 25); arsimin dhe kulturën (Kapitulli 26); dhe unionin doganor (Kapitulli 29).

#### **Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat**

*BE-ja e mbështet funksionimin normal të tregut të brendshëm për komunikimet elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizuale. Rregullat i mbrojnë konsumatorët dhe mbështesin disponueshmërinë universale të shërbimeve moderne.*

Sa i përket strategjisë së transformimit digjital, Maqedonia e Veriut së shpejti duhet të miratojë strategjinë afatgjate të TIK-së dhe strategjinë nacionale të sigurisë kibernetike. Ministria e Transformimit Digjital duhet t'i forcojë kapacitetet e saj për koordinim më të mirë të politikave të transformimit digjital në vend.

Në lidhje me komunikimet elektronike, Agjencia e Komunikimeve Elektronike miratoi rregullore për zbatimin e Direktivës së BE-së për masat për uljen e shpenzimeve të vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, bashkë me propozimin për rregullativa të reja mbi masat për t'i ulur shpenzimet e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të gigabitit. Maqedonia e Veriut së shpejti duhet të harmonizohet me Direktivën e BE-së për uljen e shpenzimeve për internetin me shtrirje të gjerë. Plani Broadband Operativ Nacional për vitet 2019-2023 mbetet në fuqi. Kapaciteti i shërbimeve të numrit evropian për rastet urgjente 112 duhet të forcohet në mënyrë shtesë. Mbulimi i internetit fiks me shtrirje të gjerë në vend me internet me shtrirje të gjerë me shpejtësi të lartë është 88,80% sipas raportit të publikuar nga ZNKB-ja në mars 2024.

Sa i përket strategjisë së transformimit digjital, strategjia afatgjate e teknologjisë informatike dhe komunikimit ende nuk është miratuar. Organet duhet të sigurojnë pavarësinë e rregullatorit të komunikimeve elektronike. Në shtator 2024, Kuvendi i shkarkoi të pesë anëtarët e Komisionit të AKE-së.

Për sa u përket shërbimeve digjitale, shumica e shërbimeve administrative ofrohen, si online, ashtu edhe offline përmes e-portalit nacional për shërbime, duke përfshirë edhe kapacitete për personat me nevoja të veçanta. E-portali së shpejti duhet të përfundojë plotësimin e tij me 135 shërbime të reja elektronike. Shërbimet më të zakonshme, të tilla si lëshimi i dokumenteve personale, nuk janë të disponueshme në internet. Maqedonia e Veriut duhet të harmonizojë legjislacionin nacional si me Kornizën Evropiane për Interoperabilitet, ashtu edhe me Ligjin për Evropën Interoperabile. Organet duhet të sigurojnë dhe lehtësojnë qasje të barabartë në shërbimet online për të gjithë qytetarët dhe t'i përmirësojnë përpjekjet për harmonizim me Ligjin për shërbimet digjitale dhe Ligjin për tregjet digjitale. Inteligjenca artificiale po pilotohet në përdorimin e 112 për transkriptim dhe përkthim në kohë reale. Organet morën trajnime nga shërbimet evropiane për ZDU-në në qershor 2024, me qëllim që t'i jepet prioritet harmonizimit të legjislacionit nacional me ZDU-në.

Për besimin digjital dhe sigurinë kibernetike, Maqedonia e Veriut duhet të miratojë Ligjin e ri për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacioneve, të harmonizuar me direktivat NIS dhe NIS2, si dhe me strategjinë nacionale të sigurisë kibernetike. Institucionet shtetërore duhet të forcojnë në mënyrë shtesë infrastrukturën e tyre dhe të sigurojnë ekspertizë të sigurisë kibernetike. Kapacitetet (kuadri dhe infrastruktura) e qendrës nacionale për t'iu

përgjigjur incidenteve kompjuterike duhet të forcohen në mënyrë shtesë. Legjislacioni nacional është harmonizuar me Rregullativën eIDAS nga viti 2014, por mjetet ekzistuese të e-identifikimit dhe certifikatat e e-nënshkrimit nuk janë falas për qytetarët dhe konsiderohen joadekuate për shfrytëzuesit. Maqedonia e Veriut duhet të harmonizohet me rregullativën e re të BE-së për identitetin digjital dhe shërbimet konfidenciale nga viti 2024. Ligji për procedurën e përgjithshme administrative ende nuk zbatohet sistematikisht në administratë. Sinjali celular 5G u zgjerua në mënyrë shtesë në vend. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të harmonizuar me Direktivën e e-privatësisë.

Për mediat, Kuvendi në mënyrë shtesë e anuloi emërimin e anëtarëve të rinj të këshillave të rregullatorit të mediave dhe servisit radiodifuziv publik. Rregullatori nacional duhet t'i forcojë kapacitetet e tij për t'i zbatuar në mënyrë efikase kompetencat e tij, veçanërisht mbikëqyrjen dhe regjistrimin e platformave të shpërndarjes së videove dhe të a.q. influenserëve. Në shkurt 2024, organet e ndryshuan Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale duke futur përsëri reklamimin qeveritar në mediat private. Industria audiovizuale vazhdoi t'i përdor edhe përfitimet nga pjesëmarrja e vendit në MEDIA dhe në nënprogramet ndërsektoriale të programit "Evropa Kreative". Ndërmarrja Radiodifuzive Publike mori mandat të sigurojë ndërtimin e infrastrukturës optike dhe të sigurojë qasje në rrjetet me internet me shtrirje të gjerë në zonat ku nuk ka interes të mjaftueshëm komercial për investime nga operatorët.

## Kapitulli 16: Tatimimi

*Rregullat e BE-së për tatimimin mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, akcizat dhe aspektet e tatimit korporativ. Ato mbulojnë, gjithashtu, bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, duke përfshirë edhe shkëmbimin e informacioneve për të parandaluar fshehjen tatimore.*

Për sa i përket **tatimit indirekt**, vonesat në procesin e kthimit të TVSH-së mbeten mjaft të dukshme, pasi vetëm 15% e kthimit janë paguar brenda afatit ligjor.

Për sa i përket akcizës, Ligji për akcizën bazohet në strukturën e legjislacionit të BE-së për akcizat. Shkallët minimalë të akcizës për alkoolin dhe pijet alkoolike janë në përputhje me të drejtën e BE-së. Nevojitet harmonizimi shtesë për strukturën e akcizës për alkoolin dhe pijet alkoolike. Akciza për produktet e duhanit është pjesërisht e harmonizuar me të drejtën e BE-së. Ligji për akcizën u ndryshua duke rritur taksën për produktet e duhanit duke filluar nga 1 janari 2024 dhe duke përfunduar më 1 janar 2030. Me këtë, akciza për cigaret do të ishte e barabartë me minimumin e përcaktuar nga BE-ja. Lëvizjet e mallrave të akcizës nën aranzhmanin e pezullimit doganor kontrollohen në mënyrë elektronike në mënyrë të ngjashme me Sistemin e Lëvizjes dhe Kontrollit të të Mirave të Akcizës (EMCS). Nevojitet harmonizimi shtesë me disa dispozita të rregullave të përgjithshme për prodhimin, ruajtjen, deponimin, lëvizjen dhe kontrollet e produkteve të akcizës.

Për sa i përket **tatimit direkt**, Ligji për tatimin mbi fitim u ndryshua për të shfuqizuar detyrimin për parashtrimin e dokumentacionit të transferimit të çmimit nga 1 janari 2024, duke ulur kështu ngarkesën administrative për tatimpaguesit. Vendi duhet të harmonizojë legjislacionin e tij me Direktivën e Bashkimit Evropian.

BE-ja bashkëpunon me Maqedoninë e Veriut përmes dialogut të përforcuar për menaxhimin e mirë tatimor brenda listës së BE-së.

Për sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës reciproke**, Maqedonia e Veriut ka nënshkruar 49 marrëveshje për tatimimin e dyfishtë, duke përfshirë edhe 23 vendet anëtare të BE-së. Vendi ende nuk është obliguar për datën e fillimit për shkëmbimin automatik të informacioneve të llogarive financiare sipas standardit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Vendi së shpejti duhet t'i zbatojë të gjitha standardet minimale

për parandalimin e erozionit të bazës tatimore dhe zhvendosjes së fitimit (BEPS), përkatësisht standardin minimal të njoftimit nga vendi në vend.

Për sa i përket **kapacitetit operativ dhe kompjuterizimit**, DAP-ja ende duhet t'i përmirësojë proceset e saj afariste, të zhvillojë menaxhimin e rrezeve të harmonizimit dhe të vazhdojë me procesin e zgjerimit të e-shërbimeve. Ishte formuar zyra e menaxhimit të reformave për të mbështetur agjendën e reformave të DAP-së. Funkzioni i TI-së është riorganizuar duke formuar sektorin e TI-së në nivel qendror. Kanë filluar përgatitjet për zbatimin e sistemit të ri të integruar tatimor të TI-së, me qëllim që të zëvendësohet sistemi ekzistues i fragmentuar i TI-së deri në vitin 2028. Në vitin 2023, u pranuan 90 punonjës të rinj, duke e çuar numrin e punonjësve në DAP afër 1.000.

## **Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare**

*Rregullat e BE-së kërkojnë që bankat qendrore të jenë të pavarura dhe t'i ndalojnë ato të financojnë drejtpërdrejt sektorin publik. Vendet anëtare të BE-së i koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë lëndë e mbikëqyrjes fiskale, ekonomike dhe financiare.*

Lidhur me **politikën monetare**, Maqedonia e Veriut ka nivel të lartë të harmonizimit me të drejtën e BE-së për ndalimin e financimit monetar të sektorit publik dhe ndalimin e qasjes së privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Legjislacioni është pjesërisht i harmonizuar me të drejtën e BE-së për pavarësinë e Bankës Popullore. Ndryshimet e Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut u miratuan në fillim të prillit 2024 me qëllim të sigurimit të autonomisë më të madhe për vendosjen e kushteve për punësimin e kuadrit, për të vendosur mandat formal makroprudent dhe për të përmirësuar kornizën menaxhuese. Sa u përket vendimeve për kushtet e punësimit të kuadrit të Bankës Popullore, megjithatë, është e domosdoshme që në Kuvend të miratohen edhe ligjet për nëpunësit administrativë dhe të punësuarit në sektorin publik që janë në pritje të miratimit.

Qëllimi primar i Bankës Popullore është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Për të kufizuar inflacionin dhe pritshmëritë e inflacionit dhe për të mbështetur denarizimin, Banka Popullore e rriti shkallën kamatare themelore, e tërhoqi likuiditetin dhe e rregulloi rezervën e detyrueshme në baza të diferencuara për depozitat në valutë vendase dhe të huaja.

Banka Popullore ka vazhduar të përmirësojë ndjekjen e rrezikut bankar dhe harmonizimin e rregullativës së mbikëqyrjes me kërkesat e BE-së. Për të forcuar mbikëqyrjen, janë plotësuar rregullativat për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe zbulimin e bankave. Pas plotësimit të kornizave makroprudente dhe kornizave për zgjidhje (Ligji për zgjidhjen e bankave, i miratuar në tetor 2023, e nominoi Bankën Popullore si organ për zgjidhje), përpjekjet duhet të orientohen në mënyrë shtesë drejt zbatimit.

Lidhur me **politikën ekonomike**, Maqedonia e Veriut ka nivel të lartë të harmonizimit me të drejtën e BE-së për kornizat buxhetore afatmesme. Legjislacioni i Maqedonisë së Veriut është pjesërisht i harmonizuar me të drejtën e BE-së për parashikimet buxhetore, statistikën, rregullat fiskale numerike, transparencën e financave të përgjithshme qeveritare dhe procedurën e çekuilibrit makroekonomik. Parashikimet makroekonomike dhe buxhetore janë shpesh tepër optimiste, shpesh nuk kanë ndikim të kuantifikuar fiskal të propozimeve të reja.

Një sërë reformash të rëndësishme në lidhje me financat publike kanë ngecur vitin e kaluar. Legjislacioni që zbaton Ligjin për buxhete nga viti 2022 duhet të përshejtohet miratimi në mënyrë që dispozitat për këshillin e pavarur fiskal, rregullat fiskale dhe planifikimin afatmesëm të mund të zbatohen plotësisht deri në vitin 2025. Këshilli Fiskal i sapoformuar do të duhet të ketë kuadër të plotë për t'i marrë funksionet e tij.

**Programi i Reformave Ekonomike (PRE) për vitet 2024-2026** paraqet kornizë makroekonomike koherente dhe konsistente, dhe deri diku edhe optimiste. Maqedonia e

Veriut ka zbatuar vetëm pjesërisht udhëzimet e politikave të përcaktuara në konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar të majit 2023).

## **Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi**

*Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standardet minimale për të drejtën e punës, barazinë, shëndetin dhe sigurinë gjatë punës dhe mosdiskriminimin. Ato, gjithashtu, promovojnë gjithëpërfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale, dhe dialogun social në nivel të BE-së.*

Lidhur me **Ligjin për marrëdhënie pune**, rroga minimale duke filluar nga marsi 2024 është 22.567,00 denarë (rreth 365 euro). Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP) i ka përmirësuar kapacitetet e tij duke angazhuar 25 inspektorë shtesë dhe duke zbatuar më shumë trajnime, por nevojiten përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në fushën e sigurisë gjatë punës.

Lidhur me **sigurinë dhe shëndetin gjatë punës**, së shpejti duhet të miratohet Ligji i ri për siguri dhe shëndet gjatë punës. Nga janari deri në dhjetor 2023, inspektorët e ISHP-së kanë kryer gjithsej 22.938 mbikëqyrje inspektuese për konstatimin e mangësive dhe parregullsive, për të cilat janë miratuar gjithsej 5.543 vendime. Për kundërvajtjet e dispozitave janë lëshuar gjithsej 994 urdhërpagesa, janë parashtruar 112 kallëzime për kundërvajtje, si dhe 35 kallëzime penale. Pas riorganizimit shtetëror në vitin 2024, Inspektorati Shtetëror i Punës tashmë është nën Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës. Organet duhet të miratojnë plan veprim për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës për periudhën 2024-2025.

Për sa i përket **dialogut social**, zbatimi dhe miratimi i marrëveshjeve kolektive në sektorin privat mbeten të dobëta. Ligji për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës së shpejti duhet të zbatohet. Kapacitetet e partnerëve socialë kërkojnë forcim të mëtejshëm. Këshilli Ekonomik dhe Social (KES) ka mbajtur gjithsej pesë mbledhje gjatë periudhës raportuese.

Për sa i përket **politikës së punësimit**, është miratuar Strategjia Nacionale e Punësimit për vitet 2021-2027 bashkë me Planin e Veprimit të Punësimit për vitet 2021-2023. Gjatë vitit 2023, Qeveria e miratoi Strategjinë e re për formalizimin e ekonomisë joformale për vitet 2023-2027 me Planin e Veprimit për vitet 2023-2025. Kapaciteti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të përmirësohet në mënyrë shtesë, me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të zbatimit të masave aktive në tregun e punës dhe Garancisë për të Rinjtë.

Lidhur me pjesëmarrjen e **fuqisë punëtore dhe shkallën e papunësisë**, shihni aneksin statistikor dhe departamentin mbi funksionimin e tregut të punës në 2.3 Kriteret ekonomike.

Skema e Garancisë për të Rinjtë mbetet masa kryesore për t'u përballur me papunësinë e të rinjve. Zbatimi i saj vazhdoi në të gjithë vendin, pas miratimit të Planit të Zbatimit të Garancisë për të Rinjtë për vitet 2023-2026. Në fund të vitit 2023, në të gjithë vendin janë regjistruar gjithsej 23.619 persona (11.675 gra), nga të cilët 8.404 kanë qenë të punësuar, ndërsa 1.849 kanë marrë pjesë në masat aktive të punësimit që nuk rezultojnë me punësim të drejtpërdrejtë, por i rrisin mundësitë e tyre për punësim. Garancia për të Rinjtë përfshinte 1.423 romë, si një nga kategoritë vulnerabile në tregun e punës.

Punësimi i romëve, personave të papunë në afat të gjatë dhe me kualifikim të ulët, dhe personave me aftësi të kufizuara mbështetet nga skema e garantuar e ndihmës minimale të futur me Ligjin për mbrojtjen sociale. Gjatë periudhës raportuese janë zbatuar Plani Operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2023 dhe Garancia për të Rinjtë që mbulojnë 12.788 persona, veçanërisht të rinjtë. Në vitin 2023, 46% e shfrytëzuesve të masave aktive të punësimit ishin gra, 1,6% ishin persona me aftësi të kufizuara, 64% ishin të rinj dhe 4,2% ishin romë.


Ekziston nivel mesatar i gatishmërisë për të marrë pjesë në **Fondin Social Evropian**. (Shih gjithashtu Kapitullin 22 – Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore).

Lidhur me **gjithëpërfshirjen dhe mbrojtjen sociale**, organet e miratuan Ligjin për mbështetjen financiare të kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve për t'u përballur me krizën energjetike. Organet, në konsultim me palët e interesuara relevante, kanë miratuar një sërë masash sociale për shfrytëzuesit e pensionit me pensione të ulëta. Pensionet u harmonizuan dy herë në vitin 2023, duke rezultuar në rritjen kumulative të pensioneve prej 14%. Mungon sistemi i ndjekjes dhe vlerësimit të shërbimeve sociale dhe sistemi i centralizuar i TI-së për ndjekjen e skemave të ndihmës sociale dhe disponueshmëria në shërbimet sociale duhet të rritet. Decentralizimi i ndihmës sociale është ende mesatar. Është shënuar progres në zbatimin e Strategjisë Nacionale për Deinstitutionalizimin për vitet 2018-2027. Në dhjetor 2023, Qeveria e miratoi Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për vitet 2023-2030 dhe Planin e Veprimit për vitet 2023-2026. Duhet të forcohen resurset njerëzore të Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. Qeveria e miratoi Planin e ri të Veprimit për Strategjinë për Deinstitutionalizimin për vitet 2022-2024. U vendosën shërbime, të tilla si kujdesi në shtëpi, ndihma personale, jetesa e mbështetur dhe kujdesi i përkohshëm. U miratua metodologjia për licencimin dhe përcaktimin e shpenzimeve të shërbimeve sociale, ndërsa u licencuan ofruesit jopublikë të shërbimeve sociale. Deri në prill 2024, u ndanë 119 ofrues të licencuar të shërbimeve sociale me kapacitet për t'u shërbyer 4.700 shfrytëzuesve në përputhje me Ligjin për mbrojtjen sociale. Shoqatat e qytetarëve dhe subjektet private morën licencë për të ofruar shërbime sociale.

Për **mosdiskriminim në punësim dhe politikë sociale**, Ligji për marrëdhënie pune duhet të harmonizohet me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Diskriminimi në bazë të punësimit dhe marrëdhënieve të punës ishte përfaqësuar në rastet e paraqitura tek Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga

Diskriminimi. (Shih gjithashtu Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat fundamentale).



Për sa i përket **barazisë midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale**, hendeku i dukshëm gjinor në tregun e punës vazhdon. Gratë në Maqedoninë e Veriut janë dukshëm më pak aktive në tregun e punës se burrat.

Në janar 2024, u zbatua kontrolli afatmesëm i zbatimit të Strategjisë së Punësimit dhe Planit të Veprimit për vitet 2021-2023. Kapacitetet e përkujdesjes për fëmijët dhe institucionet parashkollore u rritën në 1.072 vende deri në mars 2024. Ky kapacitet përfshin 34,5% të fëmijëve të moshës prej 0 deri në 6 vjeç dhe 45,5% të fëmijëve të moshës prej 3 deri në 6 vjeç. Në janar 2024, Qeveria e miratoi Programin për Mbështetjen e Sigurimit Social për

gratë që merren me veprimtari bujqësore për vitin 2024, me të cilin realizohet e drejta e përdorimit të kompensimit të mëmësisë gjatë parandalimit të kryerjes së veprimtarisë bujqësore për shkak të lindjes.

## **Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale**

*Politika industriale e BE-së e forcon konkurrencën, i lehtëson ndryshimet strukturore dhe nxit mjedis të përshtatshëm ndaj biznesit që i stimulon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).*

**Parimet e ndërmarrjeve dhe politikës industriale** mbeten të shpërndara në një numër të madh dokumentesh strategjike në kompetencë të organeve të ndryshme nacionale dhe plani për të konsoliduar një pjesë të strukturave administrative, duke bashkuar disa institucione dhe duke integruar të tjera në Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës ishte miratuar, por ende nuk ishte zbatuar (*shih gjithashtu departamentin e reformës së administratës publike*).

Strategjia e Promovimit të Eksportit për vitet 2024-2027 u miratua në janar 2024 dhe do të duhet të zbatohet shpejt. Ishte publikuar Raporti i Observatorit të NVM-ve për vitin 2022, i cili ofron të dhëna statistikore dhe analiza mbi gjendjen faktike të NVM-ve. Ministria e Ekonomisë dhe Punës ka nisur punën për strategjinë e re për zhvillimin e NVM-ve për të cilën është ofruar ndihmë teknike nga BE-ja. Strategjia ishte planifikuar të miratohet në dhjetor 2024, do të mbulojë periudhën 2025-2030 dhe do të bazohet në Strategjinë e BE-së për NVM-të e gjelbra dhe digjitale dhe Aktin e Ndërmarrjeve të Vogla.

Dialogu me odat ekonomike u zhvillua përmes platformës së dedikuar të menaxhuar nga zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështjet Ekonomike. Megjithatë, dialogu duhet të jetë më transparent, sistematik dhe dukshëm më i përgjegjshëm ndaj nevojave afariste. Organet nacionale vazhdojnë të miratojnë masa, ligje dhe të zbatojnë legalizimin pa njoftim paraprak dhe periudhë të përshtatjes për kompanitë. Organet zbatojnë ndjekje të rregullt të zbatimit të politikës bazuar në treguesit e hyrjes, por nuk bëhet vlerësimi i ndikimit dhe efektivitetit. Nga 15 lëshimet e konstatuara vitin e kaluar nga Enti Shtetëror i Revizionit, Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FIZHT) zgjidhi tre, ndërsa pjesërisht zgjidhi gjashtë.

Në përgjithësi, ndërmarrjet dhe politika industriale do të përfitonin nga përmirësimi i koherencës dhe koordinimit institucional, ndërkohë që ndikimi i politikave të zhvillimit të sektorit privat mbetet i paqartë.

Ishte arritur njëfarë progresi në zbatimin e Planit të Rritjes së Përsheptuar Ekonomike për vitet 2022-2026. Ishte vendosur kornizë juridike për Instrumentin e ri të Garancisë, Fondin e Zhvillimit, Fondin e Efikasitetit Energjetik dhe Fondin Strategjik Hibrid për Investimet e Gjelbra. Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik mbetet institucioni vendimtar për mbështetjen e inovacioneve në kompanitë private. Në kuadër të programit për ndërmarrësi, Agjencia e Ndërmarrësisë ka ofruar trajnime për zhvillimin e frymës dhe kulturës ndërmarrëse. Drejtoria e Zonave Zhvillimore Industriale Teknologjike ka nisur program të zhvillimit të furnizuesve për t'i mbështetur kompanitë lokale për t'u integruar në zinxhirët globalë të vlerës. Racionalizimi i taksave parafiskale nuk përparoi. FIZHT-ja ka nisur punën për masat për ndihmë financiare për "gjelbërimin" e bizneseve për t'i mbështetur financiarisht aktivitetet e kompanive në përputhje me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Pavarësisht rritjes së fundit të rrogave mesatare, kompanitë po përballen me vështirësi në punësimin e fuqisë punëtore të kualifikuar për shkak të emigrimit të konsiderueshëm dhe mosharmonizimit të vazhdueshëm midis kërkesës dhe ofertës së aftësive.

Ekzistojnë masa të shumta politike për ndihmë financiare dhe jofinanciare për kompanitë. Asnjë nga masat nuk ishte lëndë e vlerësimit të thellë për të vlerësuar rëndësinë e tyre, potencialin për të prishur konkurrencën në treg ose efektivitetin dhe ndikimin në rritjen e përgjithshme të ekonomisë.



Për sa u përket **instrumenteve politike**, Maqedonia e Veriut merr pjesë në shtyllën e NVM-ve të Programit të Tregut Unik.

Është shënuar progres i caktuar në harmonizimin me Direktivën e pagesës së vonuar, ndërsa transponimi i plotë është planifikuar deri në fund të vitit 2025.

Për sa u përket **politikave sektoriale**, strategjia e miratuar e specializimit të mençur i mbulon industrinë sipas këtij kapitulli, në veçanti industrinë elektro-makinë, përpunimin e ushqimit, ndërtimtarinë dhe turizmin (me shumë detaje, shih Kapitullin 25 – Shkenca dhe kërkimi). Në kuadër të Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së Industrisë së Përpunimit dhe Përgjegjësisë Shoqërore, u pilotua një masë që synon bashkëpunimin ndërmjet industrisë dhe akademisë në fushat S3. Strategjia e re për turizmin është në zhvillim e sipër. Vendi i lansoi udhërrëfyesit e tij të ekonomisë qarkore në mars 2024, duke i targetuar modelet afariste qarkore në pesë sektorët kryesorë: NVM-të, ndërtimtarinë, biomasën dhe ushqimin, tekstilin dhe minierën dhe metalurgjinë.

## **Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi**

*BE-ja ofron mbështetje të konsiderueshme për kërkimin dhe inovacionet. Të gjitha vendet anëtare mund të marrin pjesë në programet e kërkimit dhe inovacioneve të BE-së dhe t'i përdorin përfitimet, veçanërisht aty ku ka përsosmëri shkencore dhe investime solide në kërkimin dhe inovacionet.*

Është arritur progres i caktuar për harmonizimin me standardet evropiane lidhur me **kërkimin dhe inovacionet**. Në vitin 2023, Enti Shtetëror i Pronësisë Industriale regjistroi 581 patenta, ndërsa Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpalli thirrje për gjashtë aksione të reja në Fushën Evropiane të Kërkimit. Strategjia e Specializimit të Mençur, dokumenti kryesor i politikës së inovacioneve dhe kërkimit me prioritetet të qarta që ishin specifike për sektorin dhe Plani i Veprimtimit dyvjeçar për vitet 2024-2025 u miratuan në dhjetor 2023. Zbatimi filloi ngadalë, pasi nuk ishte ndarë buxheti i rëndësishëm shtetëror për vitin 2024. Investimet e përgjithshme në kërkim dhe inovacione mbeten të ulëta (vetëm 0,38% të BPV-së për vitin 2022), ndërsa pjesëmarrja e sektorit privat në kërkim mbetet si edhe në vitet e kaluara (0,1% të BPV-së). Ende nuk është hartuar Udhërrëfyesi Nacional për Infrastrukturën Kërkimore. Organet duhet të forcojnë pjesëmarrjen e tyre në Fushën e re Evropiane të Kërkimit dhe në Agjendën e re Evropiane të Inovacioneve.

Pjesëmarrja e vendit në **Horizont Evropa**, programi kornizë i kërkimit dhe inovacioneve të BE-së vazhdoi, ndërsa në vitin 2023, 17 projekte morën mjete prej 3,4 milionë euro (30% më pak mjete se në vitin 2022). Ende nuk është hartuar Udhërrëfyesi Nacional për Transferimin e Teknologjisë. Organet duhet të forcojnë pjesëmarrjen e tyre në Fushën e re Evropiane të Kërkimit dhe në Agjendën e re Evropiane të Inovacioneve.

Për sa u përket **inovacioneve**, Tabela Evropiane e Inovacioneve 2024 e klasifikon vendin si "novator në zhvillim" me rezultat prej 45,1% të mesatares së BE-së, që shënon rënie prej 4,5% krahasuar me vitin 2023. Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik ka filluar ristrukturimin për të qenë në përputhje me konstatimet e Entit Shtetëror të Revizionit. Bashkëpunimi Afarist Akademik forcohet me program special për grante, të filluar në fillim të vitit 2024.

Qendra për RIS të EIT-së ishte themeluar dhe filloi të promovojë mbështetjen e EIT-së në fushën e arsimit-shkencës-inovacioneve.

## **Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura**

*BE-ja e mbështet bashkëpunimin në arsim dhe kulturë përmes programeve të financimit dhe koordinimit të politikave të vendeve anëtare përmes "metodës së hapur të koordinimit". BE-ja dhe vendet anëtare duhet gjithashtu të parandalojnë diskriminimin dhe të sigurojnë arsim*

*cilësor për fëmijët e punëtorëve migrantë, duke i përfshirë edhe ata nga mjediset që privohen nga të drejtat.*

Strategjia e **Arsimit** për vitet 2018-2025 është dokumenti kryesor për rregullimin e sektorit të arsimit, por mekanizmat e saj të ndjekjes nuk janë të përkufizuara mirë. Qëllimet dhe treguesit duhet të përmirësohen për të mundësuar vlerësimin e duhur të zbatimit të reformave. Organet duhet të forcojnë koordinimin ndërmjet institucioneve gjatë hartimit të legjislacionit.

Organet duhet t'i përmirësojnë kapacitetet në sistemin shkollor, gjë që do të mundësojë optimizimin dhe ristrukturimin e rrjetit shkollor, i cili do të rrisë efikasitetin e sistemit arsimor. Së shpejti duhet të miratohet modeli i ri i financimit për arsimin fillor, i cili ka për qëllim rishpërndarjen më efikase të mjeteve ndërmjet komunave, i zhvilluar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Konsumi publik për arsimin dhe trajnimin u ulën minimalisht në 3,17% të BPV-së në vitin 2024 (3,58% në vitin 2022), që është ende shumë larg nën mesataren e BE-së prej 4,7%. Buxheti i arsimit është ulur si pjesë e buxhetit të përgjithshëm shtetëror në vitin 2024 (9,15 %) krahasuar me vitin 2023 (11,7%).

Gjatë periudhës raportuese, kapaciteti i institucioneve publike dhe private për arsimin dhe kujdesin e hershëm të fëmijëve është rritur për 1.072 vende. Derisa regjistrimi i fëmijëve prej 3 deri në 6 vjeç në institucionet për arsimin dhe kujdesin e hershëm të fëmijëve u rrit për 4% gjatë vitit të kaluar, shkalla aktuale prej 46% është ende dukshëm më e ulët në krahasim me qëllimin e BE-së për prani në institucionet për arsimin dhe kujdesin e hershëm të fëmijëve të vendosur në 96%.

Numri i nxënësve në shkollat fillore është zvogëluar për 0,83% në fillim të vitit shkollor 2022/2023, ndërsa numri i nxënësve në shkollat e mesme është zvogëluar për 2,52% krahasuar me vitin paraprak shkollor. Në vitin 2022/2023, në shkollat fillore në vitin 2022/2023 kanë qenë 185.099 nxënës (nga të cilët 89.676 femra), ndërsa në shkollat e mesme 69.227 (nga të cilët 33.825 femra).

Në përputhje me Ligjin për arsimin fillor, Konceptin e Arsimit Fillor, si dhe rezultatet nacionale nga të nxënësve dhe standardet e vlerësimit, në vitin shkollor 2023/2024 ishin futur programe mësimore për klasën e gjashtë, duke mbuluar gjashtë vitet e para nga tetë vitet e arsimit fillor.

Rezultatet e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) nga viti 2022, të publikuara në nëntor 2023, treguan ngecje shqetësuese të rezultateve nga të nxënësve të leximit, matematikë dhe shkencat natyrore, si dhe rënie në krahasim me vitin 2018. Në të tre testet, nxënësit në Maqedoninë e Veriut arritën rezultate më të ulëta se mesatarja e OECD-së. Rezultatet tregojnë përqindje të lartë të nxënësve të moshës 15 vjeç që nuk arrijnë të demonstrojnë njohuritë bazë (niveli 2) në lexim (73,6%), matematikë (66,2%) dhe shkencat natyrore (65,3%). Maqedonia e Veriut po merr pjesë në Studimin Ndërkombëtar të Matematikës dhe Shkencës (TIMSS 2023) dhe Kërkimin Ndërkombëtar të Ligjërimit dhe Mësimin (TALIS 2024) me qëllim që të ofrojnë të dhëna të bazuara në dëshmitë për kushtet e punës së mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave dhe mjedisit në të cilin mësojnë në shkollat e tyre. Sipas Konceptit të Arsimit Fillor, në programet e reja mësimore për lëndët për klasën e parë, të dytë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të arsimit fillor, si dhe për ato për klasën e shtatë dhe të tetë (të përgatitura në periudhën nga tetori 2023 deri në mars 2024), aftësitë e gjelbra janë të integruara në përmbajtjet e lëndëve të ndryshme mësimore, veçanërisht brenda shkencave natyrore. Megjithatë, rezultatet e këtyre testeve nuk janë ende të disponueshme.

Maqedonia e Veriut ka ndërmarrë hapa drejt transformimit digjital efikas, koherent dhe gjithëpërfshirës të sistemit të saj arsimor duke prezantuar Sistem të ri Informativ për Menaxhimin e Arsimit (EMIS), duke pajisur shkollat dhe duke vënë në përdorim tekstet

shkollore digjitale në arsimin fillor. Organet duhet në mënyrë shtesë të mundësojnë zhvillimin e aftësive digjitale gjatë arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe t'i rrisin kapacitetet e institucioneve arsimore dhe kompetencat e mësimit për t'i zhvilluar ato aftësi në përputhje me Planin e Veprimit të BE-së për Arsimin Digjital për vitet 2021-2027. Hartimi i programit mësimor për arsimin e mesëm, duke i përfshirë edhe aftësitë e gjelbra ishte anuluar në mënyrë shtesë, pasi Ligji për arsimin e mesëm ende nuk ishte miratuar.

Ligji i ri për arsimin dhe trajnimin profesional (ATP) së shpejti duhet të miratohet. Është vendosur skema e bashkëpunimit ndërmjet kompanive afariste, shkollave të mesme profesionale, odave ekonomike dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të mbështetur praktikën e nxënësve në kompani private. Në vitin shkollor 2023/24 kanë punuar gjithsej 568 paralele duale me 8.242 nxënës të regjistruar.

Në arsimin e lartë, numri i përgjithshëm i të regjistruarve mbetet i ulët. Në vitin akademik 2022/2023 ishin regjistruar 69.227 studentë (nga të cilët 33.825 femra). Sfida kryesore mbetet përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë përmes zhvillimit të proceseve të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë. Duhet të miratohet modeli i ri për financimin e arsimit të lartë.

Në tremujorin e fundit të vitit 2023, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e finalizoi projektin për të mbështetur më tej zbatimin e Kornizës Nacionale të Kualifikimeve, e cila rezultoi në zhvillimin e "trajnit të trajnuesve", doracakun për zhvillimin e standardeve të kualifikimeve, mbajtjen e trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e udhëzimeve për menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë së regjistrimit digjital në regjistrin e KNK-së.

Maqedonia e Veriut mbetet anëtare e Hapësirës Evropiane për Arsimin e Lartë (Procesi i Bolonjës).

Maqedonia e Veriut vazhdoi të marrë pjesë në Erasmus+. Në vitin 2023, organizatat nga Maqedonia e Veriut morën pjesë si kërkues ose partnerë në 828 projekte të Erasmus+ (dhe gjithashtu Korpusi Evropian i Solidaritetit) për grantin e përgjithshëm kontraktues prej 7,05 milionë euro. Vendi vazhdon të marrë pjesë në grupet e punës të Hapësirës Evropiane të Arsimit për vitet 2021-2025.

Ligji për arsimin e të rriturve ende nuk është miratuar. Maqedonia e Veriut ka arritur progres të caktuar në arsimin gjithëpërfshirës, veçanërisht në arsimin fillor. Nga viti shkollor 2023/2024, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore regjistrohen në shkollat e rregullta fillore, me çka numri i tyre u rrit rreth 10%. Numri i përgjithshëm i asistentëve arsimorë në arsimin fillor ishte 820. Gjatë periudhës raportuese, organet shpallën thirrje për angazhimin e 40 ndërmjetësuesve arsimorë romë nga 28 komuna për t'i mbështetur nxënësit romë në arsimin fillor. Në vitin shkollor 2023/2024, numri i përgjithshëm i nxënësve romë në arsimin fillor është 9.657, ndërsa në arsimin e mesëm është 1.970, ku rreth dy të tretat marrin bursë. Në arsimin e lartë, organet dhanë 135 bursa për studentët romë, ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve romë aktivë në sistemin arsimor është 250.

Në periudhën raportuese, organet e miratuan Strategjinë Nacionale për **Rininë** për vitet 2023-2027 bashkë me Planin e Veprimit për vitet 2023-2025. Lidhur me **sportin**, Maqedonia e Veriut vazhdoi të marrë pjesë në Javën Evropiane të Sportit.

Për sa i përket **kulturës** dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në mënyrë shtesë u anulua miratimi i ndryshimeve në legjislacionin nacional për kulturën dhe Strategjia e re Nacionale për vitet 2023-2027 për zhvillimin e kulturës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ministria e Kulturës duhet t'i forcojë kapacitetet për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore në vend, duke e përfshirë edhe trashëgiminë. Raporti i Entit Shtetëror të Revizionit nxori në pah nevojën e forcimit të sistemit juridik dhe operativ të Agjencisë së Filmit në vend. Trashëgimia kulturore e vendit duhet të ruhet më mirë. Duhet të merren parasysh përpjekjet shtesë për të forcuar përgjigjen institucionale dhe bashkëpunimin ndër-institucional për mbrojtjen e lokacioneve të trashëgimisë kulturore, siç është Çarshia e

Vjetër e Shkupit. Maqedonia e Veriut vazhdoi të marrë pjesë plotësisht në programin "Evropa Kreative".

## Kapitulli 29: Unioni Doganor

*Të gjitha vendet anëtare janë pjesë e Unionit Doganor të BE-së dhe i ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon harmonizimin e legjislacionit, si dhe kapacitetin e duhur të zbatimit dhe aplikimit, si dhe qasjen dhe interoperabilitetin me mjedisin doganor elektronik të BE-së.*

Shkalla e harmonizimit të **legjislacionit doganor** me të drejtën e BE-së është e lartë. Në fushën e legjislacionit doganor, është arritur progres në harmonizimin me nomenklaturën e kombinuar të BE-së.

Si pjesë e përpjekjeve në luftën kundër mashtrimeve, rekomandohet që Maqedonia e Veriut të forcojë luftën kundër mashtrimit doganor, veçanërisht kontrabandës së produkteve të duhanit, dhe përmes bashkëpunimit me OLAF-in, si dhe të ratifikojë Protokollin për Eliminimin e Tregtisë së Palejuar me Produktet e Duhanit, të nënshkruar në vitin 2014. Për sa i përket **kapacitetit administrativ dhe operativ**, është vendosur sistemi gjithëpërfshirës i zbulimit për t'i mbështetur hetimet dhe zbatimin. Kontrollat bazohen në analizën e rreziqeve të udhëhequr nga zbulimi, informacionet para mbërritjes dhe teknikat e selektimit. Menaxhimi i rrezikut u aplikua në mënyrë sistematike me përqindje të kontrollit fizik (kanali i kuq) prej 5,7% dhe kontrollat dokumentare (kanali i verdhë) që përbënin 16,9% të të gjitha dërgesave në vitin 2023. Në vitin 2024, filloi projekti i ri për të avancuar menaxhimin e rreziqeve dhe themelimin e magazinës së të dhënave doganore.

Të ardhurat e përgjithshme të Drejtorisë së Doganave në vitin 2023 ishin për 1% më të ulëta se në vitin 2022 dhe arritën në 1,9 miliardë euro. Marrëveshja për vendosjen e sistemit me një sportel për kontroll me Kosovën u ratifikua në dhjetor 2023. Strategjia e Zhvillimit të TIK-së për vitet 2021-2025 u zbatua për të siguruar zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve nacionale në koordinim me ato të BE-së. Puna e SRKT-së (faza 4) në Maqedoninë e Veriut ishte e kënaqshme. Plotësimi i sistemit nacional të SRKT-së në fazën 5 po përballlet me anulimin dhe mbetet prioritet për vitin 2024. Për t'u përballur me të, është e domosdoshme të ndërtohen kapacitete shtesë dhe të punësohen kuadër, veçanërisht në fushën e TI-së.

Drejtorja e Doganave ka marrë pjesë në shtatë operacione ndërkombëtare në periudhën nga shtatori 2023 deri në mars 2024. Vazhdoi bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve të zbulimit me shërbimet doganore të rajonit dhe me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

## KLASTERI 4: AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME

Ky klaster përfshin: politikën e transportit (Kapitulli 14); energjetikën (Kapitulli 15); rrjetet transevropiane (Kapitulli 21); dhe mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike (Kapitulli 27).

## Kapitulli 14: Politika e transportit

*BE-ja ka rregulla të përbashkëta për standardet teknike dhe të sigurisë, sigurinë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në komunikacionin rrugor, komunikacionin hekurudhor, komunikacionin ujor të brendshëm, komunikacionin multimodal, aviacionin dhe komunikacionin detar.*

Lidhur me të drejtën e **përgjithshëm** të BE-së për **transportin**, dokumentet strategjike kryesore për transportin dhe nënsektorët e tij janë përcaktuar tashmë nga viti 2023, por nuk ishte arritur progres në zhvillimin e planit të veprimit që do ta mbështesë Strategjinë Nacionale të Transportit për vitet 2018-2030. Kapaciteti operativ dhe administrativ për të gjitha llojet e transportit ishte i ulët dhe ishte bërë pak përpjekje për ta forcuar atë.

Megjithëse Maqedonia e Veriut është e përfshirë në mënyrë aktive në punën e Komunitetit të Transportit, përsëri ishte arritur progres i kufizuar në zbatimin e planeve të veprimit të Marrëveshjes për Komunitetin e Transportit. Nuk ka plane të përcaktuara për lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane për Shkupin dhe për qytetet e tjera të mëdha. Në Qeverinë e re, ministri i Transportit, i cili është edhe zëvendëskryetar i Qeverisë, mbetet përgjegjës për sektorin e transportit dhe postës.

Për sa i përket **transportit rrugor**, legjislacioni është pjesërisht i harmonizuar me të *drejtën* e BE-së. Nevojiten përpjekje shtesë për të harmonizuar plotësisht të *drejtën* e BE-së për rregullat sociale dhe të tregut në transportin rrugor. Ende nuk është themeluar trupi ekzekutiv për sigurinë në transportin rrugor dhe ende nuk është vendosur strategjia e sigurisë rrugore. Legjislacioni për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore dhe kërkesat minimale të sigurisë për tunelet në rrjetin rrugor transevropian nuk janë harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Legjislacioni nacional për qasjen në tregun e transportit ndërkombëtar të pasagjerëve është pjesërisht i harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Ligji për transportin e materieve të rrezikshme në komunikacionin e pasagjerëve dhe hekurudhave është harmonizuar me të *drejtën* e BE-së, por ende nuk është emëruar personi juridik për të kryer vlerësimin e konformitetit të pajisjeve ekzistuese për transportin e materieve të rrezikshme. Kapacitetet për zbatimin dhe kapacitetet teknike të Inspektoratit Shtetëror të Transportit mbeten të dobëta. Plani pesëvjeçar i mirëmbajtjes së rrugëve nuk publikohet rregullisht. Financimi për mirëmbajtjen e rrugëve nuk i mbulon nevojat. Strategjia Nationale për ITS dhe Plani i Veprimit u miratuan nga Qeveria, por ligjet nationale nuk janë harmonizuar me direktivat e BE-së për ITS-në.

Në lidhje me **transportin hekurudhor**, janë përmbushur kërkesat kryesore të shtyllës së tregut të së *drejtës* së BE-së në lidhje me ndarjen e drejtorit të infrastrukturës dhe operatorit shtetëror. Derisa tregu i transportit hekurudhor është hapur për të gjithë operatorët nga dhjetori 2023, ndryshimet e fundit në ligj që synojnë mbylljen e tregut për pjesëmarrësit e rinj derisa vendi të anëtarësohet në BE paraqet largimin nga qëllimi i legjislacionit të BE-së dhe Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit. Nevojitet zbatimi i legjislacionit të ndryshuar për sigurinë dhe interoperabilitetin hekurudhor. Përgatitjet për forcimin e kapacitetit operativ të Drejtorisë së Sigurisë në Sistemin Hekurudhor janë vonuar. Ende nuk ka progres në themelimin e trupit për hetime dhe aksidente. Marrëveshja e ndërsjellë për bashkëpunim hekurudhor tejkuftar me Greqinë ende nuk është lidhur. Në fushën e **transportit detar**, Maqedonia e Veriut, si vend pa dalje në det, merr pjesë në të gjitha konventat themelore të transportit të Organizatës Detare Ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Agjencinë Evropiane për Sigurinë Detare (EMSA). Nevojitet harmonizimi themelor me legjislacionin.

Për sa i përket **transportit ujqor të brendshëm**, Maqedonia e Veriut është harmonizuar me pjesën më të madhe të së *drejtës* së BE-së, por jo edhe me Rregullativën për njohjen e certifikatave dhe transportin e mallrave dhe pasagjerëve. Vendi parashtrroi kërkesë për pjesëmarrje në Strategjinë e BE-së për Zhvillimin e Rajonit të Danubit dhe vazhdon të kontribuojë në mënyrë aktive në punën e Komisionit Ndërkombëtar për Pellgun e Lumit Sava. Ende nevojitet harmonizimi i legjislacionit me rregullat e përgjithshme të zbatueshme për pasagjerët që udhëtojnë përmes rrugëve ujore të brendshme.

Në fushën e **aviacionit**, vendi ruan nivel të mirë të harmonizimit me të *drejtën* e BE-së dhe pjesërisht harmonizohet me legjislacionin e sigurisë së aviacionit brenda periudhës raportuese. Gjatë periudhës raportuese, është bërë vlerësimi nëse vendi duhet të pranohet në fazën tjetër të Marrëveshjes për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA). Nevojiten ende përpjekje shtesë për të lehtësuar inspektimet e standardizimit të Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit. Duhet të ruhet funksionimi i pavarur i ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror.

Për sa i përket **transportit** multimodal, ishte arritur progres dhe ekspertët teknikë janë ende duke punuar në vendosjen e qendrës multimodale afër Shkupit. Maqedonia e Veriut ende nuk e ka harmonizuar legjislacionin e saj nacional me të drejtën e BE-së për informacionet elektronike për transportin e ngarkesave.

Për sa i përket së drejtës së BE-së për të **drejtat e pasagjerëve**, ishte arritur progres me të drejtat e pasagjerëve në autobus dhe automjete për transportin e pasagjerëve, por përsëri mbetet për t'u harmonizuar me të drejtat e pasagjerëve në komunikacionin hekurudhor.

## Kapitulli 15: Energjetika

*Politika energjetike e BE-së përfshin furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e rinovueshme, efikasitetin energjetik, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore, mbrojtjen nga rrezatimi dhe mbrojtjen bërthamore.*

Në qershor 2023, Qeveria miratoi Udhërrëfyes për tranzicionin e drejtë që përfshin veprime konkrete që duhen ndërmarrë në planin afatshkurtër (2024-25), planin afatmesëm (2026-27) dhe planin afatgjatë në zonat e Manastirit dhe Kërçovës. Ishte hartuar Plani i Investimeve për tranzicionin e përshtetshëm nga qymyri në kuadër të Programit të Tranzicionit të Përshtetshëm nga qymyri i përcaktuar nga Fondi Klimatik i Investimeve, por zbatimi është në pritje.

Qeveria zbatoi disa nga masat e përcaktuara në Planin Nacional të Veprimit për Energjinë dhe Klimën, të miratuar në dhjetor 2022, i cili mori kontributet relevante nga Pakoja e BE-së për Mbështetjen Energjetike. Janë zbatuar programe për të mbështetur efikasitetin energjetik dhe burimet e rinovueshme në shkallë të vogël, megjithëse me ritëm të kufizuar. Në zhvillim e sipër janë reformat institucionale, revizioni i kornizës strategjike, miratimi dhe zbatimi i legjislacionit të ri.

Pritet përditësimi i **Planit Nacional aktual të Energjisë dhe Klimës** nga viti 2022 për të përmbushur rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit Energjetik.

Kapaciteti administrativ për t'u përballur me politikën energjetike, planifikimin strategjik dhe investimet në sektorin energjetik mbetet kryesisht i pamjaftueshëm. Nuk ka sistem për mbledhjen e të dhënave energjetike brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, dhe as vlerësim adekuat të politikës, as vlerësim të performancës.

Për sa i përket **sigurisë së furnizimit**, vendi mbetet dukshëm i varur nga qymyri. Termocentralet në Manastir dhe Oslomej/Kërçovë vazhdojnë të punojnë me qymyr nga burimet e kufizuara vendase dhe nga importi. Fuqia e instaluar e elektranave nga burimet e rinovueshme të energjisë është rritur në 50% të fuqisë së përgjithshme të instaluar të energjisë elektrike dhe 33% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Më e dukshme është rritja prej 287% e prodhimit të energjisë elektrike nga elektranat fotovoltaike në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Prodhimi vendas i energjisë elektrike merr pjesë me 97,25% të konsumit bruto të energjisë elektrike, ndërsa vetëm 2,75% sigurohet nga importi. Rezervat e naftës për rastet urgjente janë të mjaftueshme për të paktën 58 ditë konsum mesatar, që është nën detyrimin prej 90 ditë të importit neto ditor. Dispozitat për sigurinë e furnizimit me gaz, duke përfshirë edhe aspektet që lidhen me deponimin e gazit, nuk janë në përputhje me të drejtën e BE-së. Operatori i sistemit të transmetimit të gazit është i certifikuar sipas kërkesës së pakos së tretë energjetike.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka kryer shumë revizione në sektorin energjetik. Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike MEPSO dhe shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike ESM duhet të fokusohen më shumë në digjitalizimin, transparencën e prokurimeve publike dhe procedurat tjera për planifikimin e aktiviteteve dhe investimeve. Humbjet në rrjet prej 13,80% mbeten të larta sipas standardeve ndërkombëtare si rezultat i humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes.

Për sa u përket **burimeve të rinovueshme të energjisë**, PNEK-ja ka vendosur qëllimin që pjesa e burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin bruto final të energjisë në vitin 2030 të jetë 38%, që korrespondon me qëllimet e vendosura nga Komuniteti Energjetik. Legjislacioni nacional nuk është harmonizuar me Direktivën e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë. Pjesa e burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE) në konsumin bruto final të energjisë për vitin 2022 ishte 18,8% (për vitin 2023, të dhënat nuk janë në dispozicion). Investimet në hidroenergji duhet të harmonizohen me të *drejtën* relevante të BE-së për mjedisin jetësor. Optimizimi i shërbimeve të balancimit dhe investimeve në transmetimin e energjisë dhe deponimin e energjisë duhet të avancohet për të përmirësuar integrimin e BRE-ve në rrjet. Është i domosdoshëm plotësimi i sistemit të rrjetit. Operatori i sistemit të transmetimit të gazit është i certifikuar sipas kërkesës së pakos së tretë energjetike.

Legjislacioni i Vlerësimit të Ndikimit mbi Mjedisin Jetësor (EIA) nuk është harmonizuar me të *drejtën* e BE-së dhe paraqet rrezik të konsiderueshëm për zbatimin e vlerësimeve cilësore të ndikimit mbi mjedisin jetësor për projektet energjetike strategjike. Gjithashtu, nuk ka përmirësime në aktet nënligjore në lidhje me proceset e skringut për projektet e vogla hidroenergjetike me fuqi të instaluar më pak se 2 MW.

Ligji për **efikasitetin energjetik** është pjesërisht i harmonizuar me Direktivën për Efikasitetin Energjetik dhe me Direktivën e Karakteristikave Energjetike të Ndërtesave. Pas ndryshimeve të fundit në Direktivën e Efikasitetit Energjetik në vitin 2023, po vazhdon përditësimi i Ligjit për efikasitetin energjetik. Zbatimi i legjislacionit aktual nuk është përmirësuar.

Për sa i përket **energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore, mbrojtjes nga rrezatimi dhe mbrojtjes bërthamore**, nuk ka pasur ndryshime në periudhën raportuese.

## **Kapitulli 21: Rrjetet transevropiane**

*BE-ja i avancon rrjetet transevropiane (TEN) në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe energjetikës për të forcuar tregun e brendshëm dhe për të kontribuar në rritje dhe në punësim.*

Për sa u përket **rrjeteve të transportit**, pjesa më e madhe e rrjetit rrugor nuk është harmonizuar me Rregullativën TEN-T, me ç'rast, në këtë aspekt, Korridori 10 është më me shumë përparim se Korridori 8. Strategjia Nacionale e Transportit për vitet 2018 - 2030 (SNT) është në përputhje me zhvillimin e TEN-T, por përsëri nuk ka plan të veprimit. Prokurimet joefikase, si për planin e veprimit të SNT-së dhe zbatimi i ngadalshëm, ashtu edhe për intervenimet përgjatë korridorit 10d, e pengojnë zhvillimin në këtë sektor. Vendi për momentin po zbaton më shumë se 10 projekte në rrjetin rrugor TEN-T. Mjetet e dedikuara për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore nuk i mbulojnë nevojat. Ka interes të kufizuar për zhvillimin e planeve të lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane (SUMP), megjithëse për projektet relevante janë në dispozicion fondet IPA. Për sa u përket hendeqeve urbane, vendi ka përfituar nga studimi i fizibilitetit, i financuar nga IPA për hendequn multimodal në Trubarevë.

Në prill 2024, ishte bërë ratifikimi i marrëveshjes në nivelin e lartë ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian për hartat treguese të Rrjetit të Transportit Transevropian në Maqedoninë e Veriut në përputhje me marrëveshjen për hartat treguese për TEN-T në Ballkanin Perëndimor, të nënshkruar në maj 2023. Korridori 8 do të jetë pjesë e korridorit të ri evropian të transportit për Ballkanin Perëndimor - Mesdheun Lindor, i cili do të lidhë Evropën Juglindore me qendrën e Evropës përmes rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Përparojnë punimet në korridorin hekurudhor 8 drejt Bullgarisë. Faza e tretë e projektit, kufiri i Kriva Pallankës me Bullgarinë u ndërpre nga organet nacionale. Nevojiten përpjekje shtesë të vazhdueshme për të përshpejtuar përparimin në korridorin hekurudhor 8 dhe pjesë të tjera prioritare të rrjetit kryesor, si për hekurudhat, ashtu edhe për rrugët.

Nevojiten përpjekje më të mëdha nga të dyja palët për të finalizuar marrëveshjen e ndërsjellë me Greqinë për vendosjen e vendkalimit kufitar hekurudhor Kremenicë - Neos Kafkasos me infrastrukturë hekurudhore tashmë të ndërtuar operative. Financat për ndërtimin e infrastrukturës adekuate afër kufirit me Serbinë në stacionin hekurudhor në vendkalimin kufitar Tabanoc ende nuk janë siguruar plotësisht. Planet pesëvjeçare për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hekurudhave nuk janë miratuar ende.

Për sa u përket **rrjeteve energjetike**, është në zhvillim e sipër ndërtimi i interkonektorit të ri me Shqipërinë për transmetimin e energjisë elektrike me tension prej 400 kV, i cili ngec sipas afatit. Përgatitja e dokumentacionit teknik për forcimin e rrjetit të transmetimit në rajonin juglindor të Maqedonisë së Veriut është duke u zhvilluar. Legjislacioni nacional është pjesërisht i harmonizuar me Rregullativën e vjetër për TEN-E, megjithëse duhet të harmonizohet me TEN-E të reviduar deri në fund të vitit 2024.

Prokurimet janë duke u zhvilluar për punimet në interkonektorin e gazit natyror ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, projekti kryesor i Planit Ekonomik dhe të Investimeve (PEI) për Ballkanin Perëndimor dhe projekti prioritar i Iniciativës për Lidhshmërinë e Gazit në Evropën Qendrore dhe Juglindore (CESEC) i cili do të mundësojë sigurinë e furnizimit me gaz në Maqedoninë e Veriut. Aktivitetet përgatitore për ndërtimin e interkonektorit të gazit me Serbinë janë duke u zhvilluar. Studimi i fizibilitetit dhe projektet teknike për interkonektorin e gazit me Kosovën janë finalizuar.

## **Kapitulli 27: Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike**

*BE-ja promovon veprim të fortë klimatik, zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor. E drejta e BE-së përmban dispozita në lidhje me ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikalet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.*

### Mjedisi jetësor

Për sa i përket **legjislacionit horizontal**, Maqedonia e Veriut nuk është harmonizuar plotësisht me Direktivat për Vlerësimin e Ndikimit mbi Mjedisin Jetësor (VNMJ) dhe Vlerësimin Strategjik të Mjedisit Jetësor (VSMJ). Kjo ndikon negativisht në të gjithë sektorët e tjerë, investimet në infrastrukturë dhe pjesëmarrjen dhe perceptimin e përgjithshëm të publikut. Mungesa e kuadrit të specializuar dhe kapacitetet e dobëta institucionale dhe administrative minojnë kontrollin e cilësisë dhe performancat adekuate të vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin jetësor. Kjo çon në miratimin e projekteve të infrastrukturës pa shqyrtimin e plotë të ndikimit mbi mjedisin jetësor. Që nga miratimi i Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese në prill të vitit 2022, nuk ka filluar procesi i reformave për sistemin më efikas për zbatimin e legjislacionit në fushën e mjedisit jetësor. Maqedonia e Veriut duhet të sigurojë se ekziston struktura institucionale për të siguruar planifikimin e koordinuar dhe strategjik për investimet në mjedisin jetësor, si dhe cilësinë e përgatitjes dhe zbatimit të investimeve në infrastrukturë, duke përfshirë edhe transparencën e procedurave, harmonizimin me VNMJ/VSMJ dhe elementet e tjera të së drejtës horizontale të BE-së. Gjithashtu, nuk ka harmonizim të plotë me Direktivat e BE-së për përgjegjësinë ekologjike dhe për krimin ekologjik. Raporti nacional i zbatimit për Konventën e Arhusit pritet të hartohet në vitin 2025. Ekziston Qendra e Arhusit e cila nuk është plotësisht operative dhe ofron të dhëna dhe informacione të parashkruara. Qasja në drejtësi për çështjet në fushën e mjedisit jetësor praktikisht nuk ekziston, ndërsa qasja publike në informacionet është e dobët. Maqedonia e Veriut, gjithashtu, duhet të sigurojë që monitorimi i mjedisit jetësor t'i përmbush standardet e BE-së.

Ishte arritur progres shumë i kufizuar lidhur me **cilësinë e ajrit** dhe nuk ka pasur progres në legjislativin gjatë periudhës raportuese. Është i nevojshëm të forcohet sistemi ekzistues i monitorimit dhe strukturat e ngarkuara për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të



dhënave. Rrjeti automatik i monitorimit ishte mirëmbajtur, por kapacitetet janë jashtëzakonisht të ulëta. Procesi i përkufizimit të zonave dhe aglomerateve duhet të finalizohet. Komuna e Gostivarit miratoi planin për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe kadastër të ndotësve për vitet 2022-2026. Gjithashtu, edhe Komuna e Manastirit ka hartuar dhe miratuar plan të ri për cilësinë e ajrit. Në mars 2024, planet përfundimtare për përmirësimin e cilësisë së ajrit për Komunën e Velesit, Komunën e Ohrit, Komunën e Prilepit, Komunën e Strugës, Komunën e Shtipit dhe Komunën e Gjevgjeliçës janë dorëzuar për konsultim me publikun dhe për miratim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Në fushën e **menaxhimit të mbetjeve**, gjatë periudhës raportuese u hartua Udhërrëfytyesi drejt ekonomisë qarkulluese. Ishte hartuar Strategjia e re për Menaxhimin e Mbetjeve dhe për momentin është në procesin e konsultimeve për vlerësimin e ndikimit. Është hartuar Strategjia për Menaxhimin e Llumit, por së shpejti duhet të zbatohen konsultimet me palët e interesuara.

Korniza e tanishme juridike dhe politike është kryesisht e harmonizuar me Direktivën Kornizë të BE-së për Mbetjet dhe Direktivën e Depove dhe i rregullon skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP). Nga janari 2024, detyrimi për organizimin e skemave për PZP-në u zgjerua për t'i mbuluar mbetjet e vajrave dhe gomat e mbetjeve, automjetet e vjetruara dhe materialet tekstile, përveç atyre ekzistuese për mbetjet e paketimit, MPEE-së dhe bateritë. Ndryshimet e fundit të Ligjit ekzistues për menaxhimin me pajisjet elektrike dhe elektronike dhe pajisjet elektrike dhe elektronike të hedhura në periudhën raportuese, me të cilat zvogëlohen kompensimet e prodhuesve, shkaktojnë shqetësim të madh për efikasitetin e sistemit. Zbatimi mbetet sfidë e rëndësishme për sektorin. Përzgjedhja dhe riciklimi i mbetjeve komunale janë në nivel joadekuat, ndërsa deponimi ende është metoda dominuese e menaxhimit të mbetjeve. Parimet e ekonomisë qarkulluese janë inkorporuar në legjislacionin nacional për menaxhimin e mbetjeve, por progresi konkret ende mungon për shkak të ndërjegjësimit të kufizuar të palëve të interesuara, mbështetjes së pamjaftueshme financiare dhe mangësive infrastrukturore.

Ka progres sa u përket aktiviteteve të rehabilitimit në lidhje me pastrimin e **Industrië Kimike Organike Shkup** (OHIS), ish-deponia e fabrikës së kimikaleve organike.

Sa i përket **menaxhimit të cilësisë së ujit**, korniza juridike dhe politike për menaxhimin e integruar të ujit është kryesisht e vendosur, por nuk ishte arritur progres gjatë periudhës raportuese. Ishte vendosur Regjistri Nacional i Ujërave Nëntokësore, por ai duhet të jetë i disponueshëm për publikun. Maqedonia e Veriut duhet të përshpejtojë përparimin drejt përbaljes me burimet e pikave të ndotjes, të përparojë në shpalljen e zonave të ndjeshme ndaj eutrofikimit, të sigurojë miratimin në kohë të ciklit të parë të Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore dhe të përmirësojë ndjekjen e cilësisë dhe sasisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Vendi duhet të forcojë sistemin e inspektimeve dhe sanksioneve dhe të forcojë modelin e financimit të sektorit, duke u udhëhequr nga parimet ndotësi paguan dhe kthimi i plotë i shpenzimeve. Ishte arritur progres i caktuar në rritjen e nivelit të financimit me marrëveshje prej 50 milionë euro ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) për projektet komunale të infrastrukturës së ujit, me fokus në furnizimin me ujë, uljen e humbjeve, rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe trajtimin e ujërave të zeza.

Për sa i përket **mbrojtjes së natyrës**, ende nuk ishte miratuar Ligji për natyrën, i menduar të harmonizohet me kërkesat e Direktivës së BE-së për Habitatet dhe Direktivës për Zogjtë. Ligji për zbatimin e CITES dhe legjislacioni përkatës i zbatimit janë hartuar, por procesi i konsultimeve me publikun duhet të fillojë zyrtarisht. Aktivitetet për identifikimin e zonave potenciale të Natura 2000 vazhduan në të gjithë vendin, më pas duke hasur në vështirësi institucionale. Është e nevojshme të vazhdohet përgatitja për identifikimin dhe shpalljen

fillestare të zonave që do të mbulohen nga rrjeti Natura 2000. Është hartuar dhe publikuar harta digjitale e habitateve, në të cilën janë paraqitur kushtet ekologjike të habitateve. Procesi për marrjen e statusit të mbrojtjes speciale për Liqenin e Ohrit, Moçalin e Studençishtës dhe Kanionin e Matkës ende nuk është finalizuar. Mungesa e financimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm dhe kapacitetit administrativ për të menaxhuar zonat e mbrojtura mbetet sfida e rëndësishme në këtë sektor, megjithëse për herë të parë, janë ndarë mjetet e buxhetit nacional për të mbështetur menaxhimin e katër parqeve nacionale.

Maqedonia e Veriut ka arritur progres të caktuar në fushën e **pylltarisë**, pasi organet e reviduan Strategjinë për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pylltarisë (deri në vitin 2026). Në mënyrë shtesë, me mbështetjen e fondeve IPA, u krye regjistrimi i pilot-zonës që inicioi zhvillimin e inventarit nacional të pyjeve dhe ishte hartuar legjislacioni i ri në fushën e pylltarisë në përputhje me të *drejtën* e BE-së. Por, pa miratimin përfundimtar të legjislacionit dhe zbatimin e tij, nuk do të realizohet harmonizimi dhe nuk do të arrihen reformat e nevojshme.

**Ndotja industriale dhe menaxhimi i rrezikut** është në fazë të hershme të harmonizimit, ndërsa Ligji për emisionet industriale së shpejti duhet të miratohet. Nuk është shënuar progres në fusha të tjera.

Në periudhën raportuese nuk ka zhvillim në **fushat e ndotjes së kimikaleve dhe zhurmës**.

Lidhur me **mbrojtjen civile**, si vend pjesëmarrës në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit (UCPM), Maqedonia e Veriut merr pjesë në aktivitetet relevante. Ishte zhvilluar sistemi i paralajmërimit të hershëm për vërshimet dhe ishte kryer skicimi i zonave të rrezikuara nga vërshimet dhe lokacioneve të cenueshme. Në mënyrë shtesë, ishte hartuar dhe vendosur në përdorim platforma për menaxhimin e incidenteve dhe bashkëpunimin për mbrojtjen civile lokale dhe palët e tjera të interesuara për trajnimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj vërshimeve. Maqedonia e Veriut pritet të përmirësojë rezistencën e saj ndaj krizave në aspektin e parandalimit dhe gatishmërisë dhe të përdorë, aty ku është e përshtatshme, partneritetin shkencor për rreziqet natyrore përmes Qendrës Koordinuese të Reagimit në Rastet Urgjente. Temat që kërkojnë vëmendje urgjente përfshijnë reformat në sektor, përkufizimin më të mirë të rolit të koordinatorit nacional për Platformën Nacionale për Reduktimin e Rreziqeve nga Katastrofat, lidhshmërinë e sistemit nacional të komunikimit për rastet urgjente me Sistemin e Përbashkët të Komunikimit dhe Informacioneve për Gjendjet e Jashtëzakonshme të Komisionit Evropian (CECIS), miratimin e Strategjisë së re Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim për vitet 2022-2026. Vendi e aktivizoi Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian dy herë gjatë krizës së zgjatur me zjarret në pyje në korrik dhe gusht të vitit 2024.

#### Ndryshimet klimatike

Nuk është arritur progres. Ligji për aksionin klimatik së shpejti duhet të miratohet. Së shpejti duhet të miratohen Plani Nacional i Energjisë dhe Klimës i përditësuar (PNEK) dhe strategjia afatgjate për aksionin klimatik me qëllim për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Duhet të lëshohet në përdorim edhe sistemi nacional i inventarit të gazrave serrë. Maqedonia e Veriut duhet të zbatojë plotësisht Pakon e Zbatimit të Ndjekjes, Njoftimit dhe Verifikimit dhe Akreditimit (NNJVA) për të futur çmim të karbonit deri në dhjetor 2025 dhe të harmonizohet me Sistemin e Tregtimit të Emisioneve të BE-së. Gjithashtu, duhet të hartojë dhe parashtrojë kontribut të ri nacional për zbutjen e ndryshimeve klimatike sipas Marrëveshjes së Parisit dhe të harmonizohet me përditësimet e fundit të politikës klimatike të BE-së në kuadër të pakos "Të gatshëm për 55". Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka kapacitete administrative për këtë sektor, ndërsa koordinimi ndërinstytucional është në fazën fillestare. Këto mangësi duhet të zgjidhen urgjentisht.

Ky klaster përfshin: bujqësinë dhe zhvillimin rural (Kapitulli 11); sigurinë e ushqimit, politikën veterinare dhe fitosanitare (Kapitulli 12); peshkimin dhe akuakulturën (Kapitulli 13); politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore (Kapitulli 22); dispozitat financiare dhe buxhetore (Kapitulli 33).

### **Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural**

*Politika e përbashkët bujqësore e BE-së i mbështet bujqit dhe e ofron sigurinë e ushqimit. Ndihej në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve nacionale; i mirëmban zonat rurale dhe peizazhet në të gjithë BE-në; dhe e mban gjallë ekonominë rurale duke promovuar vende pune në bujqësi, në industrinë agro-ushqimore dhe në sektorë të ngjashëm. Kjo kërkon sisteme të qëndrueshme të menaxhimit dhe kontrollit. Ekzistojnë, gjithashtu, rregulla të përbashkëta të BE-së për standardet e tregut, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.*

Për sa u përket **çështjeve horizontale**, Maqedonia e Veriut është në fazën e hershme të përgatitjeve për bujqësi të qëndrueshme. Reformat qeveritare në sistemin e pagesave direkte nga viti 2023 e kanë forcuar mbështetjen e drejtpërdrejtë për prodhimin. Është anuluar hartimi i Ligjit të ri për bujqësi dhe zhvillim rural. Maqedonia e Veriut duhet të harmonizojë politikën e saj të mbështetjes së bujqësisë me të drejtën e BE-së, veçanërisht me përdorimin e masave agroekologjike.

Të gjithë elementët e Sistemit të Integruar të Administratës dhe Kontrollit (SIAK) janë vendosur në përputhje me të drejtën e BE-së. Duhet të sigurohet transferimi i të dhënave dhe interoperabiliteti i elementeve të ndryshëm bashkë me kontrollin e saktësisë së të dhënave. Është shënuar progres në sigurimin e incizimit ortofoto për të lehtësuar përditësimin e SIPB-së. Regjistri i bujqve dhe SIPB-së së shpejti duhet të transferohen në Agjencinë e Pagesave. Lidhur me zhvillimin e interoperabilitetit në kohë reale me sistemet e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve (identifikimi i kafshëve), për shkak të cilësisë së të dhënave nuk është arritur progres.

Në fushën e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Ekonomive Bujqësore (FADN), numri i shtuar i mostrave të mbledhjes së të dhënave ka përmirësuar përfaqësimin. Nevojiten resurse shtesë për të siguruar zgjerimin e sistemit të FADN-së dhe të përfshijnë të dhëna për qëndrueshmërinë ekologjike dhe sociale në përputhje me Rrjetin e ri të të Dhënave për Qëndrueshmërinë e Ekonomive Bujqësore të BE-së (FSDN).

Ishte miratuar Ligji i ri për sistemin këshillëdhënës për bujqësinë dhe zhvillimin rural, i cili siguron vendosjen e kornizës juridike për zhvillimin e shërbimeve këshillëdhënëse për ekonominë bujqësore në përputhje me të drejtën e BE-së.

Mbetet të miratohet legjislacioni i përgjithshëm për **organizimin e tregut të përbashkët** (OTP) dhe të përkufizohen mandatet institucionale.

Për sa i përket **zhvillimit rural**, zbatimi i IPARD III filloi me publikimin e dy thirrjeve për projekte, njëkohësisht duke përparuar me finalizimin e programit IPARD II. Kapaciteti dhe mbajtja e kuadrit të organeve të IPARD, veçanërisht të Agjencisë së Pagesave, duhet të zgjidhen për të siguruar qëndrueshmëri. Vëmendje e veçantë nevojitet për t'i reduktuar pagesat e vonuara për kërkuesit.

Për sa i përket **politikës së cilësisë**, është shënuar progres me miratimin e Ligjit për verë. Nevojitet korniza juridike, duke përfshirë edhe atë për pijet alkoolike, plotësisht të harmonizohet me të drejtën e BE-së. Kapacitetet dhe resurset administrative mbeten të pamjaftueshme, pavarësisht perspektivave të rritjes.

Sa i përket **bujqësisë organike**, mbetet për t'u miratuar Ligji i ri për bujqësinë organike, i cili do të harmonizohet në mënyrë shtesë me të *drejtën* e BE-së. Duhet të përmirësohen veprimet për përmirësimin e ndjekjes dhe kontrollit të certifikimit të prodhimit organik dhe mundësinë e ndjekjes së produkteve organike. Duhet të bëhen përpjekje për të zhvilluar më tej sektorin duke shfrytëzuar në mënyrë shtesë mbështetjen e disponueshme nga programi IPARD III.

## **Kapitulli 12: Siguria e ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare**

*E drejta e BE-së për ushqimin, duke përfshirë edhe rregullat e higjienës për prodhimin e produkteve ushqimore, siguron nivel të lartë të sigurisë së ushqimit dhe ushqimit të kafshëve dhe nivel të lartë të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimit me origjinë shtazore mbrohen bashkë me cilësinë e farës, materialin për mbrojtjen e bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.*

Sa i përket **sigurisë së përgjithshme të ushqimit**, janë miratuar ndryshime në Ligjin për sigurinë e ushqimit. Është hartuar Ligji i ri për kontrollet zyrtare, së shpejti duhet të miratohet. Sistemi Nacional për Paralajmërim të Shpejtë të Ushqimit dhe Ushqimit të Kafshëve, si dhe sistemi për revizionin e brendshëm dhe trajnimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë vazhduan. Agjencia ka kryer revizione të rregullta të laboratorëve të akredituar në fushën e mjekësisë veterinare dhe sigurisë së ushqimit. Agjencia vazhdoi të kryejë punën e saj në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë në shumicën e fushave. Megjithatë, qasja e bazuar në rrezik dhe parimi i transparencës duhet të zbatohen për të gjitha sistemet për kontrollin zyrtar dhe të financohen në mënyrë adekuate.

Për sa i përket **politikës veterinare**, së shpejti duhet të miratohet Ligji i ri për shëndetësinë veterinare, i cili ka për qëllim të harmonizohet me legjislacionin e ri të shëndetësisë veterinare të BE-së, duke përfshirë edhe rregullativën e deleguar të zbatimit për kontrollin e sëmundjeve. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë parasheh përditësimin e rregullt të masave mbrojtëse të importit dhe të kërkesave për importin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore.

Sa u përket masave për kontrollin e sëmundjeve të kafshëve, Agjencia ka program për mbikëqyrje aktive dhe pasive për sëmundjet e ndryshme; megjithatë, ato së shpejti duhet të përditësohen në përputhje me parimet e së *drejtës* së BE-së për shëndetësinë veterinare. Mbledhja, verifikimi dhe analiza e të dhënave mbeten të pamjaftueshme. Maqedonia e Veriut nuk ka kryer fushata të vaksinimit kundër tërbimit në vjeshtë të vitit 2023 dhe pranverë të vitit 2024, ndërsa numri i mostrave të mbledhura nga programi i mbikëqyrjes së tërbimit është i pamjaftueshëm për të siguruar të dhëna të besueshme për zbulimin e sëmundjes. Programi Nacional për vitin 2024 për kontrollin e reziduëve nga produktet mjekësore veterinare dhe kontaminantëve në kafshët e gjalla dhe ushqimin me origjinë shtazore nuk është plotësisht në përputhje me të *drejtën* e BE-së për gjedhët, delet, derrat, shpendët, akuakulturën, qumështin, vezët dhe mjaltin. Janë miratuar katër akte nënligjore për zooteknikën. Kapaciteti për të harmonizuar dhe zbatuar të *drejtën* e BE-së në fushën e çështjeve zooteknike mbetet për t'u përmirësuar.

Lidhur me **vendosjen në qarkullim të ushqimit, ushqimit të kafshëve dhe nënprodukteve me origjinë shtazore**, Maqedonia e Veriut miratoi legjislacionin për zbatim, me qëllim të harmonizimit me të *drejtën* e BE-së. Aktivitetet përgatitore për ndërtimin e impiantit për prodhimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ende nuk kanë përfunduar.

Sa u përket **rregullave të sigurisë së ushqimit**, Maqedonia e Veriut ka hartuar akte nënligjore për shtimin e vitaminave dhe mineraleve dhe substancave të tjera të caktuara në produktet ushqimore. Agjencia vazhdoi të zbatojë programin për ndjekjen e sigurisë së ushqimit, por të dhënat do të analizohen në mënyrë shtesë.

Sa u përket **rregullave specifike për ushqimin e kafshëve**, Agjencia ka vazhduar zbatimin e programit për ndjekjen e sigurisë së ushqimit të kafshëve.

Në fushën e **politikës fitosanitare**, së shpejti duhet të miratohet Ligji i ri për shëndetin e bimëve, i cili ka për qëllim harmonizimin me legjislacionin e ri të BE-së për shëndetin e bimëve. Drejtoria Fitosanitare e përditëson rregullisht listën e organizmave të dëmshëm në përputhje me të *drejtën* e BE-së dhe statusin e organizmave të dëmshëm në vend. Ishte zbatuar programi për ndjekjen fitosanitare të shëndetit të bimëve, ndërsa sistemi për informimin fitosanitar ishte zhvilluar në mënyrë shtesë. Ishte miratuar akti nënligjor për trajnimin në fushën e fitofarmacisë, fitomjekësisë dhe përdorimit të qëndrueshëm të produkteve fitofarmaceutike. Megjithatë, masat për përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve nuk janë zbatuar. Sipas Sistemit për Paralajmërim të Shpejtë të Ushqimit dhe Ushqimit të Kafshëve (RASFF), vendet anëtare të BE-së kanë njoftuar për konstatimet e kimikaleve të paautorizuara në disa dërgesa perimesh, duke treguar se kontrolli i pesticideve të përdorura në vend është joadekuat. Mbetet një punë e konsiderueshme për t'u bërë për të mbledhur të dhëna të besueshme mbi përdorimin nacional të pesticideve dhe ndikimin e tyre mbi shëndetin e njerëzve.

Ligji për organizmat e modifikuar gjenetiki nuk është plotësisht i harmonizuar me të *drejtën* e BE-së.

### **Kapitulli 13: Peshkimi dhe akuakultura**

*Me politikën e përbashkët të peshkimit përcaktohen rregulla për menaxhimin e peshkimit, mbrohen resurset e gjalla të detit dhe kufizohet ndikimi mbi mjedisin jetësor në peshkim. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të peshkimit, menaxhimin e kapacitetit të flotës, rregullat e kontrollit dhe inspektimit, rregullat e tregjeve dhe të akuakulturës, si dhe mbështetjen për peshkimin dhe komunitetet bregdetare. Më tutje, promovon akuakulturë të qëndrueshme.*

Meqë Maqedonia e Veriut ka vetëm peshkim të brendshëm në liqene dhe akuakulturë, pjesa më e madhe e së *drejtës* së BE-së për peshkim nuk është e zbatueshme. Ishte arritur progres lidhur me harmonizimin e kornizës juridike nacionale me miratimin e Ligjit të ri për peshkim dhe akuakulturë në vitin 2024. Ligji i ri për peshkim dhe akuakulturë është kryesisht i harmonizuar me të *drejtën* e BE-së për politikën e tregut, veçanërisht për dispozitat e BE-së për standardet e tregut, kërkesat për informacionet e konsumatorëve, mbështetjen strukturore dhe ndihmën shtetërore. Megjithatë, ai nuk është plotësisht i harmonizuar me të *drejtën* e BE-së për akuakulturën. Maqedonia e Veriut duhet të përshpejtojë miratimin e legjislacionit për zbatimin e legjislacionit të ri.

Gjatë periudhës raportuese, nuk ishte shënuar progres në përballjen me problemin e vazhdueshëm të kuadrit të pamjaftueshëm për formulimin e politikave, kontrollin dhe koordinimin ndër-institucional. **Inspektimet dhe kontrollet** mbeten të pamjaftueshme për të kontrolluar peshkimin ilegal, të paraportuar dhe të parregulluar (IPP). Planet e ndjekjes së shëndetit të peshqve zbatohen rregullisht. Maqedonia e Veriut duhet të vendos plane të forta për realizimin dhe njoftimin e kontrolleve ekologjike në sektorin e akuakulturës. Maqedonia e Veriut duhet të përfshijë veprime për të rritur ndërgjegjësimin mbi peshkimin ilegal, të paraportuar dhe të parregulluar dhe pasojat e tij juridike. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të peshkimit të paligjshëm të specieve të mbrojtura dhe të ngjalës evropiane.

Për sa i përket **menaxhimit të resurseve dhe parkut të automjeteve**, ngjala evropiane dhe trofta e Ohrit ishin specie të mbrojtura rreptësisht të mbuluara nga ndalimi i përhershëm i peshkimit. Në vitin 2023, u aplikuan ndalime të përkohshme për të ruajtur fondin e peshqve. Dispozitat e Rregullativës së BE-së për ngjalat pasqyrohen në Ligjin e ri për peshkim dhe akuakulturë. Nevojitet harmonizimi i mëtejshëm për të vendosur sistemin e mbledhjes së të

dhënave dhe për të përfshirë të dhënat e tregut dhe evidencën e detyrueshme të kapjes së ngjallës evropiane, si në peshkimin rekreativ, ashtu edhe në atë komercial.

Buxheti vjetor nacional për **masat strukturore** është joadekuat për zhvillimin e akuakulturës, veprimet për ruajtjen dhe për menaxhimin e fondit të peshqve dhe për inspektimet dhe kontrollet.

Nuk kishte zhvillim evident për sa i përket **ndihmës shtetërore**. Në lidhje me **marrëveshjet ndërkombëtare** për menaxhimin e peshkimit në liqenet tejkufitare, në vitin 2023 janë mbajtur takime të rregullta koordinuese. Greqia dhe Maqedonia e Veriut zbatojnë ndalim të rregullt të sinkronizuar të peshkimit në Liqenin e Dojranit çdo vit. Vazhdoi bashkëpunimi me Shqipërinë për menaxhimin e fondit të peshqve të Liqenit të Ohrit. Në vitin 2023, Maqedonia e Veriut iu bashkëngjiti Komisionit Këshillëdhënës Evropian për Peshkimin dhe Akuakulturën (EIFAAC) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO).

## **Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore**

*Politika rajonale është mjete kryesor i BE-së për reduktimin e pabarazive rajonale dhe investimin në zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës socio-ekonomik. Ajo funksionon përmes "menaxhimit të përbashkët" ndërmjet Komisionit dhe vendeve anëtare të BE-së. Zbatimi i programeve të politikës së kohezionit nënkupton kapacitetet administrative adekuata në nivel të programit dhe projektit, vendosjen e sistemit për menaxhim dhe kontroll të mirë financiar, si dhe përmbushjen e elementeve të tjerë të së drejtës së BE-së, të tilla si legjislacioni në fushën e mjedisit jetësor dhe legjislacioni për prokurimet publike.*

Ishte arritur progres i kufizuar lidhur me **kornizën juridike**, ndërkohë që parimet themelore mbeten kryesisht të harmonizuara me të *drejtën* e BE-së për prokurimet publike, menaxhimin e financave publike, zhvillimin rajonal dhe komunal. Ligji për revizionin e instrumentit për ndihmën paraaderuese (IPA) u ndryshua me qëllim që të autorizojë Trupin e Revizorit të kryejë revizion sipas IPA III, që është parakusht për t'ia besuar detyrat e zbatimit të buxhetit sipas IPA III Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2024 ishte hartuar dhe miratuar Urdhëresa për menaxhimin e investimeve publike. Korniza strategjike ishte forcuar me miratimin e Strategjisë së re të Reformave të Administratës Publike për vitet 2023-2030, por ka anulime në zbatimin e planit të veprimit, ndërkohë që korniza legjislative e vendit për menaxhimin e resurseve njerëzore së shpejti duhet të revidohet në përputhje me standardet evropiane. Nuk shfrytëzohet potenciali për vendosjen e lidhjeve me grupet e BE-së për bashkëpunim territorial në instrumentet e ndryshme politike. Grupet mund të përdoren si instrumente për menaxhimin e integruar territorial duke e lehtësuar zbatimin e fondeve të projekteve të vogla në programet e bashkëpunimit Interreg.

**Korniza institucionale** për menaxhimin e fondeve të BE-së sipas IPA III është harmonizuar në mënyrë shtesë me kërkesat e IPA III në lidhje me rolin e ardhshëm në politikën e kohezionit të BE-së. Megjithatë, performancat e Strukturave Operative të vendosura për programet operative shumëvjeçare janë rrezikuar për shkak të kapaciteteve të dobëta administrative dhe menaxhuese për sa i përket kuadrit. Nevojiten përmirësime të mëtejshme, pasi Maqedonia e Veriut duhet t'i forcojë kapacitetet administrative dhe të harmonizojë sistemin e menaxhimit dhe kontrollit me kërkesat e IPA III.

**Kapacitetet administrative** edhe më tutje janë të dobëta në institucionet kryesore që i menaxhojnë fondet e BE-së. Mosekzistimi i politikës nacionale për mbajtjen e kuadrit, mungesa e menaxhimit të resurseve njerëzore dhe fluktacioni jashtëzakonisht i lartë i kuadrit në strukturat e IPA-së (në vitin 2023, shkalla e ndryshimit të kuadrit ishte 10%) edhe më tutje mbesin probleme kryesore. Rëndësia e miratimit dhe zbatimit efikas të politikës së mbajtjes për strukturat e IPA-së është me rëndësi esenciale. Qendra e Trajnimeve të IPA-së mbetet me kuadër të pamjaftueshëm dhe me bazë jofunksionale të trajnuesve.

Për sa i përket **programimit** të ndihmës së BE-së, Programi Vjetor i Veprimit për IPA 2024, me vlerë prej 58,6 milionë euro, u miratua në prill 2024. Në korrik 2024 u miratuan edhe Programet Operative të IPA-së për vitet 2024-2027 për mjedisin jetësor, transportin dhe kapitalin njerëzor, me vlerë prej 160 milionë euro. Këto programe janë planifikuar të zbatohen nën menaxhimin indirekt të vendit shfrytëzues. Efikasiteti dhe shpeshtësia e dialogut të politikave sektoriale, i cili e mbështet planifikimin strategjik dhe programimin e ndihmës së BE-së, është përmirësuar gjatë periudhës raportuese.

Maqedonia e Veriut vazhdon të fitojë përvojë në programimin dhe zbatimin e politikës rajonale dhe bashkëpunimit territorial përmes pjesëmarrjes së saj në pesë programe tejkufitare (PGS), dy programe transnacionale dhe dy programe ndërrajonale të bashkëpunimit, duke përfshirë edhe strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian. Kalimi nga IPA II PGS në IPA III PGS përparoi pa probleme nga ana e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht anulimeve në ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit IPA III PGS ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, gjë që bëri që ky program i PGS-së të ishte disa muaj pa Sekretariatit e Përbashkët Teknik (SPT).

Kapacitetet administrative dhe koordinimi ndërinstucional duhet të forcohen ndjeshëm për të maksimizuar përfitimet e kësaj pjesëmarrjeje dhe për të hapur rrugën për menaxhimin e politikave të kohezionit.

Për sa i përket **ndjekjes dhe vlerësimit**, Maqedonia e Veriut merr pjesë aktive në Komitetin e Ndjekjes së IPA-së dhe në Komitetin Sektorial të Ndjekjes; megjithatë, u zbatuan më pak se 45% e konkluzioneve të përbashkëta të dakorduara për të cilat është njoftuar gjatë takimit të dytë të Komitetit të Ndjekjes së IPA III. Koordinimi i dobët ndërinstucional dhe funksioni i dobët qendror për njoftimin dhe ndjekjen e Zyrës së Koordinatorit Nacional të IPA-së ndikojnë negativisht në afatin kohor dhe cilësinë e raporteve të IPA-së. Nevojitet angazhim më i fortë politik për të përparuar me zbatimin e programeve.

Është vendosur **revizioni** i brendshëm dhe i jashtëm. Megjithatë, revizioni i brendshëm duhet të forcohet për të mbështetur më mirë funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit. Pritet miratimi i Ligjit të ri për kontrollin e brendshëm financiar publik. Trupi i Revizorit vazhdon të funksionojë mirë dhe ndjek metodologji të fuqishme të revizionit me mbulim të mirë me revizionin. Kapaciteti operativ dhe teknik i Trupit të Revizorit është përmirësuar pas punësimeve të reja. Subjektet e revizionit vazhdojnë t'i zbatojnë shumë dobët konstatimet e revizorit. Nga 46 konstatimet nga revizionet e mëparshme, vetëm 7 u mbyllën në vitin 2023, që paraqet shkallë të zbatimit prej 15%.

Sistemet e **menaxhimit financiar dhe kontrollit** janë operative, por janë nën presion për shkak të kapacitetit të kufizuar administrativ, të cilat vazhduan të ndikojnë negativisht në menaxhimin indirekt nga vendi shfrytëzues. Kapacitetet e dobëta administrative kanë çuar në anulimin automatik të më shumë se 79 milionë eurove në kuadër të programit shumëvjeçar të IPA II për mjedisin jetësor dhe transportin, duke përfshirë rreth 54 milionë euro të anuluar në vitin 2023, ndërkohë që rreziku i anulimeve shtesë mbetet i lartë. Për t'i zgjidhur mangësitë kritike dhe për të qenë në gjendje të punojë në mjedis të kontrollit *eks-post*, Maqedonia e Veriut i riorganizoi sistemet financiare dhe të kontrollit në lidhje me programet operative të parashikuara sipas IPA III. Nevojiten përpjekje shtesë për t'i përmbushur rekomandimet e BE-së dhe rekomandimet e revizionit në lidhje me menaxhimin e kuadrit dhe politikën e mbajtjes së kuadrit, planifikimin e prokurimeve publike dhe kontratave, revizionin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë.

Lidhur me luftën kundër korrupsionit, rrjeti i Departamentit të Koordinimit të Luftës kundër Mashtrimeve me Mjetet e BE-së (AFKOS), që paraqet shtyllë të sistemit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në Maqedoninë e Veriut, është vendosur dhe është plotësisht operativ. Përveç kësaj, institucionet që menaxhojnë fondet e BE-së zbatojnë sisteme të menaxhimit financiar dhe kontrollit të akredituar nga Komisioni, i cili është nën mbikëqyrjen

e organit të revizionit të jashtëm dhe Komisionit. Strategjia për transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitet 2023-2026 ishte miratuar në dhjetor 2023.

### **Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore**

*Ky kapitull i përfshin rregullat për financimin e buxhetit të BE-së ("resurset personale"). Këto resurse kryesisht përbëhen nga: i) kontributet e bazuara në të ardhurat nacionale bruto të çdo vendi anëtar; ii) taksat doganore; iii) resurset nga plastika e paricikluar dhe iv) resurset e bazuara në tatimin mbi vlerën e shtuar. Vendet anëtare duhet të kenë kapacitet administrativ adekuat për të koordinuar dhe siguruar siç duhet llogaritjen, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e resurseve personale.*

Është arritur progres i kufizuar në zhvillimin e strukturës institucionale të resurseve personale specifike dhe të kornizës juridike dhe metodologjike. Masat për të reduktuar fshehjen tatimore, mashtrimin dhe ekonominë joformale, si dhe për të përmirësuar kontrollin e brendshëm në sektorin publik duhet të zbatohen në mënyrë më efikase (për më shumë informacione, shih proceset e zhvillimit në Kapitullin 16 – Tatimimi, Kapitulli 18 – Statistika, Kapitulli 29 – Unioni Doganor dhe Kapitulli 32 – Kontrolli financiar).

Për sa u përket **resurseve personale tradicionale**, legjislacioni doganor është kryesisht i harmonizuar. Tarifa doganore për vitin 2023 ishte miratuar në përputhje me ndryshimet e fundit në Nomenklaturën e Kombinuar të BE-së. Kapaciteti i organeve doganore duhet të forcohet në mënyrë shtesë. Ishte arritur progres i caktuar në periudhën raportuese me konsolidimin dhe plotësimin e sistemeve të TI-së. Drejtoria e Doganave zbaton mjedis krejtësisht pa letra për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës. Së shpejti duhet të hartohen udhëzime për aplikimin e resurseve personale tradicionale të BE-së. Është e nevojshme të vendoset sistemi i TI-së për menaxhimin e llogarive A dhe B dhe për të mundësuar qasje në sistemin elektronik për paraqitjen e rasteve të mashtrimit dhe parregullsive në lidhje me resurset personale tradicionale (OWNRES).

Ishin miratuar ndryshimet në Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar për të siguruar që ofrimi i shërbimeve është harmonizuar me Direktivën për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Edhe më tutje ka anulime në procesin e kthimit të **TVSH-së**. Drejtoria e të Ardhurave Publike ka nisur zbatimin e Sistemit të Integruar Tatimor të Informacioneve (SITI) që ka për qëllim digjitalizimin e proceseve afariste dhe forcimin e ndjekjes së arkëtimit të tatimeve. Rreziqet që lidhen me kthimin e TVSH-së përfshihen si pjesë e sistemit të menaxhimit të rrezikut të DAP-së, i cili së shpejti duhet të revidohet. (Për më shumë informacione shih Kapitullin 16 – Tatimimi).

Llogaritë nacionale dhe përpilimi i **BND-së** bazohen në përkufizimet dhe rregullat e kontabilitetit të Sistemit Evropian të Llogarive Nacionale dhe Rajonale 2010 (SELL 2010). Enti Shtetëror i Statistikës e vazhdoi transmetimin e rregullt të të dhënave të BND-së dhe BPV-së në Eurostat, në kuadër të Programit të Transmetimit të SELL 2010. Komplet i llogarive sektoriale jofinanciare vjetore për periudhën 2018-2020 u publikua në gusht të vitit 2023. Llogaritë sektoriale vjetore hartohen për herë të parë në përputhje me SELL 2010. Megjithatë, nevojiten ende përmirësime dhe inventari i BND-së duhet të përditësohet.

**Infrastruktura administrative** së shpejti duhet të operacionalizohet për të siguruar funksionimin në kohë dhe efikas të procesit të llogaritjes, mbledhjes, pagesës dhe kontrollit të resurseve personale, si dhe për t'i përmirësuar mekanizmat e njoftimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha trupave të përfshira.

### **KLASTERI 6: MARRËDHËNIET E JASHTME**

Ky klaster përfshin: marrëdhëniet e jashtme (Kapitulli 30); politikën e jashtme, të sigurisë dhe



të mbrojtjes (Kapitulli 31).

### **Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme**

*BE-ja ka tregti të përbashkët dhe politikë tregtare ndaj vendeve të treta, bazuar në marrëveshjet multilaterale dhe bilaterale dhe masat autonome. Ekzistojnë, gjithashtu, rregulla të BE-së në fushën e ndihmës humanitare dhe politikës së zhvillimit.*

Sa i përket **politikës së përbashkët tregtare**, Maqedonia e Veriut vazhdoi t'i koordinojë pozicionet e saj dhe t'i harmonizojë politikat e saj në lidhshmëri të ngushtë me ato të BE-së, përfshirë edhe brenda OBT-së, dhe e mbështet reformën e OBT-së. Vendi u bë anëtar i plotfuqishëm i Marrëveshjes së Prokurimeve Publike të OBT-së (GPA) më 30 tetor 2023. Protokollin për pranimin e Marrëveshjes së Subvencioneve në Peshkatari u miratua dhe iu dorëzua Kuvendit për ratifikim në dhjetor 2023. Dispozitat e Marrëveshjes për Lehtësimin e Tregtisë zbatohen plotësisht. Kapaciteti administrativ i Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, e ngarkuar për politikën tregtare, duhet të forcohet në mënyrë shtesë.

Maqedonia e Veriut mori pjesë aktive në CEFTA dhe vazhdoi zbatimin e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (TPR) të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Vendi ka filluar t'i zbatojë tre marrëveshjet që lidhen me zbatimin e TPR-së, të cilat përfshijnë lirinë e lëvizjes me letërnjoftime, njohjen e kualifikimeve profesionale dhe njohjen e kualifikimeve akademike.

Sistemi i kontrollit të eksportit për **mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë** është në funksionim. Maqedonia e Veriut është harmonizuar me të *drejtën* e fundit të BE-së, përkatësisht Rregullativën (BE) 2021/821 dhe përditësimet e saj vjetore në lidhje me listën e mallrave me përdorim të dyfishtë. Megjithatë, vendi nuk është as pjesëmarrës dhe as palë e interesuar e Grupit Australian. Aderimi në Grupin Australian do të ishte hap pozitiv drejt harmonizimit me të *drejtën* e BE-së dhe anëtarësimin të ardhshëm në Grupin Australian që do të pritej pas anëtarësimin në BE.

Nuk ka negociata për **marrëveshje të reja bilaterale me vendet e treta**. Në fuqi janë 38 marrëveshje bilaterale të investimeve (MBI), nga të cilat 18 janë me vendet anëtare të BE-së.

Nuk ka progres në **politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare**. Vendi inkurajohet të vendos kornizë politikash relevante, në përputhje me politikat dhe standardet e BE-së.

### **Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes**

*Vendet anëtare duhet të jenë të afta të zhvillojnë dialog politik brenda kornizës së politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes, t'i respektojnë deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në aktivitetet e BE-së dhe t'i zbatojnë sanksionet dhe masat restriktive të dakorduara.*

Maqedonia e Veriut vazhdoi të përfshihet në **dialogun politik** me BE-në për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë në të gjitha nivelet. Ajo i nisi negociatat për partneritet të sigurisë dhe mbrojtjes me BE-në në pranverën e vitit 2024. Në shkurt të vitit 2024, Maqedonia e Veriut mori pjesë në takimin e dhjetë të Bashkimit Evropian - Ballkani Perëndimor në nivel të drejtorëve politikë. Në qershor të vitit 2024, Maqedonia e Veriut mori pjesë në drekën e punës me anëtarët e Këshillit për Punë të Jashtme.

Ishte vendosur korniza institucionale operative që mundëson pjesëmarrjen e vendit në **politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (PPJS)** dhe në politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. Maqedonia e Veriut ka ruajtur 100% harmonizimin e saj me deklaratat e përfaqësuesit të lartë në emër të BE-së dhe Vendimeve të Këshillit të BE-së për sanksionet, duke përfshirë edhe të gjitha masat restriktive të BE-së kundër Rusisë dhe Bjellorusisë në lidhje me luftën agresive ruse kundër Ukrainës. Maqedonia e Veriut mori pjesë në Samitin e Paqes në Ukrainë të organizuar nga Zvicra.

Sa u përket **masave restriktive** të BE-së, sfida kryesore është hendeku kohor juridik ndërmjet harmonizimit dhe zbatimit/hyrjes së tyre formale në fuqi. Në përbërjen e mëparshme të Dhomës Ligjvënëse, Qeveria ka parashtruar në Kuvend propozimin për ndryshimin e Ligjit për masat restriktive, por ai nuk ishte shqyrtuar dhe do të duhet të parashtrohet sërish.

Vazhdon **bashkëpunimi** aktiv i Maqedonisë së Veriut me **organizatat ndërkombëtare**. Prioritetet e saj në KB-në janë në përputhje me prioritetet e rëndësishme të BE-së, duke përfshirë edhe sigurinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe klimën, promovimin e rolit dhe pjesëmarrjes së grave dhe forcimin e rolit të të rinjve. Plani i dytë Nacional i Veprimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë është në fazën e zbatimit, duke përfshirë edhe elementë të tillë si vetëvlerësimi gjinor, plani specifik i veprimit për barazinë gjinore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe forcimin e bashkëpunimit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave. Në vitin 2023, Maqedonia e Veriut kryesoi OSBE-në dhe kontribuoi në rezultatin e suksesshëm të Këshillit Ministror të OSBE-së në Shkup. Në këtë cilësi, ishte organizatore e konferencave për t'i dhënë fund pashtetësisë, luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe përpjekjeve për kthimin e pronës, si dhe rezistencës kibernetike. Vendi, gjithashtu, mori kryesimin e PBEJL-së për periudhën 2023-2024 dhe ishte organizatore e Takimit të Ministrave të Çështjeve Evropiane.

Marrëveshja bilaterale e imunitetit midis Maqedonisë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara mbetet në fuqi, duke u mundësuar qytetarëve amerikanë përjashtim nga kompetenca e **Gjykatës Penale Ndërkombëtare**. Me të, vendi nuk i respekton qëndrimet e përbashkëta të BE-së për integritetin e Statutit të Romës ose me Parimet Udhëzuese të BE-së lidhur me marrëveshjet bilaterale të imunitetit. Nevojitet harmonizimi me qëndrimin e BE-së.

Lidhur me **parandalimin e konflikteve**, Maqedonia e Veriut vazhdoi t'i mbështesë masat dhe dokumentet e BE-së.

Lidhur me **ndalimin e proliferisë**, Maqedonia e Veriut vazhdoi të zbatojë Udhërrëfyesin Rajonal për vitin 2018 dhe Strategjinë e saj Nacionale dhe Planin e Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) për vitet 2022-2024. Nevojiten përpjekje shtesë nga vendi për të harmonizuar legjislacionin e tij me kornizën juridike të BE-së për AVL-në. Maqedonia e Veriut nuk është ende vend pjesëmarrës në asnjë nga regjimet multilaterale të kontrollit të eksportit. Harmonizimi me qëndrimin e përbashkët të BE-së<sup>15</sup> mbi kontrollin e eksportit të armëve është në vazhdim, me punë të mëtejshme të nevojshme për legjislacionin gjithëpërfshirës dhe shkëmbimin ndërshtetëror të informacioneve. Maqedonia e Veriut është vend anëtar i Marrëveshjes së Tregtisë së Armëve, me masat ndërshtetërore për zbutjen e rrezikut dhe shkëmbimin e informacioneve që së shpejti duhet të zhvillohen.

Maqedonia e Veriut merr pjesë në disa, por jo në të gjitha, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të kontrollit të eksportit, duke përfshirë edhe Iniciativën e Sigurisë nga Proliferia dhe Kodin e Sjelljes së Hagës.

Ajo është e përkushtuar të bëhet anëtare e Marrëveshjes së Vasenarit dhe Grupit Australian. Vendi ende nuk e ka përditësuar Strategjinë Nacionale për Luftën kundër Përhapjes së Armëve për Shkatërrimin Masiv dhe Mbrojtjen nga Kërcënimet Kimike, Biologjike, Radiologjike dhe Bërthamore dhe Planin e Veprimit (2019-2021) dhe Planin e Veprimit për zbatimin e tij.

Për sa u përket **masave të sigurisë**, Maqedonia e Veriut ka zbatuar në mënyrë shtesë Marrëveshjen e Sigurisë së Informacioneve me BE-në në lidhje me procedurat që i referohen shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara.

---

<sup>15</sup> Qëndrimi i përbashkët i Këshillit 2008/944

Lidhur me **Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes** (PPSM), vendi vazhdoi të marrë pjesë aktive dhe të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në operacionet ushtarake të BE-së për menaxhimin e krizave, veçanërisht EUFOR ALTEA në Bosnjë e Hercegovinë. Forcat e armatosura të Maqedonisë së Veriut marrin pjesë edhe në grupin luftarak të BE-së HELBROC 2023. Maqedonia e Veriut kontribuon në bashkëpunimin rajonal në mjekësinë ushtarake përmes Forcave Mjekësore Ballkanike me Dedikim (FMBD).

Për sa u përket **kërcënimeve hibride**, Maqedonia e Veriut iu bashkëngjiti Qendrës Evropiane të Ekselencës për t'u Përballur me Kërcënimet Hibride që ndodhet në Helsinki në tetor 2023 dhe e zbaton Strategjinë e saj për Ndërtimin e Rezistencës dhe Përballjen me Kërcënimet Hibride për vitet 2021 - 2025. Vendi promovon bashkëpunimin me shkëmbimin e të dhënave dhe përvojave nacionale me shërbimet partnere të zbulimit. Që nga marsi 2024, janë themeluar Këshilli, i kryesuar nga Kryeministri dhe grupi i punës për t'i koordinuar aktivitetet që lidhen me anëtarësimin në NATO, duke përfshirë edhe forcimin e rezistencës kundër kërcënimeve hibride. Maqedonia e Veriut është harmonizuar me deklaratat e BE-së dhe masat restriktive si përgjigje ndaj sulmeve kibernetike në vitet 2023 dhe 2024.

Maqedonia e Veriut ka filluar të vendos kornizë strategjike institucionale dhe rregullatore për të kundërshtuar efektet negative të dezinformatave. Rekomandimet për veprim të përbashkët për ndërtimin e rezistencës shoqërore ndaj ndikimeve të dëmshme të dezinformatave, të përgatitura nga shoqëria civile me mbështetjen ndërkombëtare, janë miratuar nga Qeveria si bazë për hartimin e kornizës strategjike nacionale dhe janë përfshirë në programin e saj të punës për vitin 2024. Nevojiten përpjekje shtesë për t'i reduktuar mundësitë për ndërhyrje të huaja dhe manipulime me informacionet, duke i përfshirë edhe dezinformatat, dhe për të ndërtuar rezistencën shoqërore ndaj tyre dhe formave të tjera të kërcënimeve hibride.

## **ANEKSI I – MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE MAQEDONISË SË VERIUT**

Maqedonia e Veriut ka qenë vend kandidat që nga viti 2005. Më 26 mars 2020, Këshilli Evropian e miratoi vendimin e Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut. Konferenca e parë ndërqeveritare u mbajt më 19 korrik 2022, pas miratimit të kornizës së negociatave nga Këshilli. Në të njëjtën ditë, Komisioni e filloi procesin e skringut. Skringu përfundoi në dhjetor 2023.

Maqedonia e Veriut ka marrë pjesë në procesin e **stabilizimit dhe asocimit** që nga viti 1999. Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit (MSA) me BE-në, e nënshkruar në vitin 2001 dhe në fuqi që nga viti 2004, e përcakton kornizën për marrëdhëniet me BE-në, duke përfshirë edhe dialogun politik, ekonomik dhe teknik. Ekspertët u takuan në shtatë nënkomitete dhe një grup të veçantë, në përputhje me planin. Këshilli i Stabilizimit dhe Asocimit u mbajt në mars të vitit 2023 në Shkup.

**Liberalizimi i vizave** për qytetarët e Maqedonisë së Veriut që udhëtojnë në Zonën e Shengenit është në fuqi që nga dhjetori i vitit 2009. Marrëveshja e Readmisionit është në fuqi që nga viti 2008. Në raportin e gjashtë të Komisionit, në përputhje me mekanizmin për pezullimin e regjimit të vizave, është konkluduar se Maqedonia e Veriut vazhdon t'i përmbushë kriteret për liberalizimin e vizave.

Gjatë periudhës raportuese, Maqedonia e Veriut ka harmonizuar plotësisht **politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së**. Pjesëmarrja e konsiderueshme në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave vazhdoi. Maqedonia e Veriut e përdori masën e dytë bilaterale të ndihmës në kuadër të Fondit Evropian të Paqes në vitin 2024. Paraprakisht ka marrë ndihmë përmes masës bilaterale për ndihmë që synon forcimin e kapacitetit të Armatës së Maqedonisë së Veriut për të marrë pjesë në misionet ushtarake të PPJS-së së BE-së në mars 2023, duke ofruar mbështetje në fushat e logjistikës, pajisjeve mjekësore, sistemeve të komunikimit dhe informacioneve, kapaciteteve të zbulimit, mbrojtjes kundër kërcënimeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (ABHO), pajisjes inxhinierike dhe pajisjes për trajnim. Forcat Mjekësore Ballkanike me Dedikim, në të cilat merr pjesë Maqedonia e Veriut, përfiton nga masa mbështetëse prej 6 milionë euro në vitin 2022 në kuadër të Fondit Evropian të Paqes.

Në prill të vitit 2024 ishte miratuar vendimi i katërt i financimit sipas **Instrumentit për Ndihmën Paraadruese për periudhën 2021-2027 (IPA III)** në shumë prej 58,6 milionë euro. Me të ofrohet mbështetja në fushat e të drejtave dhe sigurisë, kohezionit ekonomik, shëndetit dhe lehtësimit të integritetit. Në korrik 2024, u miratuan tre vendime të financimit me shumë prej 160 milionë euro për programet operative shumëvjeçare për periudhën 2024-2027 për transportin, mjedisin jetësor dhe kapitalin njerëzor. Maqedonia e Veriut përfiton nga mbështetja komplementare për shoqërinë civile dhe menaxhimin e migrimeve. Maqedonia e Veriut merr pjesë edhe në programet e bashkëpunimit tejkuftar, programet e bashkëpunimit transnacional dhe programet e BE-së. Me qëllim të përmirësimit të prokurimeve publike dhe forcimit të kapaciteteve për modelimin e efekteve makroekonomike të politikave dhe investimeve të gjelbra, Maqedonia e Veriut merr pjesë si vëzhgues në dy pilot-projekte në kuadër të Instrumentit për Mbështetjen Teknike.

Aktivitetet e reja janë komplementare me programet aktuale sipas **IPA II (2014-2020)**. Ishte arritur progres në zbatimin e IPA II për të mbështetur zhvillimin social dhe ekonomik dhe reformat kryesore strukturore. Ndihma e BE-së sipas IPA II vazhdoi t'i mbështesë reformat në fushat e sundimit të së drejtës, administratës publike dhe financave publike dhe e përmirësoi luftën kundër korrupsionit. Riorganizimi i institucioneve shtetërore në nivel qendror ka filluar dhe përparoi transformimi digjital i vendit. Shërbimet elektronike u zhvilluan, të ofruara nga rregullatori i energjetikës, Oda Farmaceutike dhe Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor.

Sipas **Instrumentit për Reforma dhe Rritje**, Maqedonia e Veriut mund të përfitojë nga shpërndarja indikative prej 750,4 milionë euro, e cila do të kanalizohet përmes Agjendës së Reformave, e cila i mbulon reformat kryesore në gjashtë fusha të politikës: reforma e administratës publike; (energji) e gjelbër; digjitalizimi; kapitali njerëzor; zhvillimi i sektorit privat; dhe të drejtat fundamentale dhe sundimi i së drejtës. Pagesa e mbështetjes së BE-së do të kushtëzohet me plotësimin e parakushteve dhe realizimin e reformave të përcaktuara në Agjendën e Reformave. Skema e Garancisë për të Rinjtë, e mbështetur nga BE-ja, ka përfituar më shumë se 9.900 të rinj në rajonet që përballen me shkallën më të lartë të papunësisë tek të rinjtë dhe shkallën e lartë të braktisjes së hershme të shkollës. I ndihmoi, gjithashtu, fëmijët romë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Një shumë e konsiderueshme e ndihmës financiare nga BE-ja i është dhënë Maqedonisë së Veriut për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe forcimin e lidhshmërisë me sistemet e transportit të BE-së. Në fushën e transportit, me mbështetjen e BE-së, është finalizuar rehabilitimi i segmentit rrugor A2 I, ndërmyjet Kumanovës dhe Stracinit. Me këtë është përmirësuar rruga prej 15,2 km nga korridori lindor VIII. Për sa i përket mjedisit jetësor, BE-ja e mbështeti zhvillimin e Strategjisë Nacionale për Monitorimin e Mjedisit Jetësor dhe Planin e Veprimit shoqëruar dhe Sistemin Informativ Nacional për Mjedisin Jetësor të shumëpritur. Mediat, shoqëria civile dhe sektori privat vazhdojnë të përfitojnë nga ndihma thelbësore e BE-së, e cila u ofron mundësi për rritje dhe zhvillim në mjedis të volitshëm. Në fushën e konkurrencës dhe zhvillimit të biznesit, u vendos Platforma Nacionale për Sipërmarrësinë e Grave.

Përmes **Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF)**, Maqedonisë së Veriut i janë siguruar 297,82 milionë euro në grantet e IPA III për projektet udhëheqëse në fushën e energjisë së pastër, mjedisit jetësor dhe klimës dhe transportit të qëndrueshëm. Në korrik 2024, janë miratuar dy projekte të ndihmës teknike për përgatitjen e korridorit hekurudhor VIII në shumë prej 0,78 milionë euro dhe korridorit X në shumë prej 1,04 milionë euro.

Më 8 maj 2024, BE-ja pagoi 50 milionë euro si ndihmë makrofinanciare për Maqedoninë e Veriut. Ky ishte kësti i parë prej 100 milionë euro si ndihmë makrofinanciare të përcaktuar në propozimin e Komisionit që u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli më 12 korrik 2023. Kushtet në lidhje me ndihmën janë plotësuar në mënyrë adekuate dhe përfshijnë, ndër të tjera, miratimin e Strategjisë së re të Reformës në Sektorin e Drejtësisë (2023-2027) në përputhje me komentet e Komisionit, miratimin e Strategjisë së re për Formalizimin e Ekonomisë Joformale (2023-2027), themelimin e Fondit për Efikasitetin Energjetik, ndryshimet në Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe Ligjin për tatimin mbi fitim për të reduktuar lirimet tatimore dhe operacionalizimin e Këshillit Fiskal.

BE-ja ofron mbështetje nëpërmjet IPA-së dhe Instrumentit të Politikës së Jashtme për të forcuar rezistencën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor në përballjen me kërcënimet hibride, duke i përfshirë edhe kërcënimet kibernetike dhe ndërhyrjet e huaja dhe manipulimet me informacionet.

## ANEKSI II – TË DHËNAT STATISTIKORE

TË DHËNAT STATISTIKORE (më 5.9.2024) Maqedonia e Veriut  
Maqedonia e Veriut

Të dhënat themelore	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Popullsia (në mijë)		2 057 i	2 075 i	2 077 i	2 076 i	2 069 i	1 837 bi
Sipërfaqja e përgjithshme e vendit (km <sup>2</sup> )	1)	25 436 w	25 436 w	25 436 w	25 436 w	25 436 w	25 436 w

Llogaritë nacionale	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Bruto prodhimi vendor (BPV) (në milionë nga valuta nacionale)		464 186	660 878	692 683	669 280	729 445	803 141 p
Bruto prodhimi vendor (BPV) (në milionë euro)		7 544	10 744	11 262	10 852	11 835	13 033 p
BPV (në euro për banor)		3 890 e	5 690 e	6 000 e	5 850 e	6 440 e	7 021 biw
BPV-ja për banorë (në standardet e fuqisë blerëse (OEM))		9 254 e	12 517 e	13 150 e	12 751 e	14 108 e	:
BPV-ja për banorë (në OEM), në lidhje me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		36,0 e	41,2 e	41,9 e	42,3 e	43,0 e	:
Shkalla reale e rritjes së BPV-së: ndryshimi nga viti paraprak në vëllimin e BPV-së (%)		2,3	2,9	3,9	- 4,7	4,5	2,2 p
Rritja e punësimit (të dhënat nga llogaritë nacionale), në lidhje me vitin paraprak (%)		1	0	2	- 7	3	6 e
Rritja e produktivitetit të punës: rritja e BPV-së (në vëllim) për punonjës, në lidhje me vitin paraprak (%)		1	3	2	2	2	- 3 e
Rritja e shpenzimeve të punës për njësi, në lidhje me vitin paraprak (në %)		:	:	:	:	:	:
**Ndryshimi trevjeçar (T/T-3) në indeksin e rritjes nominale të shpenzimeve të punës për njësi (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Produktiviteti i punës për punonjës: BPV (në OEM) për punonjës në lidhje me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		45	45	44	47	47	44 e
Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		10,9	9,8	9,4	9,8	8,3	8,6 p
Industria (%)		19,0	21,5	20,8	19,8	19,7	19,1 p
Ndërtimtaria (%)		6,1	6,2	6,5	6,0	6,4	6,7 p
Shërbimet (%)		64,1 i	62,6 i	63,4 i	64,3 i	65,5 i	65,7 pi
Shpenzimet për konsumin final, si pjesë e BPV-së (%)		92,0	80,1	79,5	82,8	83,6	84,9 p
Investimi bruto në mjetet themelore, si pjesë e BPV-së (%)		23,5	20,0	21,0	21,6	23,5	23,5 p
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve, në lidhje me BPV-në (%)		47,1	60,4	62,4	57,8	65,4	74,0 p
Importi i mallrave dhe shërbimeve, në lidhje me BPV-në (%)		66,1	72,8	76,2	70,5	81,3	94,9 p
Investimi bruto në mjetet themelore nga sektori i përgjithshëm qeveritar, si përqindje e BPV-së (në %)		:	:	:	:	:	:

Aktiviteti afarist	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2015 = 100)		90,6 w	109,2 w	113,2 w	102,4 w	103,9 w	:

Numri i ndërmarrjeve aktive (numri)		53 645 w	58 231 w	58 765 w	58 570 w	59 122 pw	:
Shkalla e themelimit: numri i ndërmarrjeve të themeluara në periudhën e referencës (t) i pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		12,2	8,4 b	8,5	8,0	:	:
Shkalla e mbylljes: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën e referencës (t) i pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		9,3	7,6 b	8,4 p	7,3 p	:	:
Personat e punësuar në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si pjesë e të gjithë punonjësve (në kuadër të ekonomisë së biznesit jofinanciar) (%)		77,3 iw	74,1 iw	73,7 iw	73,9 iw	73,5 iw	:
Vlera e shtuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (në ekonominë e biznesit jofinanciar) (në milionë euro)		2 245 iw	2 895 iw	3 215 i	3 154 iw	3 588 iw	:
Vlera e përgjithshme e shtuar (në ekonominë e biznesit jofinanciar) (në milionë euro)		3 227	4 579	4 878	4 643 w	5089 pw	:

#### Shkalla e inflacionit

	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK), ndryshimi në lidhje me vitin paraprak (në %)		3,2 d	2,3 d	0,7 d	1,2 d	3,4 d	14,0 d

#### Bilanci pagesor

	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Bilanci pagesor: gjithsej llogaria rrjedhëse (në milionë euro)		- 189,3	22,4	- 334,7	- 318,0	- 329,0	- 797,4
Bilanci pagesor Llogaria rrjedhëse: bilanci tregtar (në milionë euro)		- 1 904,9	- 1 736,2	- 1 948,8	- 1 803,6	- 2 336,9	- 3 481,0
Bilanci pagesor Llogaria rrjedhëse: shërbimet neto (në milionë euro)		359,2	370,9	335,7	423,7	497,9	751,9
Bilanci pagesor Llogaria rrjedhëse: bilanci neto për të ardhurat primare (në milionë euro)		- 131,1	- 450,7	- 519,6	- 411,5	- 519,5	- 568,4
Bilanci pagesor Llogaria rrjedhëse: bilanci neto për të ardhurat sekondare (në milionë euro)		1 487,5	1 838,4	1 798,0	1 473,4	2 029,4	2 500,2
Bilanci neto për të ardhurat primare dhe sekondare: nga të cilat transfertat shtetërore (në milionë euro)		76,6	109,1	43,2	110,0	138,5	59,1
**Mesatarja lëvizëse trevjeçare e prapambetur e bilancit të llogarisë rrjedhëse në lidhje me BPV-në (%)		:	- 1,1	- 1,2	- 1,9	- 2,9	- 3,9
**Ndryshimi pesëvjeçar i pjesës së eksportit botëror të mallrave dhe shërbimeve (%)		:	51,6	38,4	37,9	25,3	19,1
Bilanci neto (hyrëse-dalëse) i investimeve të drejtpërdrejta të huaja (IDH) (në milionë euro)		344,6 w	603,7 w	363,3 w	154,7 w	387,5 w	654,2 w
Investimet e drejtpërdrejta të huaja (IDH) jashtë vendit (në milionë euro)		- 0,2 w	10,4 w	35,5 w	46,7 w	83,0 w	90,8 w
nga të cilat IDH të ekonomisë për të cilën njoftohet në vendet e BE-27 (në milionë euro)		:	0,4	27,2	31,3	59,7	67,3 w
Investimet e drejtpërdrejta të huaja (IDH) në ekonominë për të cilën njoftohet (në milionë euro)		344,4 w	614,1 w	398,8 w	201,4 w	470,5 w	745,0 w
nga të cilat IDH të vendeve të BE-27 në ekonominë për të cilën njoftohet (në milionë euro)		283,7 w	291,2 w	220,2	42,3	449,7	519,6 w
**Pozicioni neto ndërkombëtar i investimeve, në lidhje me BPV-në (%)		- 52,6 w	- 56,2 w	- 57,3 w	- 63,6 w	- 61,2 w	- 62,5 w
Shkalla vjetore e ndryshimit të të dalave bruto të remitencave (në valutë nacionale) nga punonjësit migrantë (%)		2,6 iw	1,9 iw	:	:	:	:

#### Financat publike

	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Deficiti/suficiti i përgjithshëm shtetëror, në lidhje me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Borxhi bruto i përgjithshëm shtetëror, në lidhje me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Të ardhurat e përgjithshme shtetërore, si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:
Shpenzimet e përgjithshme shtetërore, si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:

<b>Treguesit financiarë</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Borxhi i jashtëm bruto i të gjithë ekonomisë, në lidhje me BPV-në (%)		64,2 i	73,0 i	72,4 i	78,7 i	80,9 i	82,8 pi
Borxhi i jashtëm bruto i të gjithë ekonomisë, në lidhje me eksportin e përgjithshëm (%)		140,8 w	121,4 w	117,0 w	136,3 w	123,0 w	111,9 w
Oferta monetare: M1 (banknota, monedha, depozita brenda natës, në milionë euro)		1 034,7 w	2 436,7 w	2 857,4 w	3 314,2 w	3 605,5 w	3 830,2 w
Kredia e përgjithshme nga institucionet financiare monetare për rezidentët (e konsoliduar) (në milionë euro)		3 412,0 w	5 237,6 w	5 552,3 w	5 791,4 w	6 277,8 w	6 880,7 w
**Ndryshimi vjetor i detyrimeve të sektorit financiar (%)		:	7,6 w	12,2 w	6,1 w	12,9 w	:
**Borxhi privat, i konsoliduar, në lidhje me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
Shkallët kamatare: kursi ditor i parasë, në vit (%)	2)	2,17 w	0,99 w	1,00 w	1,00 w	0,94 w	1,08 w
Kursi i euros: mesatarja për periudhën (1 euro = ... valuta nacionale)		61,529	61,512	61,506	61,675	61,636	61,623
Indeksi i kursit të ponderuar devizor efektiv tregtar, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
**Ndryshimi trevjeçar (T/T-3) në indeksin e kursit të ponderuar devizor efektiv tregtar, nga 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e mjeteve rezervë (përfshirë edhe arin) (në milionë euro)	3)	2 068,9 w	550,3	374,6	114,6	304,7	271,6

<b>Tregtia e jashtme e mallrave</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Vlera e importit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (në milionë euro)		5 053	7 676	8 463	7 599	9 647	12 126
Vlera e eksportit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (në milionë euro)		3 215	5 873	6 424	5 781	6 969	8 300
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (në milionë euro)		- 1 838	- 1 804	- 2 040	- 1 818	- 2 678	- 3 826
Kushtet e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / indeksi i çmimeve të importit * 100) (në numër)	4)	95,9 iw	94,9 iw	95,3 iw	102,4 iw	:	:
Pjesa e eksportit drejt vendeve të BE-27 në vlerën e eksportit të përgjithshëm (%)		62,3 iw	80,3 iw	78,5 iw	77,5 iw	77,1 iw	78,3 iw
Pjesa e importit nga vendet e BE-27 në vlerën e importit të përgjithshëm (%)		47,8 iw	52,9 iw	50,8 iw	46,3 iw	46,2 iw	46,8 iw

<b>Demografia</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Shkalla e përgjithshme e ndryshimit natyror të popullsisë (shkalla e rritjes natyrore): numri i lindjeve minus vdekjeve (për një mijë banorë)		1,6	0,8	- 0,3	- 3,2	- 5,1	- 2,4 b
Vdekshmëria e fëmijëve nën një vit (për 1.000 lindje të gjalla)		7,6	5,7	5,6	5,7	4,6	:
Jetëgjatësia e pritshme gjatë lindjes: meshkujt (vjet)		73,1	74,6	74,7	72,2	71,1 b	:
Jetëgjatësia e pritshme gjatë lindjes: femrat (vjet)		77,2	78,8	78,6	76,7	75,5 b	:

<b>Tregu i punës</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshës prej 20 deri në 64 vjeç: korelacioni i popullsisë së moshës prej 20 deri në 64 vjeç, që është ekonomikisht aktive (%)		70,1	70,4	71,5	70,5	70,5 w	:
*Shkalla e punësimit për personat e moshës prej 20 deri në 64 vjeç: korelacioni i popullsisë së moshës prej 20 deri në 64 vjeç, që janë të punësuar (%)		48,4	56,1	59,2	59,1	59,5 w	:
Shkalla e punësimit të meshkujve të moshës prej 20 deri në 64 vjeç (%)		57,8	66,6	69,7	68,9	69,5 w	:



Shkalla e punësimit të femrave të moshës prej 20 deri në 64 vjeçe (%)		38,8	45,2	48,4	49,0	49,2 w	:
Shkalla e punësimit për personat e moshës prej 55 deri në 64 vjeç: korelacioni i popullsisë së moshës prej 55 deri në 64 vjeç që janë të punësuar (%)		35,4	42,7	45,1	45,7	44,9 w	:
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		18,7 i	15,7 i	13,9 i	12,0 i	11,5 w	:
Industria (%)		23,8 i	23,9 i	24,1 i	23,9 i	23,9 w	:
Ndërtimtaria (%)		6,2 i	7,4 i	7,0 i	6,9 i	6,8 w	:
Shërbimet (%)		51,2 i	52,9 i	55,0 i	57,1 i	57,7 w	:
Personat e punësuar në sektorin publik, si pjesë e numrit të përgjithshëm të punonjësve, personat e moshës prej 20 deri në 64 vjeç (%)	5) 6)	25,5 w	23,1 w	23,2 w	24,4 w	25,6 w	:
Personat e punësuar në sektorin privat, si pjesë e numrit të përgjithshëm të punonjësve, personat e moshës prej 20 deri në 64 vjeç (%)	6)	74,5 w	76,9 w	76,8 w	75,6 w	74,4 w	:
Shkalla e papunësisë: pjesa e fuqisë punëtore që është e papunë (%)		31,4	20,8	17,3	16,4	15,7 w	:
Shkalla e papunësisë së meshkujve (%)		31,8	21,3	16,5	16,7	16,4 w	:
Shkalla e papunësisë së femrave (%)		30,8	19,9	18,4	15,9	14,6 w	:
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë: pjesa e fuqisë punëtore të moshës prej 15 deri në 24 vjeç që është e papunë (%)		55,3	45,4	35,6	35,7	36,4 w	:
Shkalla e papunësisë afatgjate: pjesa e fuqisë punëtore që ka qenë e papunë për 12 muaj ose më gjatë (%)		25,9	15,5	12,4	12,4	12,5 w	:
Shkalla e papunësisë së personave (të moshës prej 25 deri në 64 vjeç) me më së shumti arsim fillor të mbaruar (nivelet ISCED 0-2) (%)		36,0	23,1	23,7	21,4	22,8 w	:
Shkalla e papunësisë së personave (të moshës prej 25 deri në 64 vjeç) me arsim të lartë të mbaruar (nivelet ISCED 5-8) (%)		19,5	16,6	13,3	12,9	11,3 w	:

<b>Kohezioni social</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Rrogat dhe mëditjet mujore nominale mesatare (në valutë nacionale)		20 847 w	24 276 w	25 213 w	27 182 w	28 718 w	31 859 w
Indeksi i rrogave dhe mëditjeve reale (indeksi i rrogave dhe mëditjeve nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2016 = 100)		98 w	106 w	109 w	116 w	119 w	115 w
XHINIEV-koeficienti		:	:	:	:	:	:
Hendeku i varfërisë		:	37,7	32,0	34,9	:	:
*Personat që para kohe kanë braktisur arsimin dhe trajnimin: një pjesë e popullsisë së moshës prej 18 deri në 24 vjeç me më së shumti arsim fillor të mbaruar, të cilët tashmë nuk ndjekin arsim ose trajnim (%)		13,5	7,1	7,1	5,7	4,6 w	:

<b>Standardi i jetesës</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Numri i automjeteve të pasagjerëve në lidhje me madhësinë e popullsisë (numri për një mijë banorë)		152,0	200,0	205,0	207,0	260,0 b	264,0
Numri i parapagimeve për telefoninë celulare në lidhje me numrin e popullsisë (numri për një mijë banorë)	7)	1 104,9 ew	935,9 w	924,8 w	896,8 w	902,7 w	:
Penetrimi i internetit me shtrirje të gjerë celulare (për 100 banorë)	7)	:	60,9 w	65,1 w	66,1 w	67,6 w	:
Penetrimi i internetit me shtrirje të gjerë fikse (për 100 banorë)	7)	:	19 w	22 w	23 w	23 w	:

<b>Infrastruktura</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat funksionale në mijë km <sup>2</sup> )		27,5 iw	26,9 i	26,9 i	26,9 i	26,9 i	26,9 i
Gjatësia e autostradave (kilometra)		259	287	335	335	335	335

<b>Arsimi, inovacionet dhe kërkimi</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzimet publike për arsimin në lidhje me BPV-në (%)		:	:	:	:	:	:
*Shpenzimet e brendshme bruto për kërkimin dhe zhvillimin, në lidhje me BPV-në (%)		0,22 iw	0,36	0,37	0,37	:	0,38
Miratimi i mjeteve me buxhetin ose shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin (GBAORD), si përqindje e BPV-së (%)		:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpi (%)		:	79,3	81,6	79,4	83,7	:

<b>Mjedisi jetësor</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
*Treguesi i emisioneve të gazrave serrë, ekuivalentë në CO <sub>2</sub> (1990 = 100)	8)	117,1 w	79,5 w	118,7 w	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg ekuivalent me naftën për 1.000 euro të BPV-së me çmimet konstante nga viti 2015)		379,5	267,1	283,8	270,3	266,5	267,0
Energjia elektrike e fituar nga burimet e rinovueshme në lidhje me konsumin bruto të energjisë elektrike (%)		14,8	24,8	23,8	23,5	21,8	24,5
Pjesa e transportit rrugor të ngarkesave (bazuar në tonë-km) (%)		91,8 w	97,2 w	96,7 w	96,9 w	96,8 w	98,1 w

<b>Energjia</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Prodhimi primar i të gjitha produkteve energjetike (në mijë tonë energji (TOE))		1 756	1 148	1 160	992	886	1 041
Prodhimi primar i mazutit (në mijë TOE)		0	0	0	0	0	0
Prodhimi primar i lëndëve djegëse të ngurta (në mijë TOE)		1 410	800	860	685	552	711
Prodhimi primar i gazit (në mijë TOE)		0	0	0	0	0	0
Importi neto i të gjitha produkteve energjetike (në mijë TOE)		1 424 i	1 513 i	1 664 i	1 649 i	1 823 i	1 728 i
Konsumi bruto i energjisë në vend (në mijë TOE)		3 122	2 592	2 862	2 597	2 677	2 741
Prodhimi bruto i energjisë elektrike (GWh)		6 759	5 607	5 870	5 347	5 532	5 933

<b>Bujqësia</b>	Shënimi	Viti 2011	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Indeksi i vëllimit të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve bujqësore (me çmimet e prodhimit) (2015 = 100)		93,5 w	105,1 w	99,0 w	102,2 w	92,2 w	:
Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (në mijë hektarë)		1 120,2	1 264,1	1 264,6	1 270,5	1 268,8	1 265,1
Numri i bagëtimeve: bagëti të gjalla (në mijë krerë, fundi i periudhës)		:	256,0	219,0	222,0	178,0	165,0
Numri i bagëtimeve: derra të gjallë (në mijë krerë, fundi i periudhës)		:	196,0	136,0	164,0	186,0	182,0
Numri i bagëtimeve: dele dhe dhi të gjalla (në mijë krerë, fundi i periudhës)		:	844,0 i	771,0 i	726,0 i	709,0 i	726,0 i
Qumështi i freskët në dispozicion të fermave (në mijë tonë)		:	478,5	456,1	461,1	389,2	388,0

Prodhimi i kulturave të korrura: drithërat (përfshirë edhe orizin) (në mijë tonë)		561,2	605,3	569,6	585,5	568,9	548,4
Prodhimi i kulturave të korrura: panxhar sheqeri (në mijë tonë)		0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Prodhimi i kulturave të korrura: perimet (në mijë tonë)		710,1	792,9	772,7	794,2	798,0 p	803,1

**Burimi: Eurostati dhe/ose organet statistikore në Maqedoninë e Veriut**

: = i padisponueshëm

b = ndërprerjet në seri

d = përkufizimi ndryshon

e = vlera e parashikuar

p = në mënyrë provizore

s = vlerësimi i Eurostatit

w = të dhënat e ofruara nga dhe nën përgjegjësinë e organit statistikor nacional dhe të publikuara mbi bazën "siç është" dhe pa asnjë bindje lidhur me cilësinë e tyre dhe respektimin e metodologjisë statistikore të BE-së

\* = treguesi Evropa 2020

\*\* = treguesi i Procedurës së Disbalansit Makroekonomik (PDM)

**Fusnotat:**

- 1) Të dhënat janë të harmonizuara me sipërfaqen në Regjistrin e Njësive Territoriale që mbahet nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, si burim zyrtar për sipërfaqet e njësive territoriale në vend.
- 2) Të dhënat i mbulojnë transaksionet bilaterale brenda natës. Shkallët kamatare llogariten si procese të ponderuara.
- 3) Fundi i vitit (31 dhjetor).
- 4) Indeksi i Lasperit me vlerë të vetme. 2015 = 100.
- 5) Në sektorin publik janë përfshirë të dhënat për "të tjerët" (të kombinuara, kolektive, shtetërore, të papërkufizuara).
- 6) Nuk është zbatuar Rregullorja e re për Statistikën Sociale të Integruar Evropiane (SSIE).
- 7) Burimi: Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE).
- 8) Pjesa e inventarit të gazrave serrë, të përgatitur në kontekst të Komunikimit të Katërt Nacional (UNFCCC).

